



GJEJ NJË VEND PUNE MË TË MIRË

PËR MBËSHTETJEN TE VETJË



MESAZH NGA PRESIDENCA E PARË

Të dashur Vëllezër dhe Motra:

Zoti ka shpallur: “Është qëllimi im për të siguruar për shenjtorët e mi” (DeB 104:15). Kjo zbulesë është një premtim nga Zoti se Ai do të sigurojë bekime materiale dhe do ta hapë derën e mbështetjes te vetja, e cila është aftësia jonë që t’i sigurojmë nevojat e jetës për veten dhe pjesëtarët e familjes sonë.

Kjo broshurë është përgatitur për t’i ndihmuar anëtarët e Kishës që t’i mësojnë dhe t’i vënë në zbatim parimet e besimit, edukimit, të punuarit fort dhe mirëbesimit të Zoti. Pranimi dhe të jetuarit e këtyre parimeve do t’ju bëjnë të mundur më mirë që t’i merrni bekimet materiale të premtuara nga Zoti.

Ne ju ftojmë që t’i studioni me zell dhe t’i zbatoni këto parime, dhe t’ua jepni mësim pjesëtarëve të familjes suaj. Ndërsa bëni kështu, jeta juaj do të bekohet. Ju do të mësoni se si të veproni në shtegun tuaj drejt mbështetjes më të madhe te vetja. Ju do të bekoheni me shpresë, paqe dhe përparim më të madh.

Ju lutemi, jini i sigurt se ju jeni një fëmijë i Atit tonë në Qiell. Ai ju do dhe nuk do t’ju braktisë asnjëherë. Ai ju njeh dhe është gati t’ju japë bekimet shpirtërore dhe materiale të mbështetjes te vetja.

Sinqerisht,

Presidenca e Parë

Botuar nga Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme
Solt-Lejk-Siti, Juta

© 2019 nga Intellectual Reserve, Inc.
All rights reserved.

Shtypur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Miratur për anglisht: 7/16

Miratur për përkthim: 7/16

Përkthimi i *Find a Better Job for Self-Reliance*

Albanian

14072 101

PËRMBAJTJA

Vlerësimi i Përpyjekjeve të Mia	ii
Aftësitë	iii
Për Ndërmjetësit	iv
Mundësitë e Mbledhjeve	vi
Planet e Punës	vii
1. Çështjet Bazë	1
2. Krijimi i Rrjetit	19
3. Përputhimi Aftësitë Tuaja me Nevojat e Punëdhënësit	37
4. Pohime Fuqie	55
5. Materialet me Shkrim	71
6. Kopsite Intervistën: Pjesa 1	93
7. Kopsite Intervistën: Pjesa 2	111
8. Intervista Ushtrimore	127
9. Përshpejtoni Kërkimin Tuaj për Vend Pune	147
10. Kini Sukses në Punë	167
Mprijini Aftësitë Tuaja	185
Shtojca	193
Themeli Im	219

VLERËSIMI I PËRPPJEKJEVE TË MIA

Data	Ⓐ I Përcaktoj Burimet Çdo Ditë			Ⓑ Krijoj Kontakte Çdo Ditë			Ⓒ Vihem në Kon- takt dhe e Për- krah Partnerin Tim në Veprim	Ⓓ E ushtroj Parimin Themeli Im dhe ua Tregoj të Tjerëve
	Synimi Javor	Realja	Për- pjesja	Synimi Javor	Realja	Për- pjesja	Përppjekja	Përppjekja
Shem- bull	25	21		25	27			
Java 1								
Java 2								
Java 3								
Java 4								
Java 5								
Java 6								
Java 7								
Java 8								
Java 9								
Java 10								
Java 11								
Java 12								

PËR NDËRMJETËSIT

Faleminderit për ndërmjetësimin e një grupi të mbështetjes te vetja. Grupi duhet të funksionojë si një këshill me Frymën e Shenjtë si mësues. Roli juaj është të ndihmoni çdo person që të ndihet mirë duke treguar ide, suksese dhe dështime.

BËNI	MOS BËNI
<p>PËRPARA ÇDO MBLEDHJEJE</p> <ul style="list-style-type: none">○ Shkarkoni materiale filmike te srs.lds.org/videos.○ Kontrolloni që pajisja e materialeve filmike funksionon.○ Shqyrtoni shkurtimisht kapitullin.○ Përgatiteni veten shpirtërisht.	<ul style="list-style-type: none">○ Përgatitni një mësim.○ Anuloni mbledhjet. Nëse nuk mund të merrni pjesë, ju lutemi, kërkoni një anëtar të grupit të ndërmjetësorë për ju.
<p>GJATË ÇDO MBLEDHJEJE</p> <ul style="list-style-type: none">○ Filloni dhe mbaroni në kohë.○ Siguroni që secili të raportojë, edhe ata që arrijnë vonë.○ Zgjidhni një njeri të matë kohën.○ Nxitini të gjithë që të marrin pjesë.○ Jini anëtar i grupit. Bëjini, mbajini dhe raportojini zotimet tuaja.○ Argëtohuni dhe kremtojeni suksesin.○ Mirëbesoni dhe ndiqni fletoren e punës.	<ul style="list-style-type: none">○ Jepni mësim apo veproni si eksperti.○ Flitni më shumë se të tjerët.○ Përgjigjuni çdo pyetjeje.○ Jini qendra e vëmendjes.○ Uluni në krye të tavolinës.○ Ngrihuni për të ndërmjetësuar.○ Kapërcejini pjesën "Përsiatni".○ Jepni opinionin tuaj pas çdo komenti.
<p>PAS ÇDO MBLEDHJEJE</p> <ul style="list-style-type: none">○ Vihuni në kontakt me anëtarët gjatë javës dhe nxitini ata.○ Vlerësoni vetveten duke përdorur "Vetëvlerësimi i Ndërmjetësimit" (faqe v).	<ul style="list-style-type: none">○ Harroni të informoni specialistin e kunjit për mbështetjen te vetja mbi përparimin e grupit.

E RËNDËSISHME: RAPORTONI DHE PËRMIRËSOHUNI

- Plotësoni Formularin e Regjistrimit të Grupit në mbledhjen tuaj të parë dhe Raportin e Mbarimit të Grupit dhe Formularin e Kërkesës për Certifikatë në mbledhjen tuaj të fundit. Vizitoni srs.lds.org/report.
- Rishikoni broshurën *Ndërmjetësimi i Grupeve* te srs.lds.org/facilitator.

VETËVLERËSIMI I NDËRMJETËSIT

Pas çdo mbledhjeje të grupit, rishikoni pohimet e mëposhtme. Sa mirë po ia dilni mbanë?

SI PO IA DAL SI NDËRMJETËS?	Kurrë	Ndonjëherë	Shpesh	Gjithmonë
1. Vihem në kontakt me anëtarë të grupit gjatë javës.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2. E shpreh ngazëllimin dhe dashurinë time për çdo anëtar/e të grupit.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
3. Ndhimoj për të siguruar që çdo anëtar/e i/e grupit të raportojë mbi zotimet e veta.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
4. Unë flas më pak se anëtarët e tjerë të grupit. Secili merr pjesë në mënyrë të barabartë.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
5. I lë anëtarët e grupit t'u përgjigjen pyetjeve në vend që t'u përgjigjem vetë.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
6. Qëndroj brenda kohës së rekomanduar për çdo pjesë dhe veprimtari.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
7. Lë kohë për pjesën "Përsiatni" që Fryma e Shenjtë të mund t'i udhërrëfejë pjesëtarët e grupit.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
8. Ndjek fletoren e punës siç është shkruar dhe i përmbush të gjitha pjesët dhe veprimtaritë.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
SI PO SHKON GRUPI IM?	Kurrë	Ndonjëherë	Shpesh	Gjithmonë
1. Pjesëtarët e grupit e duan, e nxitin dhe i shërbejnë njëri-tjetrit.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2. Pjesëtarët e grupit i mbajnë zotimet e tyre.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
3. Pjesëtarët e grupit po arrijnë rezultate si materiale edhe shpirtërore.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
4. Partnerët në veprim vihen në kontakt dhe e nxitin njëri-tjetrin rregullisht gjatë javës.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

MUNDËSITË E Mbledhjeve

Ndërsa ky kurs është një angazhim 12-javor, mundësitë tuaja për mbledhje janë të ndryshueshme. Shumë grupe zgjedhin t'i zhvillojnë të 10 kapitujt e materialit *Gjej një Vend Pune më të Mirë* brenda dy javëve të para që të mund të fillojnë t'i ushtrojnë e përdorin ato aftësi menjëherë në kërkimin e tyre për vend pune.

Sapo t'i keni mbaruar të gjithë kapitujt e materialit *Gjej një Vend Pune më të Mirë*, vijoni të takoheni të paktën çdo javë në 12 javët e mbetura. Këto mbledhje zgjatin rreth një orë dhe ju do të përdorni pjesën "Mprihini Aftësitë Tuaja" për të raportuar mbi zotimet tuaja, për të studiuar pjesën nga *Themeli Im*, për të ushtruar aftësitë tuaja dhe për të bërë zotime javore.

Këtu janë disa sugjerime që grupe të tjera i kanë parë të efektshme. Ju mund t'i përdorni këto sugjerime ose të dilni me variantet tuaja të mbledhjeve. Modele rendi dite gjenden në faqen vii.

- Mundësia 1:** Takohuni për 8–9 orë në mbledhjen e parë për t'i plotësuar të gjithë kapitujt. Mandej takohuni çdo javë rreth një orë në secilën nga 11 javët e mbetura.
- Mundësia 2:** Takohuni dy herë nga 4–5 orë brenda dy javëve të para për t'i plotësuar të gjithë kapitujt. Mandej takohuni çdo javë rreth një orë në secilën nga 10 javët e mbetura.
- Mundësia 3:** Takohuni katër herë nga 2–3 orë brenda dy javëve të para për t'i plotësuar të gjithë kapitujt. Mandej takohuni çdo javë rreth një orë në secilën nga 10 javët e mbetura.
- Mundësia 4:** Takohuni për 2 orë çdo javë, duke bërë një kapitull në javë. Do të duhen 10 javë për t'i plotësuar të gjithë kapitujt. Takohuni çdo javë për rreth një orë në secilën nga 2 javët e mbetura.

PLANET E PUNËS

Mundësia 1

MBLEDHJA 1 (8-9 ORË)	MBLEDHJET 2-12 (1-1,5 ORË)
<i>Themeli Im</i> Kapitujt 1-10 Zotohuni	Raportoni <i>Themeli Im</i> Mprihini Aftësitë Tuaja Zotohuni

Mundësia 2

MBLEDHJA 1 (4-5 ORË)	MBLEDHJA 2 (4-5 ORË)	MBLEDHJET 3-12 (1-1,5 ORË)
<i>Themeli Im</i> Kapitujt 1-5 Zotohuni	Raportoni <i>Themeli Im</i> Kapitujt 6-10 Zotohuni	Raportoni <i>Themeli Im</i> Mprihini Aftësitë Tuaja Zotohuni

Mundësia 3

MBLEDHJA 1 (3 ORË)	MBLEDHJA 2 (2-3 ORË)	MBLEDHJA 3 (3 ORË)	MBLEDHJA 4 (2 ORË)	MBLEDHJET 5-14 (1-1,5 ORË)
<i>Themeli Im</i> Kapitujt 1-3 Zotohuni	Kapitujt 4-6	Raportoni <i>Themeli Im</i> Kapitujt 7-8 Zotohuni	Kapitujt 9-10	Raportoni <i>Themeli Im</i> Mprihini Aftësitë Tuaja Zotohuni

Mundësia 4

MBLEDHJA 1 (2 ORË)	MBLEDHJET 2-10 (2 ORË)	MBLEDHJET 11-12 (1-1,5 ORË)
<i>Themeli Im</i> Kapitulli 1 Zotohuni	Raportoni <i>Themeli Im</i> Kapitujt 2-10 (1 në javë) Zotohuni	Raportoni <i>Themeli Im</i> Mprihini Aftësitë Tuaja Zotohuni





1

ÇËSHTJET BAZË

PARIMET, AFTËSITË DHE SHPREHITË E KËRKIMIT PËR VEND PUNE

1. Veproni me Besim
2. Përqendrojeni Kërkimin Tuaj
3. Punoni Fort: Përcaktoni Burime dhe Bëni Kontakte

UDHËZIMET E FILLIMIT – Koha Maksimale: 15 Minuta

Bëni një lutje hapjeje.

Paraqitni vetveten. Secili prej jush përdorni një minutë që të thoni emrin tuaj dhe diçka rreth vetes.

MIRË SE VINI NË GRUPIN TONË TË MBËSHTETJES TE VETJA!

Lexoni: Formula për kërkim të suksesshëm për vend pune është:

Veproni me Besim + Punoni Fort + Punoni me Mençuri = Sukses

Së bashku me grupin tuaj dhe i ndihmuar nga drejtimi i Shpirtit, ju do të mësoni përse besimi është themeli i një kërkimi për vend pune dhe ju do të ftoheni të punoni fort. Ju do të mësoni edhe aftësitë që duhen për punë me mençuri, të tilla si krijimi i rrjetit, përputhja e aftësive tuaja me nevojat e punëdhënësit, pohimet e fuqisë, materialet e shkruara, aftësitë intervistuese dhe më shumë. Në fillim të çdo mbledhjeje, ju do të rishikoni një parim të ungjillit që do t'ju ndihmojë në të gjitha fushat e jetës suaj.

SI FUNKSIONON KJO?

Lexoni: Grupet e mbështetjes të vetja funksionojnë si këshill. Atje nuk ka mësues apo ekspert. Në vend të kësaj, ju ndiqni materialet siç janë shkruar. Me drejtimin e Shpirtit, ju do ta ndihmoni njëri-tjetrin si më poshtë:

- Jepni ndihmesë njësoj në diskutime dhe veprimtari. Askush, veçanërisht ndërmjetësi, nuk duhet ta mbizotërojë bashkëbisedimin.
- Duajeni dhe përkraheni njëri-tjetrin. Tregoni interesim, bëni pyetje dhe mësoni rreth njëri-tjetrit.
- Bëni komente pozitive dhe domethënëse.
- Bëni dhe mbani besëlidhjet.

Plaku M. Rasëll Ballard na mësoi: “Nuk ka problem në familje, lagje apo kunj që nuk mund të zgjidhet nëse i kërkojmë zgjidhjet sipas mënyrës së Zotit duke u këshilluar – duke u këshilluar vërtet – me njëri-tjetrin” (*Counseling with Our Councils*, botim i rishikuar [2012], f. 4).

Shikoni: “My Self-Reliance Group” [“Grupi im i Mbështetjes të Vetja”], në dispozicion të srs.ids.org/videos. (Nuk keni material filmik? Kaloni te “Pa Mësues, si do ta Dimë se Çfarë të Bëjmë?” te faqja 4.)

Diskutoni: Çfarë e bëri grupin të materiali filmik kaq të suksesshëm? Çfarë do të bëni si grup për të pasur një përvojë jetëndryshuese?

PA MËSUES, SI DO TA DIMË SE ÇFARË TË BËJMË?

Lexoni: Është e lehtë. Thjesht ndiqni materialet. Çdo kapitull në fletoren e punës ka gjashtë pjesë:

Raportoni: Diskutoni përparimin që bëtë gjatë javës në zotimet tuaja.

Themeli: Rishikoni një parim të ungjillit që do të çojë te një mbështetje shpirtërore më e madhe te vetja.

Mësoni: Mësoni aftësi praktike që do të çojnë te një mbështetje materiale më e madhe te vetja.

Përsiatni: Dëgjoni Frymën e Shenjtë që t'ju ofrojë frymëzim.

Zotohuni: Premtoni të veproni sipas zotimeve gjatë javës gjë që do t'ju ndihmojë të përparoni.

Veproni: Gjatë javës ushtroni atë që mësuat.

SI TË PËRDORET KJO FLETORË PUNE

KUR T'I SHIHNI KËTO NXITJE, NDIQINI KËTO UDHËZIME				
LEXONI	SHIHNI	DISKUTONI	PËRSIATNI	VEPRIMTARI
Një person lexon me zë të lartë për të gjithë grupin.	I gjithë grupi shikon materialin filmik.	Pjesëtarët e grupit japin mendime për dy deri katër minuta.	Individët qetësisht marrin parrasysh, meditojnë dhe shkruajnë për dy ose tri minuta.	Pjesëtarë të grupit punojnë individualisht ose me të tjerë gjatë kohës së caktuar.

CERTIFIKATË PËRFUNDIMI

Lexoni: Anëtarët e grupit që marrin pjesë në mbledhje dhe i mbajnë zotimet e tyre, mund të marrin një certifikatë të mbështetjes te vetja nga Kolegji i Biznesit SHDM. Shihni faqen 251.



THEMELI IM – Koha Maksimale: 20 Minuta

Lexoni: Fillojeni mbledhjen duke plotësuar parimin 1 të *Themeli Im* në faqen 4. Më pas kthehuni te faqja 6 e kësaj fletoreje pune.





MËSONI – Koha Maksimale: 45 Minuta

VEPRIMTARI (5 minuta)


Secili të ngrihet në këmbë. Ndërveproni me grupin tuaj dhe diskutoni sa vijon me të paktën tre veta:

- Çfarë po bënit për të kërkuar vend pune dhe si ka funksionuar?
- Cilat janë sukseset dhe zhgënjimet tuaja?
- Çfarë shpresoni të merrni nga ky grup?

Lexoni: Formula për kërkim të suksesshëm për vend pune është:

Veproni me Besim + Punoni Fort + Punoni me Mençuri = Sukses

Gjatë këtij libri, ju do të ndiqni një shteg që do t'ju ndihmojë të veproni në besim, të punoni fort dhe të mësoni aftësitë e kërkimit të vendit të punës që të punoni me mençuri. Duke u nisur nga fundi i grafikut, me radhë, lexoni secilën pjesë të figurës Shtegu drejt Një Vendi Pune më të Mirë më poshtë:



Lexoni: Ne do të fillojmë me bazat e besimit e të punuarit fort.

1. VEPRONI ME BESIM

Lexoni: Themeli i kërkimit të suksesshëm për vend pune është besimi. Për Atin Qiellor, të gjitha gjërat, përfshirë kërkimi për punë, janë shpirtërore. Zoti ka thënë: “Unë ju them se gjithë gjërat për mua janë shpirtërore dhe asnjëherë nuk ju kam dhënë një ligj që është tokësor” (DeB 29:34).

Ngaqë marrja e një vendi pune është e rëndësishme si shpirtërisht edhe materialisht, çdo gjë që bëni për kërkimin e një vendi pune mund të jetë një veprim besimi. Ju shpresoni dhe luteni që Perëndia do t’ju bekojë me një vend pune, por veproni që ta shfaqni besimin tuaj.

Diskutoni: Çfarë lidhje ka besimi me kërkimin për një vend pune?

2. PËRQENDROJENI KËRKIMIN TUAJ



Kërkimi i Xhoshit për Vend Pune

Lexoni: Gjatë gjithë mbledhjeve të grupit tonë, ne do ta vërejmë dhe trajnojmë Xhoshin ndërsa ai përpiqet të zbatojë parimet dhe aftësitë e një kërkimi të efektshëm për vend pune. Xhoshin e shkurtuan nga puna dy muaj më parë pas dy vitesh si teknik shërbimi kompjuterash. Ai është i martuar dhe studion për shkenca kompjuterike. Ka një bashkëshorte dhe një fëmijë për t’i mbajtur. Xhoshi ka nevojë të gjejë një vend pune.

Xhoshi po has një kohë të vështirë për ta ditur se ku ta fillojë kërkimin e tij për vend pune. Ka aplikuar për të gjitha llojet e vendeve të punës. Javën e kaluar ai aplikoi për kamerier, agjent shërbimi klientësh, teknik kompjuterash dhe punëtor magazine. Gjithsesi, ai nuk ka pasur shumë sukses.

Diskutoni: Si lidhet përvoja juaj e kërkimit për vend pune me të Xhoshit?

Lexoni: Fillojeni kërkimin tuaj për vend pune duke ditur çfarë vendi pune doni. Duhet të jetë diçka për të cilën jeni të kualifikuar. Shumë punëkërkuës nuk arrijnë ta bëjnë këtë. Njësoj si Xhoshi, ata humbasin kohë duke marrë parasysh të gjitha llojet e vendeve të punës. Do të gjeni më shpejt vend pune nëse përqendroheni vetëm te disa lloje punësh.

Nëse nuk e dini se çfarë vendi pune doni, harxhoni pak kohë duke biseduar me njerëz të tjerë dhe duke gjetur informacion të dobishëm për ta kuptuar shpejt. Shumë punëkërkuës marrin një **punë stabilizuese** për të mbështetur veten, ndërkohë që kërkojnë ose përgatiten për një punë më të mirë. Nëse ky është rasti për ju, kujtoni këtë këshillë nga Presidenti Spenser W. Kimball: "Puna sjell lumturi, vetëvlerësim dhe begati. Ajo është mjeti i të gjitha arritjeve; ajo është e kundërta e përtacisë. Ne jemi urdhëruar të punojmë" (*Teachings of Presidents of the Church: Spencer W. Kimball* [2006], f. 118–119). Puna është fisnike.

Xhoshi kupton se do të ketë më shumë sukses nëse përqendrohet te pozicionet për shërbim kompjuterash. Ajo bëhet synimi i tij i punësimit.

VEPRIMTARI (3 minuta)

Shkruani tri vende pune të dëshiruara tek të cilat do të përqendroheni në kërkimin tuaj për vend pune. Pastaj tregojani grupit tuaj. Nëse jeni i pasigurt te cilat vende pune të përqendroheni, përpiquni ta kuptoni këtë përpara mbledhjes tjetër.

1. _____
 2. _____
 3. _____
-

3. PUNONI FORT: PËRCAKTONI BURIME DHE BËNI KONTAKTE



Kërkimi i Xhoshit për Vend Pune

Lexoni: Xhoshit nuk i ka pëlqyer të kërkojë punë. Ai kalon disa orë çdo ditë, kryesisht duke parë lajmërimi për vende pune në internet dhe duke biseduar me agjenci punësimi.

Diskutoni: Çfarë mendoni rreth nivelit të përpjekjes së Xhoshit? Sa kohë mendoni se do t'i duhet atij të gjejë një vend pune me këtë mënyrë?

Lexoni: Punëkërkuesit e suksesshëm punojnë fort. Ju merrni nga kërkimi për vend pune atë që shpenzoni për të. Sa më fort punoni, aq më shpejt e gjeni një vend pune. Puna juaj duhet të përbëhet nga gjetja e burimeve dhe bërja e kontakteve çdo ditë.

Një **burim** është çfarëdo burim informacioni apo lidhjeje që do të japë ndihmesë në një kërkim të suksesshëm për vend pune. Ai mund të jetë një person, vend apo send.

Një **kontakt** është çfarëdo komunikim punësimi me një burim. Ky mund të jetë një takim me dikë ballë për ballë, bërja e një telefonate, dërgimi i një postimi elektronik, dorëzimi i një aplikimi ose jetëshkrimi, ose dërgimi i një shënimi për ndjekje ecurie.

Sa më shumë burime të gjeni dhe kontakte të bëni, aq më shpejt do të gjeni një vend pune. Gjeni 15 burime të reja dhe bëni 10 kontakte çdo ditë për ta përshpejtuar jashtë mase kërkimin tuaj për vend pune.



Kërkimi i Xhoshit për Vend Pune

Lexoni: Sapo Xhoshi mësoi rreth burimeve dhe kontakteve, ai filloi të veprojë.

Për shembull, dje ai bëri sa vijon:

- Zbuloi tri kompani për të cilat është i interesuar.
- Gjeti tri faqe interneti të dobishme.
- Mendoi për shtatë njerëz me të cilët mund të vihej në kontakt (miq, shokë klase dhe ish-bashkëpunëtorë).
- Gjeti dy vende pune të hapura.

Kjo do të thotë 15 **burime** në vetëm një ditë!

Pastaj ai u vu në kontakt me ato burime:

- Duke u telefonuar tri kompanive drejtpërdrejt që të mësonte më shumë rreth tyre.
- Duke i takuar, duke u dërguar mesazhe me postë elektronike apo me telefon katër miqve të tij që t'u njoftonte se po kërkonte punë.
- Duke aplikuar për ato dy vende pune të hapura.
- Duke ndjekur ecurinë me dikë në të dy kompanitë për t'u siguruar që u mor informacioni i tij.

Kjo do të thotë 11 **kontakte** në vetëm një ditë!

Lexoni: Tani që kemi një listë me burime të mundshme, hapi ynë pasues është të vihemi në kontakt me to.

VEPRIMTARI (8 minuta)

Si grup diskutoni si do të viheshit në kontakt me burimet që sapo treguat. Shkruani idetë në kolonën e dytë të tabelës në faqen e mëparshme. Mbani mend, kontakt është çfarëdo lloj komunikimi me një burim.

Këshillë: Mbajini burimet dhe kontaktet tuaja të organizuara me formularët te faqet 194–196 të shtojcës.

Diskutoni: Si do të shfaqë besim të punuarit fort në kërkimin tuaj për vend pune?

PËRFUNDIM

Shikoni: “It Was a Miracle” [“Ishte një Mrekulli”], në dispozicion te srs.ids.org/videos. (Nuk keni material filmik? Lexojeni faqen 18.)



Diskutoni: Cilat ishin disa nga gjërat më të rëndësishme që mësuat nga ky kapitull?

Lexoni: Një kërkim i suksesshëm për vend pune ndjek këtë formulë të thjeshtë:

Veproni me Besim + Punoni Fort + Punoni me Mençuri = Sukses

Filloni ta zbatoni menjëherë formulën duke përcaktuar **burime** dhe bërë **kontakte** çdo ditë. Kjo shfaq besimin tuaj. Kërkojini Atit Qiellor t’ju ndihmojë e ta njohë punën tuaj si veprim besimi dhe Ai do t’ju bekojë me sukses. Në disa kapituj në vijim do të fillojmë të shqyrtojmë aftësitë që do të na ndihmojnë të punojmë me mençuri.



PËRSIATNI – Koha Maksimale: 5 Minuta

Individualisht mendoni rreth asaj që keni mësuar sot, dhe merrni parasysh se çfarë do të donte Zoti të bënit. Lexoni shkrimin e shenjtë ose citimin më poshtë dhe shkruani përgjigje për pyetjet.

“Sepse toka është plot dhe ka mjaft edhe për të kursyer; po, unë i përgatita të gjitha gjërat dhe u kam dhënë fëmijëve të njerëzve që të jenë veprues për veten e tyre” (DeB 104:17).

Cilat janë gjërat më domethënëse që mësova sot?

Çfarë do të bëj si rezultat i asaj që mësova sot?

PARTNERËT NË VEPRIM

Lexoni: Me ndihmën e të tjerëve ju mund të arrini gjëra të mëdha. Për shembull, misionarët kanë shokë për përkrahje. Në grupet tona, ne kemi “partnerë në veprim”. Çdo javë ne do të zgjedhim një partner në veprim dhe do të punojmë me të. Partnerët në veprim e ndihmojnë njëri-tjetrin për të mbajtur zotimet:

- Duke i telefonuar, dërguar mesazhe me telefon ose vizituar njëri-tjetrin gjatë javës.
- Duke biseduar rreth asaj që mësuam në grup.
- Duke nxitur njëri-tjetrin për të mbajtur zotimet.
- Duke u këshilluar së bashku rreth sfidave.
- Duke u lutur për njëri-tjetrin.

Diskutoni: Në ç’mënyrë ju ka ndihmuar dikush për të arritur diçka të vështirë?

Lexoni: Të qenit partner në veprim nuk është gjë e vështirë apo që kërkon shumë kohë. Për ta filluar bashkëbisedimin, ju mund të pyetni:

- Çfarë ju pëlqeu nga mbledhja jonë e fundit e grupit?
- Çfarë gjërash të mira ju kanë ndodhur gjatë kësaj jave?
- Si e keni përdorur parimin nga Themeli Im këtë javë?

Pjesa më e rëndësishme e diskutimit do të jetë të ndihmoni njëri-tjetrin për të mbajtur zotimet. Ju mund të pyetni:

- Si jeni me zotimet tuaja?
- Nëse nuk i keni mbajtur disa prej tyre, a keni nevojë për ndihmë?
- Si mund t’i përkrah më mirë përpjekjet tuaja?

VEPRIMTARI (5 minuta)

Hapi 1: Zgjidhni dikë në grup që të jetë partneri juaj në veprim.

- Ju mund t'i ndërroni partnerët në veprim çdo javë nëse dëshirohet.
- Përgjithësisht, partnerët në veprim janë të së njëjtës gjini dhe nuk janë pjesëtarë të një familjeje.

Emri i partnerit në veprim

Informacion kontakti

Hapi 2: Shkruani se si dhe kur do të viheni në kontakt me njëri-tjetrin.

DIE	HËN	MAR	MËR	ENJ	PRE	SHT



ZOTOHUNI – Koha Maksimale: 10 Minuta

Nëse ky është kapitulli juaj i fundit për këtë javë, plotësoni pjesën “Zotohuni”. Ndryshe, kaloni te faqja 24.

Çdo javë ne marrim zotime. Kur të takohemi javën e ardhshme, do të fillojmë duke raportuar mbi zotimet tona. Lexojani çdo zotim me zë të lartë partnerit tuaj në veprim. Premtoni se do t'i mbani zotimet tuaja dhe më pas nënshkruani më poshtë. Shënoni synimet tuaja në tabelën te faqet ii-iii.

ZOTIMET E MIA

Ⓐ Do të përcaktoj së paku pesë burime çdo ditë. *Përzgjidhni synimin tuaj.*

Ditë/Javë	Ditë/Javë	Ditë/Javë	Ditë/Javë
5/25	10/50	15/75	20/100

Ⓑ Do të bëj të paktën tri kontakte çdo ditë. *Përzgjidhni synimin tuaj.*

Ditë/Javë	Ditë/Javë	Ditë/Javë	Ditë/Javë
3/15	5/25	7/35	10/50

Ⓒ Do të vihem në kontakt dhe do të mbështes partnerin tim në veprim.

Ⓓ Do ta ushtroj dhe tregoj parimin e sotëm nga Themeli Im.

Ⓔ Do të bëj dy prej ushtrimeve nga lista e Aftësive në faqen iii.

Nënshkrimi im

Nënshkrimi i partnerit në veprim



BURIMET

ISHTE NJË MREKULLI

Xhoni tregon atë që mësoi kur zbatoi formulën e suksesit në kërkimin e tij për vend pune.

Veproni me Besim + Punoni Fort + Punoni me Mençuri = Sukses

“Unë pata një punë të shkëlqyer dhe isha i mirë në të. Pronari im ishte i kënaqur me punën që bëja dhe ajo e bënte të lehtë të bëje punë të mirë për të. Gruaja ime dhe unë patëm dy vajza të mrekullueshme dhe një foshnjë që do të lindte së shpejti. Për një familje të re, dukej sikur kishim gjithçka që na duhej, sidomos një të ardhme të mirë.

Dhe atëherë gruaja ime u sëmur. Ne bëmë më të mirën që mundnim derisa mësuam se ajo kishte nevojë për kujdes mjekësor që ishte 800 kilometra larg. Kështu që sigurisht u zhvendosëm. Unë i sistemova atë dhe fëmijët dhe u ktheva te puna ime derisa të mund gjeja diçka më afër familjes. Nuk mendoja se do të zgjaste shumë; unë isha me kualifikim të mirë e më parë nuk kisha pasur kurrë probleme për të gjetur një vend pune. Isha i sigurt se mund ta zgjidhja vetë, por për disa arsye nuk munda të gjej gjë.

Javët u zgjatën në muaj. Unë po punoja në një qytet dhe kërkoja vend pune në një tjetër, e gjitha ndërkohë që shqetësohesha për gruan dhe familjen time. Ishte një betejë në humbje. Kisha nevojë për ndihmë. Unë nuk mund ta bëja i vetëm. Iu drejtova Atit tim në Qiell. Agjëroja dhe lutesha. Kërkimi im për vend punë u kthye në një ushtrim besimi. Punoja shumë fort, duke i kërkuar Zotit të më bekonte për përpjekjet e mia. Por shpejt e kuptova se puna e fortë nuk mjaftonte. Më duhej të punoja me më shumë mençuri. Kishte mënyra më të mira për kërkim vendi pune – aftësi që duhej t'i mësoja dhe t'i përmirësoja.

Kur gërshetova besimin, të punuarit fort dhe aftësitë e përmirësuara, gjërat u bënë më mirë. Fillova të merrem në intervista dhe atëherë doli një vend pune i shkëlqyer. Ishte tmerrësisht e vështirë të isha i veçuar nga familja ime dhe të kaloja përmes një kohe të tillë të vështirë. Por dha rezultat dhe unë mësova aq shumë. Kjo vërtet ishte një mrekulli për familjen time. Unë jam falënderues që e pata këtë përvojë dhe i jam aq mirënjohës Atit Qiellor që më bekoi gjatë gjithë rrugës.”

Kthehuni te faqja 13.



2

KRIJIMI I RRJETIT

PARIMET, AFTËSITË DHE SHPREHITË E KËRKIMIT PËR VEND PUNE

1. Si i Gjejnë Njerëzit në të Vërtetë Vendet e Punës
2. Bisedoni me Çdo Njeri
3. Unë në 30 Sekonda



RAPORTONI – Koha Maksimale: 25 Minuta

Nëse ky është kapitulli juaj i parë i kësaj jave, plotësoni pjesën “Raportoni”. Ndryshe, kaloni te faqja 24.

ZOTIMET E JAVËS SË SHKUAR

- Ⓐ Të gjej burime çdo ditë.
- Ⓑ Të bëj kontakte çdo ditë.
- Ⓒ Të vihem në kontakt dhe ta përkrah partnerin tim në veprim.
- Ⓓ Ta ushtroj dhe tregoj parimin e sotëm nga Themeli Im.
- Ⓔ Të ushtroj aftësi për kërkimin e një vendi pune.

HAPI 1: VLERËSONI VETVETEN (5 minuta)

Përdoreni tabelën “Vlerësimi i Përpjekjeve të Mia” në faqet ii-iii për të rishikuar zotimet tuaja të mbledhjes së fundit. Së pari, shkruani numrin e vërtetë të burimeve që gjetët dhe kontaktet që bëtë. Pastaj vlerësojeni individualisht përpjekjen tuaj për ta mbajtur secilin zotim duke i shenjuar me të kuqe, të verdhë apo të gjelbër.

VLERËSIMI I PËRPJEKJEVE TË MIA										AFTËSITË		
Data	Ⓐ I Përcakttoj Burimet Çdo Ditë		Ⓑ Krijoj Kontakte Çdo Ditë		Ⓒ Vihem në Kontakt dhe e Përkrah Partnerin Tim në Veprim	Ⓓ E ushtroj Parimin Themeli Im dhe ua Tregoj të Tjerëve	Ⓔ I Ushtroj Aftësitë për Kërkimin e një Vendi Pune (Zgjidhni dy nga lista e Aftësive)	LEGJENDA: ● Përpjekje Mësimore ● Përpjekje Mbrojtëse ● Përpjekje të Bërditshme				
	Syrimi Javor	Realizoj	Syrimi Javor	Realizoj				Aftësia 1	Përpjekja	Aftësia 2	Përpjekja	
Shëmbulli	25	21	25	27	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●
Java 1												
Java 2												
Java 3												
Java 4												
Java 5												
Java 6												
Java 7												
Java 8												
Java 9												
Java 10												
Java 11												
Java 12												

PËRSHËNI ZOTIN (KAP. 1)

- Luatni për ndihmë të posaçme për kërkimin tuaj për vend pune.
- Agjëroni për ndihmë të posaçme për kërkimin tuaj për vend pune.

LINE NË 25 SEKONDA (KAP. 2)

- Ushtrojeni pesë herë deklaratën tuaj “Unë në 30 Sekonda” dhe merri përfitime.
- Përdoret deklarata tuaj “Unë në 30 Sekonda” për përkrahje të ndihmës.

INTERVISTA INFORMIMI (SHITJA)

- Shkruani pesë pyetje për një intervistë informimi. Shihfaqjen 201.
- Ushtrojeni në të njëjtën mënyrë për informim dhe merri përfitime. Shihfaqjen 201.

PËRKOHINI AFTËSITË (KAP. 3)

- Shkruani pesë pyetje për vend pune dhe përkrahje aftësi tuaja me mësuesit e punëdhënësit.

POHIME FUGUE (KAP. 4)

- Shkruani 10 pohime të rrethimit tuaj.
- Thirrni të qatën në pohime tuaja dhe merri përfitime.

MATERIALI ME SHKRIM (KAP. 5)

- Shkruani 10 pohime të rrethimit tuaj.
- Shkruani një përkrahje dhe merri përfitime nga tre rrethim.
- Shkruani dy pohime tuaja për të filluar letrat përfundim.
- Shkruani një letër paraqitja dhe merri përfitime nga tre rrethim.

INTERVISTA (KAP. 6-7)

- Ushtrojeni deklaratën tuaj “Unë në 30 Sekonda” për dy intervista të mundshme.
- Ushtrojeni kërkimin e përgjigjeve në dy pyetje të intervistës dhe përkrahje për formë tuaj.
- Ushtrojeni pesë pyetje që mund të bëni në fund të një interviste.
- Përdoret tri mënyra të sëmundit të pyetjes më të mëdha të tërësive tuaja të fundit të një interviste.
- Ushtrojeni kërkimin e përgjigjeve për tri pyetje interviste dhe përkrahje nga intervistat tuaja.

HAPI 2: TREGOJINI GRUPIT (10 minuta)

Secili nga ju raporton se si shkoi me zotimet e veta duke treguar synimet e numrat realë dhe duke e deklaruar “të kuqe”, “të verdhë” ose “të gjelbër” përpjekjen e vet. Tregoni çfarë shkoi mirë dhe se si ju ndihmoi Ati Qiellor.

HAPI 3: ZGJIDHNI PARTNERË NË VEPRIM (2 minuta)

Zgjidhni një partner në veprim nga grupi për javën që vjen. Përgjithësisht, partnerët në veprim janë të së njëjtës gjini dhe nuk janë pjesëtarë të një familjeje.

Përdorni tani disa minuta për t’u takuar me partnerin tuaj në veprim. Prezantohuni vetë dhe diskutoni se si do të viheni në kontakt me njëri-tjetrin gjatë gjithë javës.

Emri i partnerit në veprim

Informacion kontakti

Shkruani se si dhe kur do të viheni në kontakt me njëri-tjetrin këtë javë.

DIE	HËN	MAR	MËR	ENJ	PRE	SHT

Plotësoni veprimtarinë në faqen pasuese.



THEMELI IM – Koha Maksimale: 20 Minuta


Nëse ky është kapitulli juaj i parë i javës, plotësoni parimin pasues të *Themeli Im* që gjendet në fund të këtij libri. Mandej kthehuni te faqja 24.





MËSONI – Koha Maksimale: 45 Minuta

SHTEGU DREJT NJË VENDI PUNE MË TË MIRË



VEPRIMTARI (5 minuta)

Secili të ngrihet në këmbë. Flisni me të paktën tre anëtarë të tjerë të grupit dhe tregojini njëri-tjetrit një përvojë në të cilën i treguat dikujt se po kërkonit për punë ose ndoshta iu qasët personalisht një punëdhënësi të mundshëm. Cilat ishin rezultatet?

Diskutoni: Çfarë mësuat nga përvojat e njëri-tjetrit?

Lexoni: Një kërkim i suksesshëm vendi pune ndjek një formulë të thjeshtë:

Veproni me Besim + Punoni Fort + Punoni me Mençuri = Sukses

Në kapitullin e mëparshëm, ju mësuat rreth besimit dhe të punuarit fort. Në këtë kapitull, ne do të fillojmë të mësojmë aftësitë për të punuar me mençuri. Ne do të fillojmë me krijimin e rrjetit.



Kërkimi i Xhoshit për Vend Pune

Lexoni: Xhoshi i ka gjeur në internet ose në agjenci punësimi të gjitha orientimet e tij për vend pune. Megjithatë, ai pothuajse nuk ka pasur sukses dhe shumicën e kohës nuk ka marrë asnjë përgjigje. Ai është i bindur se ka një mënyrë më të mirë për të gjetur një vend pune. Ai ka dëgjuar për gjëra si krijimi i rrjetit, por nuk është i sigurt çfarë është ai apo si t'ia fillojë.

Diskutoni: Si krahasohet përvoja juaj në kërkim të vendit të punës me të Xhoshit?

1. SI GJEJNË NJERËZIT VEND PUNE NË TË VËRTETË


Lexoni: Ju do të gjeni punë më shpejt nëse kërkonte në mënyrat më të efektshme.

Shikoni: "How Jobs Are Really Filled" ["Si Plotësohen në të Vërtetë Vendet e Punës"], në dispozicion te srs.ids.org/videos. (Nuk keni material filmik? Lexoni faqen 35.)




Lexoni: Krahasoni këta dy grafikë.

NË Ç'MËNYRË
KËRKOJNË PUNË NJERËZIT
Krijimi i Lidhjeve



NË Ç'MËNYRË I GJEJNË NJERËZIT
NË TË VËRTETË VENDET E PUNËS




Diskutoni: Ç'do të ndryshonte në kërkimin tuaj për vend pune nëse do të punonit më shumë për krijimin e një rrjeti?

2. BISEDONI ME KËDO

Lexoni: Krijimi i rrjetit është mënyra më e mirë për të gjetur vend pune. **Të krijosh rrjet** do të thotë të flasësh me njerëz që mund t'ju ndihmojnë të gjeni njerëz dhe organizata që kanë nevojë për aftësitë tuaja. I thoni kujtdo që po kërkon punë. Njerëzit do t'ju ndihmojnë. Presidenti Spenser W. Kimball tha: "Perëndia na vështron dhe kujdeset për ne. Por zakonisht është nëpërmjet një personi tjetër që Ai i plotëson nevojat tona" ("Small Acts of Service", *Ensign*, dhjetor 1974, f. 5).


Ndonjëherë ju nevojitet të punoni në rrjet nëpër shumë nivele për të gjetur personin me informacionin që ju nevojitet. Puna në rrjet nëpër nivele do të thotë t'u kërkohet njerëzve t'ju japin emrat e njerëzve të tjerë që mund të kenë informacion që mund t'ju ndihmojë. Ju mund të punoni në rrjet drejtpërdrejt, me telefon ose postë elektronike. Ju mund të përdorni gjithashtu faqe interneti të rrjeteve profesionale dhe shoqërore.



- Diskutoni:**
- Çfarë mund të ndodhte nëse do të bisedonit me secilin nga këta njerëz dhe biznese rreth vendit të punës që po kërkonti?
 - Si do të qe nëse do të flisnit me gjithë njerëzit e tjerë që njihni?

3. UNË NË 30 SEKONDA

Lexoni: Puna në rrjet me njerëz të tjerë jep rezultatin më të mirë nëse dini çfarë të thoni. Një deklaratë Unë në 30 Sekonda është mjete më i mirë për t'u vënë në kontakt me njerëz apo biznese. Ajo i ndihmon njerëzit të kuptojnë se çfarë vendi pune po kërkonti dhe si mund t'ju ndihmojnë. Ajo ndjek këto katër hapa.



Këshillë: Pyetje të Mundshme në Deklaratën Unë në 30 Sekonda

- Me kë do të më rekomandonit të flas?
- Çfarë mundësish dini për dikë si unë?
- Çfarë dini rreth _____ (kompania, sektori)?
- Çfarë biznese ka në zonë që po kërkojnë për _____ (lloji i vendit të punës ose pozicioni)?
- Cilin njihni që bën atë që bëj unë?



Kërkimi i Xhoshit për Vend Pune

Lexoni: Ja se si e përdori Xhoshi deklaratën Unë në 30 Sekonda për të krijuar rrjet me ungjin e tij, Dejvidin. Shënoni katër pjesët e veprimit.

“Ungji Dejvid, jam nipi juaj, ① Xhoshi. Si jeni? A keni një minutë? Ju mund të mos ta keni ditur këtë, por ② unë po kërkoj një vend pune të ri për shërbim kompjuterash. ③ Kam dy vjet përvojë dhe kam disa certifikata teknike. Në kompaninë time të fundit unë quhesha tekniku më i mirë i shërbimit për shkak të efektshmërisë sime. Unë jam i mirë në atë që bëj dhe më pëlqen puna. ④ Cilin njihni që mund të vihem në kontakt lidhur me mundësitë?”

VEPRIMTARI (5-8 minuta)

Tani ju do të krijoni deklaratën tuaj Unë në 30 Sekonda dhe do ta ushtroni atë.

Hapi 1: Secili nga ju shkruani katër pjesët e deklaratës suaj Unë në 30 Sekonda në hapësirat e mëposhtme:



Hapi 2: Pasi secili nga ju ta keni shkruar deklaratën tuaj Unë në 30 Sekonda, ngrihuni një nga një dhe prezantoheni veten me deklaratën tuaj Unë në 30 Sekonda. Caktoni dikë të matë kohën e secilit prezantim që të dini se sa afër jeni te 30 sekondat. Duartrokkitni dhe brohoritni pas çdo prezantimi.

Lexoni: Në kapitullin e mëparshëm ne mësuam rreth kontakteve. Mbani mend, **kontakt** është çdo komunikim punësimi me një burim. Jo të gjithë kontaktet janë të krijuara njësoj. Sa më personale që të mund t'i bëni kontaktet tuaja, aq më efektive do të jenë. Të folurit ballë për ballë me dikë është më i efektshëm sesa një postë elektronike apo mesazh me celular. Të paktën dy nga kontaktet tuaja ditore duhet të jenë ballë për ballë. Kjo është arsyeja përse një deklaratë Unë në 30 Sekonda mund të jetë kaq e fuqishme.

Deklarata juaj Unë në 30 Sekonda është një nga aftësitë për kërkim vendi pune që ju lejon të punoni me mençuri. Ju e dini se keni një deklaratë të mirë Unë në 30 Sekonda kur ajo çon qëndrueshëm te ndihma që ju nevojitet. Ushtroni shpesh deklaratën tuaj Unë në 30 Sekonda dhe merrni përshtypje. Le të fillojmë menjëherë!

VEPRIMTARI (5 minuta)


Hapi 1: Ngrihuni që të gjithë dhe ndahuni në dy rreshta ballë për ballë.

Hapi 2: Tregojani deklaratën tuaj Unë në 30 Sekonda personit përballë jush.

Hapi 3: Jepini shpejt përshtypje njëri-tjetrit:

- A e tregoi partneri/ja juaj vendin e punës të cilën ai ose ajo po kërkon?
- A e tregoi partneri/ja juaj përse ai ose ajo është i/e mirë për atë punë?
- A kërkoi ndihmë partneri/ja juaj? Në ç'mënyrë?
- A ishte afër te 30 sekonda?

Hapi 4: Secili në një rresht kalon pastaj pas një personi. Personi në fund qarkullon te fillimi i rreshtit. Rreshti tjetër nuk lëviz. Përsëritni hapat 1–3 derisa t'ia keni treguar deklaratën tuaj Unë në 30 Sekonda çdonjërit dhe të keni marrë përshtypje.



Diskutoni: Si do të ishte akt besimi puna në rrjet me deklaratën tuaj Unë në 30 Sekonda?

VEPRIMTARI (5 minuta)

Hapi 1: Secili nga ju zgjidhni një person nga lista tuaj e kontakteve të mundshme në faqen 28 dhe telefonojini atij ose asaj. Ia thoni deklaratën tuaj Unë në 30 Sekonda atij ose asaj dhe shihni se çfarë ndodh.

Hapi 2: Mblidhuni përsëri si grup dhe tregoni përvojat tuaja.

PËRFUNDIM

Shikoni: “Basketball Got Me a Job” [“Basketbolli më Dha Vend Pune”], në dispozicion te srs.lds.org/videos. (Nuk keni material filmik? Lexoni faqen 36.)



Diskutoni: Cilat janë gjërat më të rëndësishme që mësuat nga ky kapitull?

Lexoni: Një kërkim i suksesshëm për vend pune ndjek këtë formulë:

Veproni me Besim + Punoni Fort + Punoni me Mençuri = Sukses

Puna në rrjet kërkon besim dhe punë të fortë. Puna në rrjet është gjithashtu një mënyrë më e mençur për të gjetur vend pune dhe ju tani keni një mjet të shkëlqyer, deklaratën Unë në 30 Sekonda, që t’ju ndihmojë të filloni. Zoti ka premtuar: “Hapini gojët tuaja e ato do t’ju mbushen” (DeB 33:8). Tani dilni dhe bëjeni punën në rrjet një pjesë të përditshme të kërkimit tuaj për vend pune.

Për ide të mëtejshme për punën në rrjet, lexoni vetë gjatë kësaj jave faqet 197–202 te shtojca.



PËRSIATNI – Koha Maksimale: 5 Minuta

Individualisht mendoni rreth asaj që keni mësuar sot, dhe merrni parasysh se çfarë do të donte Zoti të bënit. Lexoni shkrimin e shenjtë ose citimin më poshtë dhe shkruani përgjigje për pyetjet.

“Hapini gojët tuaja e ato do t’ju mbushen dhe ju do të bëheni sikurse Nefi i lashtësisë, i cili udhëtoi nga Jeruzalemi në shkretëtirë. Po, hapini gojët tuaja e mos u kurseni dhe ju do të ngarkoheni me duaj mbi supe, sepse, ja, unë jam me ju” (DeB 33:8–9).
Cilat janë gjërat më domethënëse që mësova sot?

Çfarë do të bëj si rezultat i asaj që mësova sot?



ZOTOHUNI – Koha Maksimale: 10 Minuta

Nëse ky është kapitulli juaj i fundit për këtë javë, plotësoni pjesën “Zotohuni”. Ndryshe, kaloni te faqja 42.

Lexojani çdo zotim me zë të lartë partnerit tuaj në veprim. Premtoni se do t’i mbani zotimet tuaja dhe më pas nënshkruani më poshtë. Shënoni synimet tuaja në tabelën te faqet ii–iii.

ZOTIMET E MIA

(A) Do të përcaktoj së paku pesë burime çdo ditë. *Përzgjidhni synimin tuaj.*

Ditë/Javë	Ditë/Javë	Ditë/Javë	Ditë/Javë
5/25	10/50	15/75	20/100

(B) Do të bëj të paktën tri kontakte çdo ditë. *Përzgjidhni synimin tuaj.*

Ditë/Javë	Ditë/Javë	Ditë/Javë	Ditë/Javë
3/15	5/25	7/35	10/50

(C) Do të vihem në kontakt dhe do të mbështes partnerin tim në veprim.

(D) Do ta ushtroj dhe tregoj parimin e sotëm nga Themeli Im.

(E) Do të bëj dy prej ushtrimeve nga lista e Aftësive në faqen iii.

Nënshkrimi im

Nënshkrimi i partnerit në veprim



SI PLOTËSOHEN NË TË VËRTETË VENDET E PUNËS

Dëgjojeni se si e përshkruan ky punëdhënës mënyrën se si plotësohen në të vërtetë vendet e punës.

“Gabimi që bëjnë shumica e punëkërkuësve, është harxhimi i kohës duke dërguar jetëshkrim, kur duhet ta shpenzojnë kohën duke punuar në rrjet, duke u lidhur me njerëz kyç në fushën e tyre dhe duke ndërtuar marrëdhënie.

Si rekrutues, unë e ndihmova kompaninë tonë të plotësonte afro 1 000 vende të hapura vitin e kaluar. Ja se si u plotësuan.

Ne nuk e reklamua shumicën e vendeve tona të hapura. Në vend të kësaj, menaxheri i punësimit e kishte tashmë dikë në mend ose ndoshta një anëtar i ekipit të tij i rekomandonte dikë. Ai do të vihej në kontakt me mua dhe do të më njoftonte se kishte dikë që donte ta merrte në punë, dhe unë thjesht do ta vija procesin në lëvizje që atje.

Për pozicionet e reklamuar shpesh do të kishte të paktën njëqind vetë që kishin aplikuar për vendin e hapur. Zakonisht më telefononin menaxherët punësues që më kërkonin të veçoja aplikime të caktuara njerëzish që donin t’i intervistonin. Këta ishin njerëz që ata i njihnin, që u ishin rekomanduar ose me të cilët ishin vënë në kontakt tashmë. Ngaqë menaxheri dinte tashmë rreth këtyre njerëzve, ai e dinte se ata do të ishin një përputhje e shkëlqyer. Këta qenë njerëzit që zakonisht merrnin vendin e punës. Ne morëm disa njerëz nga masa e përgjithshme e aplikuesve, por ishte vetëm rreth 25% e rasteve.

Këshilla ime: krijoni rrjet. Ndërtojeni rrjetin tuaj. Mirëmbajeni rrjetin tuaj. Lidhuni me njerëzit që marrin vendime punësimi qoftë drejtpërdrejt ose nëpërmjet të tjerëve. Nëse punëkërkuësit do ta bëjnë këtë, ata do të marrin vende pune.”

Kthehuni te faqja 26.

BASKETBOLLI MË DHA VEND PUNE

Le të lexojmë se si deklarata Unë në 30 Sekonda e Rubenit e çoi te një vend pune i shkëlqyer nga rrjeti i tij.

“Unë kam qenë gjithmonë shumë punëtor, por ndonjëherë kjo nuk mjafton. Shkurtime më lanë pa vend pune dhe mendoja se gjersa isha shumë punëtor do të gjeja punë lehtësisht. Problemi ishte se pata disa pengesa në biografinë time që po e bënë të vështirë të kisha intervista. Dukej sikur nuk do të shkoja kurrë më tej se aplikimet. Kaluan disa javë dhe isha i mërziur dhe i shkurajuar. Atëherë mësova rreth krijimit të rrjetit dhe mendova se ky mund të ishte kyçi im për të pasur një mundësi. E ushtrova deklaratën time Unë në 30 Sekonda herë pas here dhe fillova të flas me çdo njeri – duke i njoftuar se po kërkoja mundësi menaxhimi në ndërtim, se cilat ishin aftësitë e mia dhe me sa përvojë isha.

Një mbrëmje po luaja basketboll me disa miq. Kuptova se secili prej tyre njihnte plot njerëz dhe mund të ishte në gjendje të më ndihmonte të gjeja punë, kështu që u thashë deklaratën time Unë në 30 Sekonda. Për befasinë time, njëri prej tyre tha se bashkëshortja e tij punonte për një firmë ndërtimi dhe t’ia dërgoja asaj jetëshkrimin tim. Unë e bëra këtë dhe e ndoqa ecurinë me të të nesërmen. Ajo tha se do t’ia dorëzonte një grupi të sektorit të cilit i përkiste. Disa ditë më vonë më telefonoi një burrë që nuk e njihja. Ai kishte jetëshkrimin tim dhe donte të fliste me mua. Ai menaxhonte një firmë të madhe ndërtimi. Përfundimisht ajo çoi në një vend pune të shkëlqyer. Vendi im i punës nuk ishte publikuar kurrë dhe erdhi nga dikush dy ose tre nivele thellë në rrjetin tim. Unë kurrë nuk do ta kisha marrë këtë mundësi nëse nuk do ta kisha hapur gojën dhe të thosha deklaratën time Unë në 30 Sekonda. Çdo njeri ka një rrjet; përdoreni atë që të përhapni fjalën.”

Kthehuni te faqja 32.



3

PËRPUTHINI AFTËSITË TUAJA ME NEVOJAT E PUNËDHËNËSIT

PARIMET, AFTËSITË DHE SHPREHITË E KËRKIMIT PËR VEND PUNE

1. Gjeni Nevojat e Punëdhënësit
2. Përputhini Aftësitë Tuaja



RAPORTONI – Koha Maksimale: 25 Minuta

Nëse ky është kapitulli juaj i parë i kësaj jave, plotësoni pjesën “Raportoni”. Ndryshe, kaloni te faqja 42.

ZOTIMET E JAVËS SË SHKUAR

- Ⓐ Të përcaktoj burime çdo ditë.
- Ⓑ Të bëj kontakte çdo ditë.
- Ⓒ Të vihem në kontakt dhe të mbështes partnerin tim në veprim.
- Ⓓ Ta ushtroj dhe tregoj parimin e sotëm nga Themeli Im.
- Ⓔ Të ushtroj aftësi për kërkimin e një vendi pune.

HAPI 1: VLERËSONI VETVETEN (5 minuta)

Përdoreni tabelën “Vlerësimi i Përppjekjeve të Mia” në faqet ii-iii për të rishikuar zotimet tuaja nga mbledhja e fundit. Së pari, shkruani numrin e vërtetë të burimeve që gjetët dhe kontaktet që bëtë. Pastaj vlerësojeni individualisht përppjekjen tuaj për ta mbajtur secilin zotim duke i shenjuar me të kuqe, të verdhë apo të gjelbër.

VLERËSIMI I PËRPPJEKJEVE TË MIA										AFTËSITË	
Data	Ⓐ I Përcaktoj Burimet Çdo Ditë			Ⓑ Krijoj Kontakte Çdo Ditë			Ⓒ Vihem në Kontakt dhe e Përkrah Partnerin Tim në Veprim	Ⓓ E ushtroj Parimin Themeli Im dhe ua Tregoj të Tjerëve	Ⓔ I Ushtroj Aftësitë për Kërkimin e një Vendi Pune (Zgjidhni dy nga lista e Aftësive)	LEGJENDA:	
	Synimi Javor	Realja	Përppjekja	Synimi Javor	Realja	Përppjekja				Aftësia 1	Përppjekja
Shm-bull	25	21	●●●●	25	27	●●●●	●●●●	●●●●	E ushtroj aftësi për kërkimin e një vendi pune	●●●●	●●●●
Java 1			●●●●			●●●●	●●●●	●●●●	Shkruaj 10 pohime të reja	●●●●	●●●●
Java 2			●●●●			●●●●	●●●●	●●●●		●●●●	●●●●
Java 3			●●●●			●●●●	●●●●	●●●●		●●●●	●●●●
Java 4			●●●●			●●●●	●●●●	●●●●		●●●●	●●●●
Java 5			●●●●			●●●●	●●●●	●●●●		●●●●	●●●●
Java 6			●●●●			●●●●	●●●●	●●●●		●●●●	●●●●
Java 7			●●●●			●●●●	●●●●	●●●●		●●●●	●●●●
Java 8			●●●●			●●●●	●●●●	●●●●		●●●●	●●●●
Java 9			●●●●			●●●●	●●●●	●●●●		●●●●	●●●●
Java 10			●●●●			●●●●	●●●●	●●●●		●●●●	●●●●
Java 11			●●●●			●●●●	●●●●	●●●●		●●●●	●●●●
Java 12			●●●●			●●●●	●●●●	●●●●		●●●●	●●●●

PËRFSHËNI ZOTIN (KAP. 1)

- Luatja për ndihmë të posaçme për kërkimin tuaj për vend pune.
- Agjencia për ndihmë të posaçme për kërkimin tuaj për vend pune.

LINE NË 25 SEKONDA (KAP. 2)

- Ushtrojeni pesë herë deklaratën tuaj "Unë në 30 Sekonda" dhe merri përfitimet.
- Përdoroni deklaratën tuaj "Unë në 30 Sekonda" për përkrahje të ndihmës.

INTERVISTA INFORMIMI (SHITJA)

- Shkruani pesë pyetje për të marrë informim.
- Shkruani 201.
- Ushtrojeni në të njëjtën mënyrë për informim dhe merri përfitimet. Shih faqen 201.

PËRKQINI AFTËSITË (KAP. 3)

- Shkruani pesë parafrazime për vendet tuaja dhe përkrahje të ndihmës tuaj me mjetet e punës.

POHIME FUGIE (KAP. 4)

- Shkruani 10 pohime të reja tuaja.
- Thirrni të qatën në pohime tuaja dhe merri përfitimet.

MATERIALI ME SHKRIM (KAP. 5)

- Shkruani 10 pohime të reja tuaja për kërkimin tuaj.
- Shkruani një parafrazim dhe merri përfitimet nga tre rrethet.
- Shkruani dy pohime tuaja për të filluar letrat parafrazim.
- Shkruani një letër parafrazim dhe merri përfitimet nga tre rrethet.

INTERVISTI (KAP. 6-7)

- Ushtrojeni deklaratën tuaj "Unë në 30 Sekonda" për dy intervista të mundshme.
- Ushtrojeni kërkimin e përgjigjeve në dy pyetje të intervistës dhe përkrahje të ndihmës tuaj.
- Ushtrojeni pesë pyetje që mund të bëhen në fund të një interviste.
- Përdoroni tri mënyra të reja të mundshme të pyetjeve të intervistës dhe merri përfitimet.
- Ushtrojeni kërkimin e përgjigjeve për tri pyetje interviste dhe merri përfitimet nga tre rrethet.

HAPI 2: TREGOJINI GRUPIT (10 minuta)

Secili nga ju raporton se si shkoi me zotimet e veta duke treguar synimet e numrat realë dhe duke e deklaruar “të kuqe”, “të verdhë” ose “të gjelbër” përpjekjen e vet. Tregoni çfarë shkoi mirë dhe se si ju ndihmoi Ati Qiellor.

HAPI 3: ZGJIDHNI PARTNERË NË VEPRIM (2 minuta)

Zgjidhni një partner në veprim nga grupi për javën që vjen. Përgjithësisht, partnerët në veprim janë të së njëjtës gjini dhe nuk janë pjesëtarë të një familjeje.

Përdorni tani disa minuta për t’u takuar me partnerin tuaj në veprim. Prezantohuni vetë dhe diskutoni se si do të viheni në kontakt me njëri-tjetrin gjatë gjithë javës.

Emri i partnerit në veprim

Informacion kontakti

Shkruani se si dhe kur do të viheni në kontakt me njëri-tjetrin këtë javë.

DIE	HËN	MAR	MËR	ENJ	PRE	SHT


Plotësoni veprimtarinë në faqen pasuese.

VEPRIMTARI (5-8 minuta)

Le ta ushtrojmë pohimin tonë Unë në 30 Sekonda.

Hapi 1: Ndahuni në grupe me të paktën tre veta, por jo më shumë se gjashtë.

Hapi 2: Secili person ngrihet dhe tregon deklaratën e vet Unë në 30 Sekonda duke ndjekur këta hapa:



Hapi 3: Jepini shpejt përshtypje njëri-tjetrit:

- A e treguan se çfarë vendi pune po kërkonin?
 - A e treguan se përse janë të mirë për të?
 - A kërkuan ndihmë? Në ç'mënyrë?
 - A ishte afër te 30 sekonda?
-



THEMELI IM – Koha Maksimale: 20 Minuta


Nëse ky është kapitulli juaj i parë i javës, plotësoni parimin pasues të *Themeli Im* që gjendet në fund të këtij libri. Mandej kthehuni te faqja 42.





MËSONI – Koha Maksimale: 45 Minuta

SHTEGU DREJT NJË VENDI PUNE MË TË MIRË



Lexoni: Një kërkim i suksesshëm për vend pune ndjek këtë formulë të thjeshtë:

Veproni me Besim + Punoni Fort + Punoni me Mençuri = Sukses

Në kapitullin e mëparshëm mësuat se krijimi i rrjetit është mënyra më e mirë për të gjetur vend pune. Por kur e gjeni një orientim të mirë për vend pune, çfarë duhet të bëni së pari? Përputhini aftësitë tuaja me nevojat e punëdhënësit. Kjo është një aftësi tjetër kërkimi për vend pune që do t'ju ndihmojë të punoni me mençuri.



Kërkimi i Xhoshit për Vend Pune

Lexoni: Kur Xhoshi filloi kërkimin e tij për vend pune, ai e përditësoi jetëshkrimin e tij për të përfshirë gjithë përvojën dhe mandej ua bashkëngjiti aplikimeve të tij. Edhe pse aplikoi për shumë vende pune, ai nuk mori ndonjë përgjigje shumicën e kohës. A nuk mund ta shohin këta punëdhënës sa i mirë do të ishte ai në punë? A ka diçka që ai mund ta bëjë ndryshe?

Diskutoni: Në çfarë mënyrash mund të jeni të ngjashëm me Xhoshin?

Lexoni: Shumë punëkërkues i shkatërrojnë shanset e tyre që nga fillimi duke mos përcaktuar së pari nevojat e punëdhënësit dhe mandej të përputhin aftësitë e tyre me ato nevoja. Ata thjesht dërgojnë të njëjtin informacion për veten dhe mendojnë se punëdhënësi do ta kuptojë.

Fatkeqësisht, nuk funksionon kështu. Besojeni apo jo, kjo është diçka si të porositësh një picë.

Përfytyroni sikur keni qenë duke menduar gjithë ditën për një picë me sallam pikant. Ju nuk doni asnjë lloj tjetër pice – vetëm me sallam. Kështu që ju porositni një picë me sallam nga dyqani juaj i afërt i picave. Ju keni shumë uri dhe mezi pritni që të arrijë. Bie zilja e derës dhe ju hapni derën, paguani personin që e sjell dhe e çoni kutinë e pahapur të picës në kuzhinë. Ju e vendosni atë në tavolinë dhe e hapni dhe kjo është ajo që shihni:



Diskutoni: Sa kohë u desh që të kuptonit se kjo nuk ishte ajo që porositët?

Lexoni: Nëse nuk harxhoni kohën që së pari të përcaktoni dhe të përqendroheni te nevojat e punëdhënësit, ata ndoshta do t'ju përjashtojnë po aq shpejt sa e kuptuat ju që ishte një porosi me picën e gabuar. Kjo ka qenë pjesë e problemit të Xhoshit. Ai nuk dinte si të përqendrohej te nevojat e punëdhënësit. Ai po dërgonte jetëshkrim dhe aplikime me informacion që punëdhënësit nuk i interesonte. Punëkërkuesit e suksesshëm shpenzojnë kohë që të kuptojnë atë që ka porositur punëdhënësi; mandej ofrojnë aplikimin, jetëshkrimin apo intervistën e përsosur që t'u përgjigjen nevojave të punëdhënësit.

1. GJENI NEVOJAT E PUNËDHËNËSIT

Lexoni: Ka shumë burime që mund t'i përdorni për të gjetur nevojat e punëdhënësit.

- Faqe interneti dhe raportime të kompanisë
- Interneti
- Mjetet shoqërore të komunikimit
- Njerëz që punojnë në role të ngjashme
- Përshkrimi i vendit të punës

Diskutoni: Si mund t'ju ndihmojnë këto ose burime të tjera që të gjeni nevojat e një punëdhënësi?



Kërkimi i Xhoshit për Vend Pune

Lexoni: E mbani mend nga kapitulli i fundit se si Xhoshi i telefonoi ungjit të tij, Dejvidit? Pra, ungji Dejvid e ndihmoi vërtet. Ai e rekomandoi Xhoshin te një mikeshë e tij e quajtur Xhulia, që është menaxhere te një punëdhënësi i madh vendas, ABC Marketing. Xhoshi i telefonoi Xhulias dhe e prezantoi veten duke përdorur deklaratën e vet Unë në 30 Sekonda. Xhulias i bëri përshtypje! Xhulia i tha Xhoshit se po kërkonin një punonjës për shërbim të mirë për kompjuterët, por nuk e patën reklamuar hapjen pasi qenë shumë të zënë. Ajo i dërgoi Xhoshit përshkrimin e vendit të punës dhe i kërkoi t'i dërgonte jetëshkrimin e tij. Përpara se të aplikonte për pozicionin, Xhoshi vendos të sigurohet që e di se çfarë i nevojitet vërtet punëdhënësit.

VEPRIMTARI (4 minuta)

Ky është përshkrimi i vendit të punës që Xhuli i dërgoi Xhoshit. Ne do ta rishikojmë së bashku.

Hapi 1: Një person do të lexojë me zë përshkrimin e vendit të punës. Ndërsa personi lexon, anëtarët e grupit do të nënvizojnë, theksojnë apo shenjojnë aftësitë dhe kualifikimet kyç që dëgjojnë.

Hapi 2: Pastaj, si grup, diskutoni atë që shënuat dhe përse.

MODEL PËRSHKRIMI I VENDIT TË PUNËS

TEKNIK I KATEGORISË II NË ZYRËN E NDIHMËS

Ekipi i kompanisë ABC Marketing ka aktualisht në dispozicion një mundësi për një Teknik të Kategorisë II në Zyrën e Ndhmës.

Tekniku i Kategorisë II në Zyrën e Ndhmës do të jetë përgjegjës për administrimin e telefonatave dhe mesazheve elektronike për përkrahje. Ai/Ajo do të punojë me efektshmëri me përdoruesit dhe klientët përfundimtarë për të siguruar zgjidhje në kohën e duhur ndaj çështjeve dhe kërkesave për shërbim.

Përgjegjësitë:

- T'u përgjigjet telefonatave dhe mesazheve elektronike për përkrahje nga punonjësit dhe klientët e kompanisë ABC Marketing.
- Ta gjurmojë, ta regjistrojë dhe ta shohë prirjen e zgjidhjeve të çështjeve duke përdorur sistemin e biletave të zyrës së ndihmës.
- T'i zgjidhë çështjet teknike të klientëve personalisht dhe nëpërmjet telefonit.
- Të riparojë dhe zgjidhë problemet e pajisjeve fizike dhe të lidhjes në rrjete.
- T'i heqë pajisjet e vjetra dhe të kryejë transferimin e të dhënave tek aparatet e reja.
- Të administrojë inventarin dhe të ndjekë pronat e kompanisë ABC Marketing.
- T'i kryejë gjithë detyrat e tjera si t'i caktohet nga përgjegjësit e TI-së ose përgjegjësi i përkrahjes.

Kualifikimet:

- Dy ose më shumë vite përvojë praktike me pajisjet fizike ose programet e kompjuterëve.
- Parapëlqehet njohuri pune me programet aktuale Windows OS dhe Microsoft Office Suite.
- Parapëlqehet njohuri për funksionimin e pajisjeve dhe sistemeve TCP/IP, rrjeteve pa tel, LAN, WAN, mbrojtjes nga viruset dhe postës elektronike.
- Parapëlqehet përvojë me skedarët aktivë, serverët e dosjeve dhe ruajtjen në shirita të të dhënave.
- Me shtysë vetjake me aftësinë për të ndjekur ecurinë e projekteve në kohën e duhur.
- Sjellje profesionale; aftësi të mira shërbimi ndaj klientit personalisht dhe nëpërmjet telefonit.
- Aftësi për të punuar me orare të ndryshueshme.
- Aftësi të shkëlqyera komunikimi gojarisht, me shkrim dhe shkrimi teknik.
- Aftësi të shkëlqyera për zgjidhjen e problemeve dhe organizimi.
- Parapëlqehet diplomë kolegji.

ÇFARË TË PRITET:

- Nëse ofrohet punësimi, të gjithë punëmarrësit e rinj duhet të kalojnë [me sukses] përpara punësimit një kontroll të origjinës dhe analizë për përdorim droge.

Lexoni: Tani, krahasojeni atë që shenjuat me këtë. A ishit disi afër apo nuk i dalluat disa gjëra? Nëse nuk i dalluat disa gjëra, vazhdojeni ushtrimin dhe do të përmirësoheni.

MODEL PËRSHKRIMI I VENDIT TË PUNËS

TEKNIK I KATEGORISË II NË ZYRËN E NDIHMËS

Ekipi i kompanisë ABC Marketing ka aktualisht në dispozicion një mundësi për një Teknik të Kategorisë II në Zyrën e Ndihmës.

Tekniku i Kategorisë II në Zyrën e Ndihmës do të jetë përgjegjës për administrimin e telefonatave dhe mesazheve elektronike për përkrahje. Ai/Ajo do të punojë me efektshmëri me përdoruesit dhe klientët përfundimtarë për të siguruar zgjidhje në kohën e duhur ndaj çështjeve dhe kërkesave për shërbim.

Përgjegjësitë:

- Tu përgjigjet telefonatave dhe mesazheve elektronike për përkrahje nga punonjësit dhe klientët e kompanisë ABC Marketing.
- Ta gjurmojë, ta regjistrojë dhe ta shohë prirjen e zgjidhjeve të çështjeve duke përdorur sistemin e biletave të zyrës së ndihmës.
- T'i zgjidhë çështjet teknike të klientëve personalisht dhe nëpërmjet telefonit.
- Të riparojë dhe zgjidhë problemet e pajisjeve fizike dhe të lidhjes në rrjete.
- T'i heqë pajisjet e vjetra dhe të kryejë transferimin e të dhënave tek aparatet e reja.
- Të administrojë inventarin dhe të ndjekë pronat e kompanisë ABC Marketing.
- T'i kryejë gjithë detyrat e tjera si t'i caktohet nga përgjegjësit e TI-së ose përgjegjësi i përkrahjes.

Kualifikimet:

- Dy ose më shumë vite përvojë praktike me pajisjet fizike ose programet e kompjuterëve.
- Parapëlqehet njohuri pune me programet aktuale Windows OS dhe Microsoft Office Suite.
- Parapëlqehet njohuri për funksionimin e pajisjeve dhe sistemeve TCP/IP, rrjeteve pa tel, LAN, WAN, mbrojtjes nga viruset dhe postës elektronike.
- Parapëlqehet përvojë me skedarët aktivë, serverët e dosjeve dhe ruajtjen në shirita të të dhënave.
- Me shtysë vetjake me aftësinë për të ndjekur ecurinë e projekteve në kohën e duhur.
- Sjellje profesionale; aftësi të mira shërbimi ndaj klientit personalisht dhe nëpërmjet telefonit.
- Aftësi për të punuar me orare të ndryshueshme.
- Aftësi të shkëlqyera komunikimi gojarisht, me shkrim dhe shkrimi teknik.
- Aftësi të shkëlqyera për zgjidhjen e problemeve dhe organizimi.
- Parapëlqehet diplomë kolegji.

ÇFARË TË PRITET:

- Nëse ofrohet punësimi, të gjithë punëmarrësit e rinj duhet të kalojnë [me sukses] përpara punësimit një kontroll të origjinës dhe analizë për përdorim droge.

VEPRIMTARI (5 minuta)

Shikoni te përshkrimi i vendit të punës që sollët me vete ose mendoni rreth vendit të punës që doni. Përdorni pesë minuta për të bërë të njëjtën gjë që e bëtë me përshkrimin e vendit të punës së Xhoshit.

Hapi 1: Përcaktoni nevojat e punëdhënësit duke nënvizuar, theksuar ose shenjuar aftësitë dhe kualifikimet e rëndësishme.

Hapi 2: Rishikojeni me partnerin tuaj në veprim, duke theksuar atë që mendoni se ka nevojë punëdhënësi.

Këshillë: Kompania dhe përshkrimi i vendit të punës që gjetët, janë të dyja **burime**.

2. MPREHINI AFTËSITË TUAJA

Lexoni: Pasi të keni gjetur se çfarë do punëdhënësi, hapi i mëtejshëm është të kuptoni nëse përputhen aftësitë dhe përvoja juaj. Kjo është e thjeshtë si të pyesësh veten: “A e kam atë aftësi?” ose “Çfarë përvoja kam në bërjen e saj?” Sa më shumë shembujt apo arritje të mund të mendoni, aq më mirë.



Kërkimi i Xhoshit për Vend Pune

Lexoni: Kjo është mënyra se si filloi Xhoshi t'i përputhte aftësitë e tij me nevojat e punëdhënësit. Ai theksoi fjalinë vijuese në përshkrimin e vendit të punës:

- Të zgjidhë çështje teknike të klientëve personalisht dhe me telefon.

Ai mendoi me vete: “Unë jam vërtet mirë në këtë. Në vendin tim të fundit të punës, pata një sistem për ndreqjen e defekteve dhe kreu dy herë më shumë punë sesa teknikët e tjerë.” Ai pa gjithashtu disa aftësi kyç dhe kërkesa bazë që i plotësonte. Ai i qarkoi të gjitha aftësitë ose përvojat për të cilat ndiente se përputhej. Mbajti gjithashtu shënime rreth përvojës së tij dhe arritjeve përkatëse.

VEPRIMTARI (3 minuta)

Ky është përshkrimi i vendit të punës pasi Xhoshi përputhi aftësitë e tij dhe shtoi shënime.

Hapi 1: Në një minutë ose më pak, rishikoni individualisht se si e shenjoji Xhoshi përshkrimin e tij të vendit të punës.

Hapi 2: Si grup diskutoni se çfarë ju pëlqeu rreth mënyrës se si Xhoshi i përputhi aftësitë e tij me nevojat e punëdhënësit.

MODEL PËRSHKRIMI I VENDIT TË PUNËS

TEKNIK I KATEGORISË II NË ZYRËN E NDIHMËS

Ekipi i kompanisë ABC Marketing ka aktualisht në dispozicion një mundësi për një Teknik të Kategorisë II në Zyrën e Ndhmës.

Tekniku i Kategorisë II në Zyrën e Ndhmës do të jetë përgjegjës për administrimin e telefonatave dhe mesazheve elektronike për përkrahje. Ai/Ajo do të punojë me efektshmëri me përdoruesit dhe klientët përfundimtarë për të siguruar zgjidhje në kohën e duhur ndaj çështjeve dhe kërkesave për shërbim.

Përgjegjësitë:

- T'u përgjigjet telefonatave dhe mesazheve elektronike për përkrahje nga punonjësit dhe klientët e kompanisë ABC Marketing.
- Ta gjurmojë, ta regjistrojë dhe ta shohë prirjen e zgjidhjeve të çështjeve duke përdorur sistemin e biletave të zyrës së ndihmës.
- T'i zgjidhë çështjet teknike në klientëve personalisht dhe nëpërmjet telefonit.
- Të riparojë dhe zgjidhë problemet e pajisjeve fizike dhe të lidhjes në rrjete.
- T'i heqë pajisjet e vjetra dhe të kryejë transferimin e të dhënave tek aparatet e reja.
- Të administrojë inventarin dhe të ndjekë pronat e kompanisë ABC Marketing.
- T'i kryejë gjithë detyrat e tjera si t'i caktohet nga përgjegjësit e TI-së ose përgjegjësi i përkrahjes.

Kualifikimet:

- Dy ose më shumë vite përvojë praktike me pajisjet fizike ose programet e kompjuterëve.
- Parapëlqehet njohuri pune me programet aktuale Windows OS dhe Microsoft Office Suite.
- Parapëlqehet njohuri për funksionimin e pajisjeve dhe sistemeve TCP/IP rrjeteve pa tel, LAN, WAN, mbrojtjes nga viruset dhe postës elektronike.
- Parapëlqehet përvojë me skedarët aktivë, serverët e dosjeve dhe ruajtjen në shirita të të dhënave.
- Me shtysë vetjake me aftësinë për të ndjekur ecurinë e projekteve në kohën e duhur.
- Sjellje profesionale aftësi të mira shërbimi ndaj klientit personalisht dhe nëpërmjet telefonit.
- Aftësi për të punuar me orare të ndryshueshme.
- Aftësi të shkëlqyera komunikimi gojarisht, me shkrim dhe shkrimi teknik.
- Aftësi të shkëlqyera për zgjidhjen e problemeve dhe organizimi.
- Parapëlqehet diplomë kolegji.

ÇFARË TË PRITET:

- Nëse ofrohet punësimi, të gjithë punëmarrësit e rinj duhet të kalojnë [me sukses] përpara punësimit një kontroll të origjinës dhe analizë për përdorim droge.

Mbajta regjistër për t'i ndjekur dhe zgjidhur çështjet.

Krijova një sistem të shkëlqyer që më lejoi t'i zgjidh problemet dy herë më shpejt se teknikët e tjerë.

E kam bërë këtë në vendin tim të vjetër të punës.

Kam përdorur programin Excel për të administruar inventarin.

Kam dy vite përvojë, certifikata për infrastrukturën e serverëve MTCA, MCSA [Administrues Sistemesh i Certifikuar nga Microsoft-i], MCSE [Ekspert për Zgjidhje i Certifikuar nga Microsoft-i].

Punova me pak mbikëqyrje.

Jam i gatshëm të punoj mbrëmjeve dhe të shtunave.

Lexoni: Mbani mend se shumica e përshkrimeve të vendeve të punës janë lista më e plotë e dëshirave të punëdhënësit. Është në rregull nëse nuk përputheni me secilën aftësi apo kualifikim të renditur. Mos gënjeni ose i sajoni gjërat thjesht që të merrni një intervistë apo vend pune. Nëse shqyrtoni një mundësi për vend pune dhe mendoni se përputheni të paktën 50 për qind me atë që do punëdhënësi, ju duhet të aplikoni. Nëse përputheni të paktën 75%, me gjasa jeni kandidat i fortë.

VEPRIMTARI (5 minuta)

Shikoni te përshkrimi i juaj i vendit të punës ose mendoni për vendin e punës që dëshironi. Përdorni 5 minuta të bëni atë që bëri Xhoshi, duke qarkuar aftësitë që keni dhe duke bërë ndonjë shënim që do të ndihmojë. Pastaj bëhuni në dyshe me partnerin tuaj në veprim dhe tregojani atij apo asaj.

Diskutoni: Si do t'ju ndihmojë përputhja në këtë mënyrë e aftësive në kërkimin tuaj për vend pune?

PËRFUNDIMI

Shikoni: “The 16th Time Is the Charm” [“Hera e 16-të Doli me Sukses”], në dispozicion te srs.ids.org/videos. (Nuk keni material filmik? Lexojeni faqen 54.)



Diskutoni: Cilat janë gjërat më të rëndësishme që mësuat nga ky kapitull?

Lexoni: Përputhja e aftësive tuaja me nevojat e punëdhënësit është të punoni me mençuri.

Veproni me Besim + Punoni Fort + Punoni me Mençuri = Sukses

Përputhni aftësitë tuaja përpara se të bëni një aplikim për një pozicion, të shkruani një jetëshkrim ose të keni një intervistë. Nëse e bëni këtë, ju do të përjetoni sukses më të madh në kërkimin tuaj për vend pune.



PËRSIATNI – Koha Maksimale: 5 Minuta

Individualisht mendoni rreth asaj që keni mësuar sot, dhe merrni parasysh se çfarë do të donte Zoti të bënit. Lexoni shkrimin e shenjtë ose citimin më poshtë dhe shkruani përgjigje për pyetjet.

“Perëndia i ka dhënë secilit prej nesh një apo më shumë talente të veçanta. . . . Varet nga secili prej nesh të kërkojë për dhuratat që Perëndia i ka dhënë dhe t’i shtojë ato. Ne duhet të kujtojmë se secili prej nesh është bërë sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë, se nuk ka persona pa rëndësi. Secili ka rëndësi për Perëndinë dhe bashkënjëzitet e tij” (Marvin J. Ashton, “There Are Many Gifts”, *Ensign*, nëntor 1987, f. 20).

Cilat janë gjërat më domethënëse që mësova sot?

Çfarë do të bëj si rezultat i asaj që mësova sot?



ZOTOHUNI – Koha Maksimale: 10 Minuta

Nëse ky është kapitulli juaj i fundit për këtë javë, plotësoni pjesën “Zotohuni”. Përndryshe, kaloni te faqja 60.

Lexojani çdo zotim me zë të lartë partnerit tuaj në veprim. Premtoni se do t'i mbani zotimet tuaja dhe më pas nënshkruani më poshtë. Shënoni synimet tuaja në tabelën te faqet ii-iii.

ZOTIMET E MIA

Ⓐ Do të përcaktoj së paku pesë burime çdo ditë. *Përzgjidhni synimin tuaj.*

Ditë/Javë	Ditë/Javë	Ditë/Javë	Ditë/Javë
5/25	10/50	15/75	20/100

Ⓑ Do të bëj të paktën tri kontakte çdo ditë. *Përzgjidhni synimin tuaj.*

Ditë/Javë	Ditë/Javë	Ditë/Javë	Ditë/Javë
3/15	5/25	7/35	10/50

Ⓒ Do të vihem në kontakt dhe do të mbështes partnerin tim në veprim.

Ⓓ Do ta ushtroj dhe tregoj parimin e sotëm nga Themeli Im.

Ⓔ Do të bëj dy prej ushtrimeve nga lista e Aftësive në faqen iii.

Nënshkrimi im

Nënshkrimi i partnerit në veprim



BURIMET

HERA E 16-TË DOLI ME SUKSES

Lexoni: Le të lexojmë rreth mënyrës se si u përmirësua fuqishëm kërkimi i Isabelës për vend pune kur ajo filloi t’i përputhte aftësitë e saj me nevojat e punëdhënësit.

“Isha duke kërkuar punësim për më shumë se një muaj. Ishte një fabrikë në qytetin tim ku doja të punoja dhe ata kishin shpesh pozicione të lira. Unë isha e mirëkualifikuar për pozicionin, kështu që fillova të aplikoj. Aplikova 15 herë për të njëjtin pozicion, por nuk u thirra kurrë për intervistë. Sigurisht që po dërgoja të njëjtin jetëshkrim përsëri e përsëri duke pritur një rezultat të ndryshëm. Atëherë mësova rreth gjetjes së nevojave të punëdhënësit dhe kjo ndryshoi gjithçka.

Unë kontrollova përshkrimin e vendit të punës dhe gjeta aftësitë dhe përvojën kyç. Kur i shoh jetëshkrimin dhe aplikimin që pata dërguar, ato nuk ishin aspak afër asaj çka i nevojitej punëdhënësit. Nuk ishte çudi që nuk më patën telefonuar. Kështu që unë gjeta aftësitë dhe arritjet e mia që përputheshin me nevojat e punëdhënësit dhe aplikova për të 16-n herë. Dy ditë më vonë më telefonuan për intervistë! Ata më ofruan një pozicion sapo mbaroi intervista dhe unë fillova punë po atë javë. Përputhja e aftësive të mia me nevojat e punëdhënësit ishin çelësi për suksesin tim.”

Kthehuni te faqja 51.



4

POHIME FUQIE

PARIMET, AFTËSITË DHE SHPREHITË E KËRKIMIT PËR VEND PUNE

1. Lini Mbresa të Fuqishme
2. Ndiqni Formulën e Pohimit të Fuqisë



RAPORTONI – Koha Maksimale: 25 Minuta

Nëse ky është kapitulli juaj i parë i kësaj jave, plotësoni pjesën “Raportoni”. Përndryshe, kaloni te faqja 60.

ZOTIMET E JAVËS SË SHKUAR

- Ⓐ Të gjej burime çdo ditë.
- Ⓑ Të bëj kontakte çdo ditë.
- Ⓒ Të vihem në kontakt dhe të mbështes partnerin tim në veprim.
- Ⓓ Ta ushtroj dhe tregoj parimin e sotëm nga Themeli Im.
- Ⓔ Të ushtroj aftësi për kërkimin e një vendi pune.

HAPI 1: VLERËSONI VETVETEN (5 minuta)

Përdoreni tabelën “Vlerësimi i Përpjekjeve të Mia” në faqet ii-iii për të rishikuar zotimet tuaja të mbledhjes së fundit. Së pari, shkruani numrin e vërtetë të burimeve që gjetët dhe kontaktet që bëtë. Pastaj vlerësojeni individualisht përpjekjen tuaj për ta mbajtur secilin zotim duke i shenjuar me të kuqe, të verdhë apo të gjelbër.

VLERËSIMI I PËRPJEKJEVE TË MIA								AFTËSITË					
Data	Ⓐ I Përcakttoj Burimet Çdo Ditë		Ⓑ Krijoj Kontakte Çdo Ditë		Ⓒ Vihem në Kontakt dhe e Përkrah Partnerin Tim në Veprim	Ⓓ E ushtroj Parimin Themel (m dhe ua Tregoj të Tjerëve)	Ⓔ I Ushtroj Aftësitë për Kërkimin e një Vendi Pune (Zgjidhni dy nga lista e Aftësive)	LEGJENDA: ● Përpjekje Mëmirë ● Përpjekje Mëkëmb ● Përpjekje Mëkëq ● Përpjekje Mëkeq					
	Syrimi Javor	Realizoj	Syrimi Javor	Realizoj				Aftësia 1	Përpjekja	Aftësia 2	Përpjekja		
Shëmbull	25	21	25	27	●●●●	●●●●	●●●●	●●●●	●●●●	●●●●	●●●●	●●●●	●●●●
Java 1													
Java 2													
Java 3													
Java 4													
Java 5													
Java 6													
Java 7													
Java 8													
Java 9													
Java 10													
Java 11													
Java 12													

PËRSHËNI ZOTIN (KAP. 1)
 ● Luatja për ndihmë të posaçme për kërkimin tuaj për vend pune.
 ● Agjencitë për ndihmë të posaçme për kërkimin tuaj për vend pune.

LINE NË 30 SEKONDA (KAP. 2)
 ● Ushtrojeni pesë herë deklaratën tuaj “Line në 30 Sekonda” dhe merri përfitimet.
 ● Përdoret deklarata tuaj “Line në 30 Sekonda” për përkrahje të ndihmës.

INTERVISTA INFORMIMI (SHITËJA)
 ● Shikoni pesë pyetje për të marrë informim, Shihfaqjen 201.
 ● Shikoni në faqe informatat për informim dhe merri përfitimet. Shihfaqjen 201.

PËRKOHINI AFTËSITË (KAP. 3)
 ● Shikoni pesë përshkrimet për vendet tuaja dhe përkohini aftësitë tuaja me mjetet e përdoruesit.

POHIME FUQIE (KAP. 4)
 ● Shikoni 10 pohime të ndihmës tuaj.
 ● Thirrni të gatshëm në pohime tuaja dy gjelbra dhe merri përfitimet.

MATERIALI ME SHIKIM (KAP. 5)
 ● Shikoni 10 pohime të ndihmës tuaj.
 ● Shikoni një përshkrim dhe merri përfitimet nga tre rrethet.
 ● Shikoni dy pohime tuaja për të filluar letrat paraqitëse.
 ● Shikoni një listë paraqitëse dhe merri përfitimet nga tre rrethet.

INTERVISTI (KAP. 6-7)
 ● Ushtrojeni deklaratën tuaj “Line në 30 Sekonda” për të marrë informim të mundshme.
 ● Ushtrojeni kërkimin e përgjigjeve në pyetje për intervistën dhe përdorini pohime tuaja.
 ● Ushtrojeni pesë pyetje që mund të bëhen në fund të një interviste.
 ● Përdoret tri mënyra të shtuar të pyetjeve më të mëdha të tërësive të fundit të një interviste.
 ● Ushtrojeni kërkimin e përgjigjeve për tri pyetje interviste dhe përdorini rregullimet për postime.

HAPI 2: TREGOJINI GRUPIT (10 minuta)

Secili nga ju raporton se si shkoi me zotimet e veta duke treguar synimet e numrat realë dhe duke e deklaruar “të kuqe”, “të verdhë” ose “të gjelbër” përpjekjen e vet. Tregoni çfarë shkoi mirë dhe se si ju ndihmoi Ati Qiellor.

HAPI 3: ZGJIDHNI PARTNERË NË VEPRIM (2 minuta)

Zgjidhni një partner në veprim nga grupi për këtë javë që vjen. Përgjithësisht, partnerët në veprim janë të së njëjtës gjini dhe nuk janë pjesëtarë të një familjeje.

Përdorni tani disa minuta për t’u takuar me partnerin tuaj në veprim. Prezantohuni vetë dhe diskutoni se si do të viheni në kontakt me njëri-tjetrin gjatë gjithë javës.

Emri i partnerit në veprim

Informacion kontakti

Shkruani se si dhe kur do të viheni në kontakt me njëri-tjetrin këtë javë.

DIE	HËN	MAR	MËR	ENJ	PRE	SHT


Plotësoni veprimtarinë në faqen pasuese.

VEPRIMTARI (5-8 minuta)

Le ta ushtrojmë pohimin tonë Unë në 30 Sekonda.

Hapi 1: Ndahuni në grupe me të paktën tre veta, por jo më shumë se gjashtë.

Hapi 2: Secili person ngrihet dhe tregon deklaratën e vet Unë në 30 sekonda duke ndjekur këto hapa:



Hapi 3: Jepini shpejt përshtypje njëri-tjetrit:

- A e treguan se çfarë vendi pune po kërkonin?
 - A e treguan se përse janë të mirë për të?
 - A kërkuan ndihmë? Në ç'mënyrë?
 - A ishte afër te 30 sekonda?
-



THEMELI IM – Koha Maximale: 20 Minuta


Nëse ky është kapitulli juaj i parë i javës, plotësoni parimin pasues të *Themeli Im* që gjendet në fund të këtij libri. Pastaj kthehuni te faqja 60.





MËSONI – Koha Maksimale: 45 Minuta

**SHTEGU DREJT NJË
VENDI PUNE MË TË MIRË**



Lexoni: Një kërkim i suksesshëm për vend pune ndjek këtë formulë të thjeshtë:

Veproni me Besim + Punoni Fort + Punoni me Mençuri = Sukses

Në kapitullin e mëparshëm mësuat një aftësi që ju ndihmon të punoni me mençuri: si të përputhni aftësitë tuaja me nevojat e punëdhënësit. Në këtë kapitull do të mësoni një aftësi tjetër për të “punuar me mençuri”: pohimet e fuqisë.



Kërkimi i Xhoshit për Vend Pune

Lexoni: Xhoshi mund të shohë tani se ai është përshtatje e mirë për pozicionin e ndihmës teknike të ABC Marketing. Por ai është mjaft i sigurt se njerëz të tjerë mund të kenë të njëjtat kualifikime. Ajo që e ndihmon vërtet të dallohet, janë arritjet e tij, por nuk është krejt i sigurt se si të flasë rreth tyre. Ai pyet veten se çfarë mund të bëjë për të dalë në pah si zgjedhja e qartë.

Diskutoni: Në çfarë mënyrash mund të jeni të ngjashëm me Xhoshin?

1. LINI MBRESA TË FUQISHME

Lexoni: Mënyra më e mirë për të treguar se ju u përgjigjeni nevojave të punëdhënësit, është me një pohim fuqie. Një **pohim fuqie** përshkruan shkurt përvojat dhe arritjet tuaja të mëparshme duke treguar një shembull dhe rezultat konkret. Mendojini ato si histori të vogla. Njerëz të tjerë mund të kenë kualifikime të ngjashme, por askush nuk ka bërë saktësisht të njëjtat gjëra. Prandaj, në vend që të renditni aftësi të përgjithshme që kushdo mund t'i thotë, përdorni një pohim fuqie.

VEPRIMTARI (4 minuta)

Zgjidhni role dhe interpretoni tre shembujt vijues. Ndërsa bëni këtë, mendoni me vete: “Kush del në pah si zgjedhja e qartë?”

Shembulli i Keq

Intervistuesi: “Më tregoni rreth një kohe kur ofruat një shërbim të shkëlqyer ndaj klientit”.

Punëkërkuesi 1: “Mua vërtet më pëlqen shërbimi ndaj klientit dhe mendoj se jam mjaft i mirë aty. Përveç kur klientët janë mistrecë. Nuk dua të trajtohem në atë mënyrë. Pritni pak, a janë mistrecë klientët tuaj?”

Shembulli Mesatar

Intervistuesi: “Më tregoni rreth një kohe kur ofruat një shërbim të shkëlqyer ndaj klientit”.

Punëkërkuesi 2: “Shërbimi ndaj klientit është shumë i rëndësishëm për mua. Klientët janë çelësi i suksesit tonë të vazhdueshëm. Unë kam parë gjithmonë se, nëse i trajtoni klientët siç duhet, ata do t’ju shpërblejnë me biznes të vazhdueshëm. Kam shumë përvojë me shërbimin ndaj klientit dhe jam shumë i mirë për këtë. Klientët duan t’i dëgjojnë dhe ta dinë se i kanë dëgjuar. Është e rëndësishme që ne të bëjmë më të mirën që ta bëjmë siç duhet herën e parë dhe ta ndreqim sa më shpejt që është e mundur kur bëjmë gabim. Unë besoj te thënia se klienti ka gjithmonë të drejtë.”

Shembulli i Mirë

Intervistuesi: “Më tregoni rreth një kohe kur ofruat një shërbim të shkëlqyer ndaj klientit”.


Punëkërkuesi 3: “Unë jam shumë i aftë në shërbimin ndaj klientit. Për shembull, kur punoja për YZ Sales, ne patëm një klient afatgjatë, i cili, në një rast, nuk mori atë që pati porositur. Kur më telefanoi, ai ishte i nevrikosur dhe kërcënoi se do ta ndërpriste gjithë punën e tij me ne. Unë i kushtova kohë për ta dëgjuar dhe kuptuar gjendjen e tij dhe mandej ofrova një zgjidhje që i pëlqeu klientit. Si rezultat, ne jo vetëm që e mbajtëm klientin, por ai i shtoi porositë e tij te ne me 200 për qind. Unë jam i sigurt se po këto aftësi shërbimi ndaj klientit mund t’i vë në punë për ju.”

Diskutoni: Përse ishte më i miri shembulli i tretë?

Lexoni: Punëkërkuksi i tretë përdori pohim fuqie, që i mundësoi të flasë rreth diçkaje që ai ose ajo pati bërë vërtet në një mënyrë interesante, mbresëlënëse dhe tërësisht të veçantë. Ishte si një histori e shkurtër, e vërtetë. Ajo e ndihmoi punëkërkuksin e tretë të dilte në pah si zgjedhja e qartë.

2. NDIQNI FORMULËN E POHIMIT TË FUQISË

Lexoni: Pohimet e fuqisë ndjekin një formulë shumë të thjeshtë:



Pjesë e fuqisë në një pohim fuqie është se është e shkurtër. Dhënia e një pohimi fuqie nuk merr më shumë se 30 deri në 45 sekonda.



Kërkimi i Xhoshit për Vend Pune

Lexoni: Le të shohim një pohim fuqie që hartoi Xhoshi pasi pa përshkrimin e vendit të punës në ABC Marketing. Ai pa se punëdhënësi i nevojitej një person me aftësi të mira për ndreqje defektesh. Vini re se si e përdori ai formulën për krijimin e pohimit të tij të fuqisë.

① “Unë jam i shkëlqyer në ndreqjen e defekteve. ② Për shembull, si teknik i zyrës së ndihmës në IT World, unë zhvillova një proces të thjeshtë për të gjetur probleme të zakonshme teknike. ③ Si rezultat, në dy vite unë isha në gjendje të zgjidhja mbi 1 000 shqetësime në rreth gjysmën e kohës së grupit të kolegëve të mi. ④ Unë mund ta vë po këtë ekspertizë në punë për ju.”

Diskutoni: Si do ta ndihmojë Xhoshin pohimi i fuqisë që të dalë në pah si zgjedhja e qartë?

Lexoni: Ja disa modele pohimesh fuqie për një misionar të kthyer, një pronar biznesi të vogël dhe një nënë, të cilët që të gjithë po kërkojnë vend pune. Ata përdorën të katër hapat dhe përfshinë hollësi të veçanta për t'i forcuar pohimet e tyre të fuqisë. Lexojeni me radhë me zë secilën deklaratë.

<p>① DEKLARONI NJË AFTËSI OSE PËRVOJË</p> <p>("Unë jam . . .", "Unë mundem . . ." ose "Unë kam . . .")</p>	<p>② JEPNI NJË SHEMBULL</p> <p>("Për shembull . . .")</p>	<p>③ JEPNI NJË REZULTAT</p> <p>("Si rezultat . . .")</p>	<p>④ PËRPUTHENI AFTËSINË ME NEVOJAT E PUNËDHËNËSIT</p>
<p>Misionar i Kthyer</p> <p>Unë mund të ngre dhe të motivoj ekipe.</p>	<p>Për shembull, si vullnetar me kohë të plotë për Kishën time, m'u kërkua të drejtoja një ekip me tetë vullnetarë të tjerë, të cilët nuk ishin të bashkuar dhe nuk po i përmbushnin synimet. Unë i dallova nevojat dhe krijova një varg të posaçëm trajnimesh dhe zotimesh që t'i ndihmoja të përmirësoheshin.</p>	<p>Si rrjedhojë, grupi filloi t'i arrinte dhe pastaj t'i tejkalonte synimet e veta.</p>	<p>Mund t'i ndihmoj ekipet tuaja të bashkohen për t'i përmbushur dhe tejkaluar synimet.</p>
<p>Pronar Biznesi të Vogël</p> <p>Unë mund të zgjidh probleme.</p>	<p>Për shembull, në biznesin tonë familjar, na nevojitej një sistem për të ndjekur shpenzimet. Unë hartova një sistem ndjekjeje të ecurisë dhe dallova një furnitor që po na jepte fatura më të mëdha se ç'duhej.</p>	<p>Si rrjedhojë e sistemit tim, isha në gjendje t'i korrigoja mbiçmimet dhe i kurseva biznesit tonë më shumë se 5 000 dollarë në vit.</p>	<p>E di se mund t'i zbatoj po këto aftësi për zgjidhjen e problemeve për ju.</p>
<p>Nëna</p> <p>Unë kam aftësi të forta organizative.</p>	<p>Për shembull, si nënë, unë bashkërendoj me sukses detyrat e shkollës dhe veprimtaritë e tre fëmijëve. Kam mësuar t'ia dal me programet tona sipas orareve.</p>	<p>Si rrjedhojë, fëmijët e mi rrallë nuk e përmbushin një detyrë apo arrijnë vonë në një veprimtari.</p>	<p>Mund t'i përdor po ato aftësi organizimi për të siguruar që të mos ta humbisni asnjëherë një takim.</p>

VEPRIMTARI (5 minuta)

Merrni disa minuta dhe përdoreni këtë skemë për të krijuar disa pohime fuqie. Pastaj lidhuni me partnerin tuaj në veprim për t'ia treguar.

Ndiqni Formulën:

<p>① DEKLARONI NJË AFTËSI OSE PËRVOJË ("Unë jam . . .", "Unë mundem . . ." ose "Unë kam . . .")</p>	<p>② JEPNI NJË SHEMBULL ("Për shembull . . .")</p>	<p>③ JEPNI NJË REZULTAT ("Si rezultat . . .")</p>	<p>④ PËRPUTHENI AFTËSINË ME NEVOJAT E PUNËDHËNËSIT</p>

Diskutoni: Çfarë mësuat nga tregimi i pohimit/eve tuaj/a të fuqisë?

Lexoni: Pohimet e fuqisë janë aftësi në kërkim vendi pune që do t'ju ndihmojnë të punoni me mençuri. Ju do ta dini se po i bëni si duhet nëse pohimet tuaja të fuqisë çojnë në interes më të madh të punëdhënësit. Pohimet e fuqisë në jetëshkrim duhet të çojnë në intervista. Pohimet e fuqisë në kontakte duhet të çojnë në informacion të dobishëm apo orientime. Dhe pohimet e fuqisë në intervista duhet të çojnë në oferta për vend pune. Nëse nuk po i merrni këto rezultate, punoni për ta përmirësuar këtë aftësi.

Ushtrimi me të tjerë dhe marrja e përshtypjeve do t'ju ndihmojë të përmirësoheni. Le të fillojmë menjëherë!

VEPRIMTARI (5 minuta)


Hapi 1: Ngrihuni që të gjithë dhe ndahuni në dy rreshta ballë për ballë.

Hapi 2: I thoni një nga pohimet tuaja të fuqisë personit përballë jush.

Hapi 3: Jepini shpejt përshtypje njëri-tjetrit:

- Çfarë aftësish deklaron partneri juaj?
- Cili është shembulli i partnerit tuaj?
- Cili qe rezultati?
- Si e përputhi partneri juaj atë me nevojat e një punëdhënësi?
- A ju la mbresa?

Hapi 4: Secili në një radhë më pas zbret një person më poshtë. Personi në fund qarkullon te fillimi i rreshtit. Rreshti tjetër nuk lëviz. Përsëritni hapat 1–3 derisa t'ia keni treguar secilit pohimin tuaj të fuqisë dhe të keni marrë përshtypje.



Diskutoni: Si do t'ju ndihmojnë pohimet e fuqisë të dilni në pah si zgjedhja e qartë?

PËRFUNDIM

Shikoni: “The Power of Power Statements” [“Fuqia e Pohimit të Fuqisë”], në dispozicion te srs.ids.org/videos. (Nuk keni material filmik? Lexoni faqen 70.)



Diskutoni: Cilat janë gjërat më të rëndësishme që mësuat nga ky kapitull?

Lexoni: Pohimet e fuqisë do të jenë aftësia më ndikuese e kërkimit për vend pune që mund të mësoni. Ato janë thelbësore për të punuar me mençuri.

Veproni me Besim + Punoni Fort + Punoni me Mençuri = Sukses

Pohimet e fuqisë do t’ju ndihmojnë më shumë se çdo gjë tjetër që mund të bëni, që të dilni në pah si zgjedhja e qartë. Përdorini në jetëshkrimet, kontaktet dhe intervistat tuaja. Ushtrojeni këtë aftësi. Përgatitni duzina pohimesh fuqie. Lutuni për ndihmën e Atit Qiellor dhe do të shihni sukses më të madh.



PËRSIATNI – Koha Maksimale: 5 Minuta

Individualisht mendoni rreth asaj që keni mësuar sot, dhe merrni parasysh se çfarë do të donte Zoti të bënit. Lexoni shkrimin e shenjtë ose citimin më poshtë dhe shkruani përgjigje për pyetjet.

“Sa të frytshme janë fjalët e drejta!” (Jobit 6:25).
Cilat janë gjërat më domethënëse që mësova sot?

Çfarë do të bëj si rezultat i asaj që mësova sot?



ZOTOHUNI – Koha Maksimale: 10 Minuta

Nëse ky është kapitulli juaj i fundit për këtë javë, plotësoni pjesën “Zotohuni”. Ndryshe, kaloni te faqja 76.

Lexojani çdo zotim me zë të lartë partnerit tuaj në veprim. Premtoni se do t'i mbani zotimet tuaja dhe më pas nënshkruani më poshtë. Shënojin synimet tuaja në tabelën te faqet ii–iii.

ZOTIMET E MIA

Ⓐ Do të përcaktoj së paku pesë burime çdo ditë. *Përzgjidhni synimin tuaj.*

Ditë/Javë	Ditë/Javë	Ditë/Javë	Ditë/Javë
5/25	10/50	15/75	20/100

Ⓑ Do të bëj të paktën tri kontakte çdo ditë. *Përzgjidhni synimin tuaj.*

Ditë/Javë	Ditë/Javë	Ditë/Javë	Ditë/Javë
3/15	5/25	7/35	10/50

Ⓒ Do të vihem në kontakt dhe do të mbështes partnerin tim në veprim.

Ⓓ Do ta ushtroj dhe tregoj parimin e sotëm nga Themeli Im.

Ⓔ Do të bëj dy prej ushtrimeve nga lista e Aftësive në faqen iii.

Nënshkrimi im

Nënshkrimi i partnerit në veprim



BURIMET

FUQIA E POHIMEVE TË FUQISË

Darreni tregon se si pohimet e fuqisë e ndihmuan të dilte në pah si zgjedhja e qartë në një proces konkurrimi për punësim.

“Edhe nëse keni një vend pune, është mirë të përgatitni dhe të ushtronini pohimet tuaja të fuqisë. Unë e dija se do të shkurtohesha nga puna, ndaj fillova aktivisht të kërkoja vend pune. Më bëri të kuptoj se njeriut i nevojitet ta mbajë të përditësuar rrjetin e të njohurve . . . gjithsesi, ajo që bëj është paksa specialitet, por ka të tjerë me aftësi e përvojë të ngjashme. Unë gjeta një pozicion me internet dhe fillova të përgatit aplikimin dhe jetëshkrimin tim. E dija se konkurrenca do të ishte e fortë, sidomos ngaqë ky pozicion ishte njoftuar atje ku mund ta gjente kushdo. Kisha mësuar rreth pohimeve të fuqisë dhe e dija që ato ishin kyçi im. Ndërsa të tjerët kishin aftësi të ngjashme, asnjëri nuk pati të njëjtat përvoja dhe arritje si unë. Hartova një jetëshkrim të shkëlqyer, e përshtata sipas nevojave të punëdhënësit dhe përmenda disa shembuj dhe arritje që kanë lidhje [me vendin e punës]. Punëdhënësi më telefonoi brenda pak ditësh nga dorëzimi i aplikimeve të mia.

Unë përfundova duke bërë disa intervista – disa me telefon dhe disa me videokonferencë. Përgatita pohime fuqie për pyetjet që parashikoja për intervistën. Ngaqë ishte intervistë në largësi, në të vërtetë unë mund t’i përdorja shënimet e mia. E dija se ata po intervistonin të tjerë, kështu që duhej të dilja në pah. Pohimet e fuqisë më ndihmuan të paraqitem mirë. Pohimet e fuqisë provuan se cili jam. Ato provuan se isha i gatshëm ta marr vendin e punës dhe ta kryej shumë mirë. Punëdhënësi e dinte se unë do të punoja mirë për ta, sepse unë munda të tregoj shembuj dhe histori kur pata bërë gjëra të ngjashme në të kaluarën. E mora vendin e punës! Unë e di se pohimet e fuqisë sollën ndryshimin për mua.”

Kthehuni te faqja 67.



5

MATERIALET ME SHKRIM

PARIMET, AFTËSITË DHE SHPREHITË E KËRKIMIT PËR VEND PUNE

1. Tri Parime të Thjeshta
2. Jetëshkrimet
3. Letrat Paraqitëse
4. Aplikimet



RAPORTONI – Koha Maksimale: 25 Minuta

Nëse ky është kapitulli juaj i parë i kësaj jave, plotësoni pjesën “Raportoni”. Ndryshe, kaloni te faqja 76.

ZOTIMET E JAVËS SË SHKUAR

- Ⓐ Të gjej burime çdo ditë.
- Ⓑ Të bëj kontakte çdo ditë.
- Ⓒ Të vihem në kontakt dhe të mbështes partnerin tim në veprim.
- Ⓓ Ta ushtroj dhe tregoj parimin e sotëm nga Themeli Im.
- Ⓔ Të ushtroj aftësi për kërkimin e një vendi pune.

HAPI 1: VLERËSONI VETVETEN (5 minuta)

Përdoreni tabelën “Vlerësimi i Përpyjekjeve të Mia” në faqet ii-iii për të rishikuar zotimet tuaja të mbledhjes së fundit. Së pari, shkruani numrin e vërtetë të burimeve që gjetët dhe të kontakteve që bëtë. Pastaj vlerësojeni individualisht përpyekjen tuaj për ta mbajtur secilin zotim duke i shenjuar me të kuqe, të verdhë apo të gjelbër.

VLERËSIMI I PËRPYEKJEVE TË MIA										AFTËSITË	
Data	Ⓐ I Përcakttoj Burimet Çdo Ditë			Ⓑ Krijoj Kontakte Çdo Ditë			Ⓒ Vihem në Kontakt dhe e Përkrah Partnerin Tim në Veprim	Ⓓ E ushtroj Parimin Themeli Im dhe ua Tregoj të Tjerëve	Ⓔ I Ushtroj Aftësitë për Kërkimin e një Vendi Pune (Zgjidhni dy nga lista e Aftësive)	LEGJENDA:	
	Synimi Javor	Realizoj	Përpyekja	Synimi Javor	Realizoj	Përpyekja				Aftësia 1	Përpyekja
Shëmbulli	25	21	●●●●	25	27	●●●●	●●●●	●●●●	E ushtroj parimin themelimit dhe ua tregoj 30 ditëve	●●●●	●●●●
Java 1			●●●●			●●●●	●●●●	●●●●		●●●●	●●●●
Java 2			●●●●			●●●●	●●●●	●●●●		●●●●	●●●●
Java 3			●●●●			●●●●	●●●●	●●●●		●●●●	●●●●
Java 4			●●●●			●●●●	●●●●	●●●●		●●●●	●●●●
Java 5			●●●●			●●●●	●●●●	●●●●		●●●●	●●●●
Java 6			●●●●			●●●●	●●●●	●●●●		●●●●	●●●●
Java 7			●●●●			●●●●	●●●●	●●●●		●●●●	●●●●
Java 8			●●●●			●●●●	●●●●	●●●●		●●●●	●●●●
Java 9			●●●●			●●●●	●●●●	●●●●		●●●●	●●●●
Java 10			●●●●			●●●●	●●●●	●●●●		●●●●	●●●●
Java 11			●●●●			●●●●	●●●●	●●●●		●●●●	●●●●
Java 12			●●●●			●●●●	●●●●	●●●●		●●●●	●●●●

PËRSHENI ZOTIN (KAP. 1)
 • Luatja për ndihmë të posaçme për kërkimin tuaj për vend pune.
 • Agjencia për ndihmë të posaçme për kërkimin tuaj për vend pune.

LINE NË 25 SEKONDA (KAP. 2)
 • Ushtrojeni pesë herë deklaratën tuaj "Line në 30 Sekonda" dhe merri përfitime.
 • Përdoroni deklaratën tuaj "Line në 30 Sekonda" për përkrahje të ndihmës.

INTERVISTA INFORMIMI (SHITJA)
 • Shkruani pesë pyetje për të marrë informim, Shihfaqen 201.
 • Ushtrojeni në të njëjtën mënyrë për informim dhe merri përfitime. Shihfaqen 201.

PËRKOHINI AFTËSITË (KAP. 3)
 • Shkruani pesë parafjalë për vendin tuaj dhe përkrahje aftësi tuaja me mësuesit e punëdhënësit.

POHIME FUGIE (KAP. 4)
 • Shkruani 10 pohime të ndihmës tuaj.
 • Thirrni të qatën në pohime tuaja dhe merri përfitime.

MATERIALET ME SHKRIM (KAP. 5)
 • Shkruani 10 pohime të ndihmës tuaj.
 • Shkruani një parafjalë dhe merri përfitime nga tre rrethet.
 • Shkruani dy pohime tuaja për të filluar letrat parafjalë.
 • Shkruani një letër parafjalë dhe merri përfitime nga tre rrethet.

INTERVISTI (KAP. 6-7)
 • Ushtrojeni deklaratën tuaj "Line në 30 Sekonda" për dy intervista të mundshme.
 • Ushtrojeni kërkimin e përgjigjeve në dy pyetje të intervistës dhe përkrahje për formë tuaj.
 • Ushtrojeni pesë pyetje që mund të bëni në fund të një interviste.
 • Përdoroni tri mënyra të si mund të pyetni më tej ata të të cilëve keni marrë kontakt.
 • Ushtrojeni kërkimin e përgjigjeve për tri pyetje interviste dhe përkrahje nga intervistat.

HAPI 2: TREGOJINI GRUPIT (10 minuta)

Secili nga ju raporton se si shkoi me zotimet e veta duke treguar synimet e numrat realë dhe duke e deklaruar “të kuqe”, “të verdhë” ose “të gjelbër” përpjekjen e vet. Tregoni çfarë shkoi mirë dhe se si ju ndihmoi Ati Qiellor.

HAPI 3: ZGJIDHNI PARTNERË NË VEPRIM (2 minuta)

Zgjidhni një partner në veprim nga grupi për javën që vjen. Përgjithësisht, partnerët në veprim janë të së njëjtës gjini dhe nuk janë pjesëtarë të një familjeje.

Përdorni tani disa minuta për t’u takuar me partnerin tuaj në veprim. Prezantohuni vetë dhe diskutoni se si do të viheni në kontakt me njëri-tjetrin gjatë gjithë javës.

Emri i partnerit në veprim

Informacion kontakti

Shkruani se si dhe kur do të viheni në kontakt me njëri-tjetrin këtë javë.

DIE	HËN	MAR	MËR	ENJ	PRE	SHT


Plotësoni veprimtarinë në faqen pasuese.

VEPRIMTARI (5-8 minuta)

Le t'i ushtrojmë pohimet tona të fuqisë.

Hapi 1: Ndahuni në grupe me të paktën tre veta, por jo më shumë se gjashtë.

Hapi 2: Secili person ngrihet dhe thotë një pohim fuqie duke ndjekur këto hapa:



Hapi 3: Jepini shpejt përshtypje njëri-tjetrit:

- Çfarë aftësie pretendonin ata?
 - Cili ishte shembulli i tyre?
 - Cili qe rezultati?
 - Si e përshtatën me nevojat e punëdhënësit?
 - A ju la mbresa?
-



THEMELI IM – Koha Maksimale: 20 Minuta


Nëse ky është kapitulli juaj i parë i javës, plotësoni parimin pasues të *Themeli Im* që gjendet në fund të këtij libri. Pastaj kthehuni te faqja 76.





MËSONI – Koha Maksimale: 45 Minuta

**SHTEGU DREJT NJË
VENDI PUNE MË TË MIRË**



Lexoni: Një kërkim i suksesshëm për vend pune ndjek këtë formulë të thjeshtë:

Veproni me Besim + Punoni Fort + Punoni me Mençuri = Sukses

Në këtë kapitull ju do të mësoni një aftësi thelbësore për kërkim për vend pune: si të krijoni jetëshkrime të shkëlqyera, letra paraqitëse dhe aplikime. Kur mund të prodhoni materiale me shkrim të shkëlqyera, ju po punoni me mençuri.



Kërkimi i Xhoshit për Vend Pune

Lexoni: Xhoshi ka bërë punë të mirë duke u vënë në kontakt me individë e duke i përputhur aftësitë e tij me nevojat e punëdhënësit. Por tani Xhuli në ABC Marketing ka kërkuar një jetëshkrim. Por po ai jetëshkrim dhe ajo letër paraqitëse e vjetër që Xhoshi i ka përdorur gjithmonë, ndoshta nuk do të jenë aq të mira, pasi nuk prodhuan shumë intervista më parë. Xhoshi do që të ketë materiale me shkrim të shkëlqyera që do ta ndihmojnë të dalë në pah si zgjedhja e qartë, por si? A mund të përdorë diçka si pohimet e fuqisë? Dhe si i bëni ju jetëshkrimet dhe letrat paraqitëse që vërtet të duken të mira?

Diskutoni: Në çfarë mënyrash mund të jeni të ngjashëm me Xhoshin?


Lexoni: Materialet me shkrim – të tilla si jetëshkrimet, letrat paraqitëse dhe aplikimet – janë pjesë thelbësore e çdo kërkimi të suksesshëm për vend pune. Ju do të dëshironi të bëni një përshtypje po aq të mirë me shkrim sikurse personalisht. Secili nga jetëshkrimet, letrat paraqitëse dhe aplikimet tuaja duhet të shkruhen për vendin e punës konkret për të cilin po aplikoni. Ju do të dini se keni materiale të mira me shkrim kur merreni vazhdimisht në intervista.

Ajo që është mjaft e përhapur lidhur me materialet me shkrim, ndryshon dhe ka disa mënyra të drejta për t'i krijuar ato. Ky kapitull paraqet një informacion bazë dhe disa shembuj. Ka më shumë informacion dhe shembuj në faqet 203–213 të shtojca, që duhet ta lexoni vetë gjatë kësaj jave. Përveç kësaj, kërkoni vetë informacion dhe burime shtesë.

Këshillë: Faqe interneti të dobishme, artikuj, apo shembuj jetëshkrimi konsiderohen secila si **burime**.

1. TRI PARIME TË THJESHTA

Lexoni: Materialet me shkrim efektive ndjekin tri parime të thjeshta:



Diskutoni: Përse do të ishin të rëndësishme këto tri parime për jetëshkrimin, letrat paraqitëse apo aplikimet?

2. JETËSHKRIMET

Lexoni: Një jetëshkrim është një dokument i shkruar që përmbledh aftësitë, zotësitë dhe arritjet tuaja. Ai është si një reklamë e shpejtë e asaj se kush jeni ju.

VEPRIMTARI (5 minuta)

Këtu janë jetëshkrimi fillestar i Xhoshit dhe jetëshkrimi i përmirësuar shumë që ai e përgatiti për zyrën e ndihmës teknike të kompanisë ABC Marketing.

Si grup, përdorni pesë minuta për të rishikuar dhe krahasuar jetëshkrimet. Diskutoni se si i përdori Xhoshi tri parimet e qenies tërheqëse, të zbatueshme dhe me arritje për ta përmirësuar jetëshkrimin e tij.

Jetëshkrimi i Vjetër

Josh Silva

123 North 900 w, Anytown, PA 12345 – 111-123-457 – joshsilva@myemail.com

Për të gjetur një vend pune KUPËSIMPLOTE te një kompani e madhe ku mund të kontribuoj, të mësoj dhe të zhvillohem

Përvoja

Teknik i Zyrës së Ndhmës

IT World,

5 janar 2014 – 15 janar 2016

Dhashë ndihmë teknike për përdoruesit e kompjuterave. Iu përgjigja pyetjeve ose i zgjidha problemet e kompjuterit duke i takuar personalisht klientët ose nga telefoni apo në mënyrë elektronike. Dhashë ndihmë në lidhje me përdorimin e Pjesëve dhe Programeve Kompjuterike, duke përfshirë Shtypjen, Instalimin, Përpunimin e Materialeve në Formatin Word, Postën Elektronike dhe Sistemet Operative. Dhashë ndihmë teknike ndaj përdoruesve dhe zgjidha probleme të zakonshme kompjuterike. Shpesh çinstalova programe kompjuterike dhe u mora me viruse dhe instalova programe kompjuterike dhe ruajta pajisje dhe instalova programe mbrojtëse ndaj viruseve. Shpesh shkoja te shtëpitë e njerëzve për t'u dhënë ndihmë për kompjuterin

Punonjës

dyqani bill's
2011– 2014

Punova në arkë duke përdorur skanerat elektronike, regjistrin e të hollave dhe pajisjet që lidhen me to. Magazinoja në rafte dhe bëja tregti. Pastroja.

Mirëmbajtës i Hapësirave të Gjellbërta

Trees-R-Us
2010

Më pëlqente vërtet shumë puna ime dhe punëdhënësi im mendoi gjithashtu se bëra edhe një punë të shkëlqyer. Pjesa ime e parapëlqyer ishte të kositja në mënyrë profesionale lëndinën në ndërtesën e Kapitolit. E përfundova punën kaq shpejt sa që shefi im më zhvendosi nga punonjës me kohë të pjesshme në punonjës me kohë të plotë, gjë e cila ishte e mrekullueshme dhe më bëri ta doja punën edhe më shumë. Diçka tjetër me të cilën merresha, ishin edhe prerja e gëmushave dhe shkurreve sipas formave dhe tëharrja e parcelave me lule, dhe plehërimi i lëndinave. Ndhimova edhe për prerjen e barishteve dhe pastrimin e trotuareve.

marangoz

Build It
2010– 2011

Punova te kompania e babait tim gjatë periudhës së shkollës së mesme. Bëra çdo lloj pune në ndërtim.

Referencat

Diploma e Shkollës së Mesme, Superior High School, Anytown, PA

David Thompson, Mbikëqyrës, IT World Karl Silva, Owner, Build It 198-765-4321

123-456-7891

Peter Johnson, Numri i shokut 159-487-2361

Josh Silva

111-123-4567 • 123 N 900 W, Anytown, PA 12345 • joshsilva@myemail.com

Teknik me Përvojë i Zyrës së Ndhmës

Mbështetje në të gjitha aspektet për klientët, problemet me sistemin dhe përvojat teknike si vijojnë:

Mbështetja ndaj klientit	Lidhja e rrjetit	TCP/IP [Kalimi i Kontrollit të Protokollit/Protokolli i Internetit]
Sistemet e listave të kërkesave të klientëve	Riparimi i pjesëve kompjuterike	Rrjetet jokabllore
Pajisje që kontrollon materialet e ruajtura	Administrimi i inventarit	Programe kompjuterike për Microsoft Office
Ruajtja e materialeve rezervë në shirit magnetik	PC Windows OS	

Përvoja Profesionale

Certifikuar dhe me efektshmëri profesionale me përshtypje të mirë për mirëbesim.

Zgjidha shqetësimet teknike të klientëve me 50% më shpejt se grupi im i kolegëve, duke zhvilluar një mjet që i zhblokon sistemet kompjuterike në mënyrë të thjeshtë dhe të lehtë.

Zgjidha në mënyrë të suksesshme mbi 1000 kërkesa të zyrës së ndihmës në 2 vjet, duke përfshirë direktorinë aktive, rrjetet LAN, WAN, mbrojtjen nga viruset dhe ndihmën për postën elektronike.

U përzgjodha që t'i përgjigjesha dhjetëra nevojave më të vështira të IT për shkak të aftësive të jashtëzakonshme në shërbimin ndaj klientit.

Dokumentova saktësisht 100% të të gjithave kërkesave të zyrës së ndihmës që nga fillimi deri në përfundimin, duke ndjekur ecurinë, duke futur të dhënat dhe duke ndjekur zgjidhjen e problemeve.

Kreva transferime të ndërlikuara të të dhënave pa humbje të shërbimeve kompjuterike duke krijuar një plan për projektin dhe një kalendar dhe duke e ndjekur ecurinë e planit.

Trajnova mbi 20 teknikë të tjerë të zyrës së ndihmës për sistemet operative Windows dhe Programin Microsoft Office.

Krijova tabelë të dhënash në internet për të administruar në mënyrë të suksesshme një inventar prej 300000 dollarësh.

Rendi Kronologjik i Punës

Teknik i Zyrës së Ndhmës, IT World, Filadelfia, PA	2014–2016
Punonjës, Dyqani Bill's, Filadelfia, PA	2011–2014
Mirëmbajtës i Hapësirave të Gjelbërta, Trees-R-Us, Columbus, OH	2010–2011
Marangoz Build It, Filadelfia, PA	2007–2010

Arsimi dhe Certifikimet

Certifikatë A+	2014
Teknik i certifikuar në sistemin Cisco (CCT)	2013
Kurse universitare në shkencë kompjuterike, January Falls Community College	2012–2013
Diploma e shkollës së mesme, Superior High School, Anytown, PA	2008–2012

Lexoni: Shumica e jetëshkrimeve përfshijnë tri lloje informacioni: përmbledhje, përvojë dhe arsimim e trajnim.

Informacioni përmbledhës është si një prezantim dhe është zakonisht në krye të jetëshkrimit. Ai përfshin emrin, informacionin tuaj për kontaktin dhe një përmbledhje të shpejtë të aftësive dhe përvojës suaj që kanë lidhje [me vendin e punës]. Një punëdhënës shpesh do ta shqyrtojë këtë pjesë të jetëshkrimit tuaj në vetëm tre deri në pesë sekonda dhe do të vendosë nëse do ta vijojë leximin ose do t'ju lërë jashtë.

Ju mund ta shihni se Xhoshi përdori atë që quhet titull ose përmbledhje (Teknik me Përvojë për Zyrën e Ndihmës) kështu që punëdhënësi do ta dinte menjëherë kush ishte ai si profesionist. Ai pastaj e vazhdoi me fjalë kyç dhe aftësi nga përshkrimi i vendit të punës për t'ia tërhequr vëmendjen punëdhënësit.

Josh Silva

111-123-4567 • 123 N 900 W, Anytown, PA 12345 • joshsilva@myemail.com

Teknik me Përvojë i Zyrës së Ndihmës

Mbështetje në të gjitha aspektet për klientët, problemet me sistemin dhe përvojat teknike si vijojnë:

Mbështetja ndaj klientit	Lidhja e rrjetit	TCP/IP [Kalimi i Kontrollit të Protokollit/Protokolli i Internetit]
Sistemet e listave të kërkesave të klientëve	Riparimi i pjesëve kompjuterike	Rrjetet jokabllore
Pajisje që kontrollojnë materialet e ruajtura	Administrimi i inventarit	Microsoft Office
Ruajtja e materialeve rezervë në shirit magnetik	Programe kompjuterike për PC	
	Windows OS	

VEPRIMTARI (3 minuta)

Shikoni përshkrimin e vendit të punës që sollët me vete, ose mendoni për vendin e punës që doni. Ushtroni shkrimin e pjesëve nga informacioni juaj përmbledhës.

Hapi 1: Në hapësirën më poshtë shkruani një titull për jetëshkrimin tuaj.

Titulli: _____

Hapi 2: Renditni katër aftësi që mund t'i përfshini në informacionin tuaj përmbledhës.

Aftësia 1: _____

Aftësia 2: _____

Aftësia 3: _____

Aftësia 4: _____

Lexoni: Informacioni mbi përvojën përfshin gjëra si historia e punës dhe duhet të përfshijë disa arritje që lidhen me nevojat e punëdhënësit. Arritjet janë të ngjashme me pohimet e fuqisë, por në një jetëshkrim ju e çoni rezultatin në fillim të pohimit që të dalë në pah. Me radhë lexojini pohimet nën pjesën “Përvojë Profesionale” të jetëshkrimit i Xhoshit për të parë se si shkroi ai rreth arritjeve të tij.

Përvoja Profesionale

Certifikuar dhe me efektshmëri profesionale me përshtypje të mirë për mirëbesim.

Zgjidha shqetësimet teknike të klientëve me 50% më shpejt se grupi im i kolegëve, duke zhvilluar një mjet që i zhblokoi sistemet kompjuterike në mënyrë të thjeshtë dhe të lehtë.

Zgjidha në mënyrë të suksesshme mbi 1000 kërkesa të zyrës së ndihmës në 2 vjet, duke përfshirë direktorinë aktive, rrjetet LAN, WAN, mbrojtjen nga viruset dhe ndihmën për postën elektronike.

U përzgjidha që t'i përgjigjesha dhjetëra nevojave më të vështira të IT për shkak të aftësive të jashtëzakonshme në shërbimin ndaj klientit.

Dokumentova saktësisht 100% të të gjithave kërkesave të zyrës së ndihmës që nga fillimi deri në përfundimin, duke ndjekur ecurinë, duke futur të dhënat dhe duke ndjekur zgjidhjen e problemeve.

Kreva transferime të ndërlikuara të të dhënave pa humbje të shërbimeve kompjuterike duke krijuar një plan për projektin dhe një kalendar dhe duke e ndjekur ecurinë e planit.

Trajnova mbi 20 teknikë të tjerë të zyrës së ndihmës për sistemet operative Windows dhe Programin Microsoft Office.

Krijova tabelë të dhënash në internet për të administruar në mënyrë të suksesshme një inventar prej 300000 dollarësh.

Rendi Kronologjik i Punës

Teknik i Zyrës së Ndihmës, IT World, Filadelfia, PA	2014–2016
Punonjës, Dyqani Bill's, Filadelfia, PA	2011–2014
Mirëmbajtës i Hapësirave të Gjelbërta, Trees-R-U's, Columbus, OH	2010–2011
Marangoz Build It, Filadelfia, PA	2007–2010

VEPRIMTARI (5 minuta)

Shikoni përshkrimin e vendit të punës që sollët me vete, ose mendoni për vendin e punës që doni. Secili nga ju përdorni tri minuta dhe shkruani dy arritje për jetëshkrimin tuaj, të ngjashme me mënyrën se si e shkroi Xhoshi të vetin. Pastaj me radhë ia tregoni ato grupit tuaj.

1. _____

2. _____

Lexoni: Informacioni për arsimimin dhe trajnimin e ndihmon një punëdhënës të kuptojë kualifikimet tuaja. Ky mund të përfshijë diploma, certifikime, kurse të veçanta dhe më shumë. Sigurohuni që ajo që përfshini të ketë lidhje, duke filluar me informacionin më mbresëlënës.

Këtu është mënyra se si Xhoshi e përfshiu informacionin e tij për arsimimin dhe trajnimin.

Arsimi dhe Certifikimet

Certifikatë A+	2014
Teknik i certifikuar në sistemin Cisco (CCT)	2013
Kurse universitare në shkencë kompjuterike, January Falls Community College	2012–2013
Diploma e shkollës së mesme, Superior High School, Anytown, PA	2008–2012

3. LETRAT PARAQITËSE

Lexoni: Një letër paraqitëse shpesh shoqëron jetëshkrimin tuaj. Ajo funksionon si hyrje dhe duhet ta nxitë punëdhënësin ta lexojë më pas jetëshkrimin tuaj. Letra paraqitëse mund ta ndihmojë kompaninë të kuptojë përse jeni i interesuar për mundësinë dhe përse mendoni se kompania do të tregojë mençuri po t'ju punësojë ju.

Letrat e mira paraqitëse hapen me një pohim fuqie për ta tërhequr shpejt vëmendjen e lexuesit.

VEPRIMTARI (5 minuta)

Këtu janë letra paraqitëse fillestare e Xhoshit dhe letra shumë e përmirësuar paraqitëse që ai përgatiti për zyrën e ndihmës teknike të kompanisë ABC Marketing.

Si grup, përdorni deri në pesë minuta për t'i rishikuar e krahasuar letrat paraqitëse. Diskutoni se si i përdori Xhoshi tri parimet e thjeshta të të qenit tërheqëse, e zbatueshme dhe me arritje për ta përmirësuar letrën e tij paraqitëse.

Letra Paraqitëse e Vjetër

Kujt Mund t'i Interesojë:

Unë po shkruaj për të aplikuar për një vend pune në kompaninë tuaj.

U diplomova nga Shkolla e Mesme "Superior" në vitin 2009. Që nga ajo kohë, kam punuar për disa kompani të ndryshme vendore si IT World, dyqani Bill's Grocery, Tree-R-Us, Build It etj. Gjashtë vitet e kaluara më kanë dhënë mundësinë të fitoj kuptueshmëri, si dhe disa njohuri të veçanta në gjërat si mirëmbajtja e hapësirave të gjelbërta, shitja me pakicë, shërbimi ndaj klientit dhe mbështetja kompjuterike.

Si Teknik i Zyrës së Ndihmës, unë kam dhënë mbështetje teknike për përdoruesit e kompjuterave. U jam përgjigjur pyetjeve dhe i kam zgjidhur problemet e kompjuterave duke i takuar personalisht klientët ose nga telefoni apo në mënyrë elektronike. Kam dhënë gjithashtu ndihmesë në lidhje me përdorimin e pjesëve fizike dhe programeve kompjuterike, duke përfshirë shtypjen, instalimin, përpunimin e materialeve në formatin Word, adresën postare elektronike dhe sistemet operative. Përveç këtyre, në punën e mëparshme, unë krijova një program për të dhënat që të administroja inventarin dhe i zgjidha shqetësimet teknike të klientëve më shpejt se kolegët e mi.

Si një ndihmës në dyqan, kam arkëtuar duke përdorur skanerat elektronikë të shiritit të kodeve, regjistrin e të hollave dhe pajisje të tjera që lidheshin me to. Kam magazinuar raftet dhe kam bërë tregti. Si një mirëmbajtës i hapësirave të gjelbërta, kam kaluar kohë me një ekip drugarësh dhe bëmë trajnim bazë për mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbërta. Së fundi, si marangoz unë kam punuar në kompaninë e babait tim dhe kam kursyer para për investime të mëvonshme. Kam bërë çdo lloj pune në ndërtim.

Nëpërmjet të gjitha këtyre përvojave kam arritur të kuptoj rëndësinë e të qenit gjithmonë i sjellshëm kundrejt të tjerëve, si me klientët edhe me kolegët, veçanërisht gjatë zgjidhjes së konflikteve. Kam kuptuar edhe se si të parandaloj përshkallëzimin e konflikteve. Përveç këtyre, përvoja ime e punës ka përforcuar rëndësinë që ka ndihma ndaj klientëve; mënyra se si kompania vazhdon ta ndihmojë një klient, do të përcaktojë gjerësisht nëse klienti do të vazhdojë të bëjë biznes me kompaninë ose jo.

Që në moshë të hershme kam treguar se jam punëtor i palodhur: kam qenë gjithmonë një student i përkushtuar; ndërsa isha në shkollë të mesme punoja, pa prishur rezultatin e mirë të notave dhe jam mësuar të punoj derisa ta kryej një detyrë, edhe nëse kjo nënkupton të qëndroj orë shtesë në punë. Mua më pëlqen, si të thuash, të punoj me njerëz, si me ata që janë të komunikueshëm edhe me ata që kanë personalitet të vështirë. Kam aftësi të mira në komunikim dhe jam i përqendruar deri te hollësitë. Këto aftësi më kanë lejuar që ta kryeja mirë detyrën në punët e mëparshme. Ndërsa i kam praktikuar këto aftësi, unë kam pasur mundësi të merrja shumë përshtypje pozitive nga kolegët dhe mbikëqyrësit në çdo kompani.

Kohët e fundit më pushuan nga puna – si shumë punonjës të kompanisë, për shkak se kompania shpalli falimentimin. Si një njeri që siguron bukën e gojës për një familje të re, mezi pres të kthehem në punë që të kujdesem për të. Unë po punoj për diplomën në shkencë kompjuterike dhe shpresoj të shkoj të punoj në atë fushë si për të marrë më shumë përvojë edhe për t'i dhënë kontributin kompanisë që më punëson.

Mezi pres të flas me ju më shumë për vendin tuaj të punës.

Ju faleminderit!

Josh Silva

Letra Paraqitëse e Përmirësuar

Josh Silva

111-123-4567 • 123 N 900 W, Anytown, PA 12345 • joshsilva@myemail.com

10 janar 2016

Znj. Julie Andrews
Mbikëqyrëse, Mbështetja Teknike
Kompania e Marketingut ABC
15 ABC Way
Anytown, PA 12345

E nderuar znj. Endrjus,

Si teknik i zyrës së ndihmës me organizatën time të mëparshme, zhvillova një mjet të thjeshtë identifikues që më lejoi t'i vlerësoja shpejt dhe më pas t'i zgjidhja nevojat e IT-së çdo ditë për dhjetëra klientë të brendshëm e të jashtëm. Si rrjedhojë, unë zgjidha mbi 1000 kërkesa të zyrës së ndihmës për dy vjet, me një mesatare sa gjysma e kohës të kolegëve të mi. Duke e bërë këtë, unë krijova emër për shërbim më të mirë ndaj klientëve duke i zgjidhur problemet e ndërlikuara teknike në mënyra të thjeshta e të qarta.

Nga biseda jonë këtë javë dhe nga përshkrimi i punës që ju treguat, duket se keni nevojë për njerëz të aftë nga ana teknike, të cilët mund të komunikojnë me efektshmëri ndërsa japin shërbim të shkëlqyer ndaj klientit. Mendoj se unë jam pikërisht ai që po kërkonte.

Do ta vlerësoja mundësinë për t'u takuar me ju e për të diskutuar rreth nevojave që keni për pozicionin Teknik i Zyrës së Ndihmës. Mund të viheni në kontakt me mua në numrin 111-123-4567.

Sinqerisht,

Josh Silva

Bashkëngjitur: Jetëshkrim

VEPRIMTARI (5 minuta)

Xhoshi e filloi letrën e tij paraqitëse me një pohim të fortë fuqie për ta tërhequr interesin e lexuesit. Ju duhet të bëni të njëjtën gjë.

Shikoni përshkrimin e vendit të punës që sollët me vete, ose mendoni për vendin e punës që doni. Individualisht shkruani një pohim fuqie për ta filluar efektshëm letrën tuaj paraqitëse. Mandej tregojani partnerit tuaj në veprim.

4. APLIKIMET

Lexoni: Aplikimet përdoren zakonisht nga bizneset si pjesë e procesit të tyre rekrutues. Ato zakonisht kërkojnë informacionin tuaj bazë të kontaktit, arsimimin dhe historinë e punës. Shumë aplikime dorëzohen në internet dhe mund të marrin kohë për t'u plotësuar. Thjesht plotësimi i aplikimit mund të jetë pjesë e një procesi shqyrtimi nga punëdhënësi.

Aplikimet e mira ndjekin parimet e të qenit tërheqëse, të zbatueshme dhe me arritje duke qenë pa gabime, të lidhura me vendin e punës dhe që përshkruajnë përvojën tuaj duke përdorur pohime fuqie.

PËRFUNDIM

Shikoni: “Better Written Materials” [“Materiale me Shkrim më të Mira”], në dispozicion te srs.ids.org/videos. (Nuk keni material filmik? Lexoni faqen 92.)



Diskutoni: Cilat ishin gjërat më të rëndësishme që mësuat nga ky kapitull?

Lexoni: Shkrimi i jetëshkrimeve, letrave paraqitëse të mira dhe i aplikimeve është një aftësi për kërkimin e vendit të punës që ju ndihmon të punoni me mençuri.

Veproni me Besim + Punoni Fort + Punoni me Mençuri = Sukses

Sa më i mirë bëheni në shkrimin e tyre, aq më shumë sukses do të keni. Lutuni për ndihmën e Atit Qiellor dhe mandej bëjeni punën. Ndiqeni ecurinë e çdo jetëshkrimi dhe aplikimi që dorëzoni. Kjo është të tregoni besimin tuaj. Nëse e bëni këtë, ju do të shihni se shkrimi i jetëshkrimeve bëhet më i lehtë dhe do t’ju ofrohen më shumë intervista.



PËRSIATNI – Koha Maksimale: 5 Minuta

Individualisht mendoni rreth asaj që keni mësuar sot, dhe merrni parasysh se çfarë do të donte Zoti të bënit. Lexoni shkrimin e shenjtë ose citimin më poshtë dhe shkruani përgjigje për pyetjet.

“Prandaj, mos u lodhni së bëri mirë, sepse ju po ngrini themelin e një veprë të madhe. Dhe nga gjëra të vogla vjen ajo që është e madhe” (DeB 64:33).

Cilat janë gjërat më domethënëse që mësova sot?

Çfarë do të bëj si rezultat i asaj që mësova sot?



ZOTOHUNI – Koha Maksimale: 10 Minuta

Nëse ky është kapitulli juaj i fundit për këtë javë, plotësoni pjesën “Zotohuni”. Ndryshe, kaloni te faqja 98.

Lexojani çdo zotim me zë të lartë partnerit tuaj në veprim. Premtoni se do t'i mbani zotimet tuaja dhe më pas nënshkruani më poshtë. Shënoni synimet tuaja në tabelën te faqet ii-iii.

ZOTIMET E MIA

Ⓐ Do të përcaktoj së paku pesë burime çdo ditë. *Përzgjidhni synimin tuaj.*

Ditë/Javë	Ditë/Javë	Ditë/Javë	Ditë/Javë
5/25	10/50	15/75	20/100

Ⓑ Do të bëj të paktën tri kontakte çdo ditë. *Përzgjidhni synimin tuaj.*

Ditë/Javë	Ditë/Javë	Ditë/Javë	Ditë/Javë
3/15	5/25	7/35	10/50

Ⓒ Do të vihem në kontakt dhe do të mbështes partnerin tim në veprim.

Ⓓ Do ta ushtroj dhe tregoj parimin e sotëm nga Themeli Im.

Ⓔ Do të bëj dy prej ushtrimeve nga lista e Aftësive në faqen iii.

Nënshkrimi im

Nënshkrimi i partnerit në veprim



BURIMET

MATERIALE MË TË MIRA ME SHKRIM

Meri tregon se si përmirësimi i materialeve të saj me shkrim ishte kyç në kërkimin e saj për vend pune.

“Kur po kërkoja punë, thjesht nxora jetëshkrimin tim të vjetër, shtova disa nga përvojat e mia të reja dhe mendova se isha gati ta filloja. Jetëshkrimi im tani ishte tri faqe i gjatë dhe i mbushur me të gjitha llojet e gjërave të mëdha . . . diçka mbresëlënëse. Ose kështu mendova unë. Fillova ta përdorja jetëshkrimin tim për të aplikuar për disa vende pune për të cilat isha e kualifikuar mirë. Nuk mora asnjë lloj përgjigjeje. Përfundimisht diçka nuk shkonte. Unë do të isha e shkëlqyer në cilindo nga ato vende pune, atëherë përse nuk po më telefononin? Më në fund mendova se kisha nevojë për një ndihmë. U luta për ndihmë dhe fillova të bëja një kërkim dhe të bisedoja me të tjerë rreth jetëshkrimeve. Shpejt kuptova se jetëshkrimi që e mendoja aq të shkëlqyer, ishte vërtet mjaft i keq dhe ndoshta nuk qe lexuar fare. Kjo ishte përulëse.

Iu futa punës për ta rregulluar. Kjo më mori kohë dhe shumë përpjekje. Fillova ta përshtat për secilin pozicion, duke e bërë më të lexueshëm dhe duke zëvendësuar listat e mia të mërzitshme të përgjegjësi me arritje emocionuese. Vërtet më ndihmoi të shihja modele jetëshkrimesh të mira dhe të përpiqesha t'i ndiqja ato modele. E dija se isha atje ku duhej kur fillova të kem shumë më tepër telefonata për intervista. Materialet e mia të shkruara po jepnin më në fund rezultate për mua dhe jo kundër meje. Ato intervista më çuan tek ofertat për vend pune.

Unë mora një dozë të shëndetshme përulësie për vete që ta kuptoja se më duhej ndihmë, por sapo e kuptova, Ati Qiellor më drejtoi te burimet. Unë shoh pas te jetëshkrimi im i vjetër dhe qesh. Jam mirënjohëse që mësova një mënyrë më të mirë. Ajo bëri një ndryshim të madh për mua.”

Kthehuni te faqja 89.



6

KOPSITE INTERVISTËN: PJESA 1

PARIMET, AFTËSITË DHE SHPREHITË E KËRKIMIT PËR VEND PUNE

1. Përgatituni Përpara Intervistës
2. Hapeni Intervistën Efektshëm
3. Përdoreni Deklaratën Tuaj Unë në 30 Sekonda
4. Përdorni Pohime Fuqie



RAPORTONI – Koha Maksimale: 25 Minuta

Nëse ky është kapitulli juaj i parë i kësaj jave, plotësoni pjesën “Raportoni”. Ndryshe, kaloni te faqja 98.

ZOTIMET E JAVËS SË SHKUAR

- Ⓐ Të përcaktoj burime çdo ditë.
- Ⓑ Të bëj kontakte çdo ditë.
- Ⓒ Të vihem në kontakt dhe të mbështes partnerin tim në veprim.
- Ⓓ Ta ushtroj dhe tregoj parimin e sotëm nga Themeli Im.
- Ⓔ Të ushtroj aftësi për kërkimin e një vendi pune.

HAPI 1: VLERËSONI VETVETEN (5 minuta)

Përdoreni tabelën “Vlerësimi i Përpjekjeve të Mia” në faqet ii-iii për të rishikuar zotimet tuaja të mbledhjes së fundit. Së pari, shkruani numrin e vërtetë të burimeve që gjetët dhe kontakteve që bëtë. Pastaj vlerësojeni individualisht përpjekjen tuaj për ta mbajtur secilin zotim duke i shenjuar me të kuqe, të verdhë apo të gjelbër.

VLERËSIMI I PËRPJEKJEVE TË MIA										AFTËSITË	
Data	Ⓐ I Përcaktoj Burimet Çdo Ditë		Ⓑ Krijoj Kontakte Çdo Ditë		Ⓒ Vihem në Kontakt dhe e Përkrah Partnerin Tim në Veprim	Ⓓ E ushtroj Parimin Themel (m dhe ua Tregoj të Tjerëve	Ⓔ I Ushtroj Aftësitë për Kërkimin e një Vendi Pune (Zgjidhni dy nga lista e Aftësive)	LEGJENDA: ● Përpjekje Mëmirë ● Përpjekje Mëkufizuar ● Përpjekje Mëkufizuar ● Përpjekje Mëkufizuar			
	Syminj Javor	Realja	Syminj Javor	Realja				Përpjekja	Përpjekja	Aftësia 1	Përpjekja
Shëmbulli	25	21	25	27	●●●●	●●●●	E ushtroj parimin themel 30 sekonda	●●●●	Shëruaj 10 pohime tuaja	●●●●	<p>PËRSHENI ZOTIM (KAP. 1)</p> <ul style="list-style-type: none"> Lutuni për ndihmë të posaçme për kërkimin tuaj për vend pune. Ajtoni për ndihmë të posaçme për kërkimin tuaj për vend pune. <p>UNE NË 30 SEKONDA (KAP. 2)</p> <ul style="list-style-type: none"> Ushtrojeni pesë herë deklaratën tuaj "Une në 30 Sekonda" dhe merri përfitime. Postojeni deklaratën tuaj "Une në 30 Sekonda" për postë mundësi të reja. <p>INTERVISTA INFORMIMI (SHITËJA)</p> <ul style="list-style-type: none"> Shëruaj pesë pyetje për të marrë informim. Shihfaqen 201. Shëruaj në të njëjtën mënyrë për informim dhe merri përfitime. Shihfaqen 201. <p>PËRKQINI AFTËSITË (KAP. 3)</p> <ul style="list-style-type: none"> Shëruaj pesë përkrahje për vend pune dhe përkrahje aftësi tuaja me mësuesit e punëdhënësit. <p>POHIME FUGJE (KAP. 4)</p> <ul style="list-style-type: none"> Shëruaj 10 pohime të rrejshme tuaja. Thirrni të qatën në pohime tuaja dhe shëruaj dhe merri përfitime. <p>MATERIALI ME SHKRIM (KAP. 5)</p> <ul style="list-style-type: none"> Shëruaj 10 pohime të rrejshme tuaja. Shëruaj një përkrahje dhe merri përfitime nga tre rreza. Shëruaj dy pohime tuaja për të filluar letrat përfundim. Shëruaj një letër paraqitja dhe merri përfitime nga tre rreza. <p>INTERVISTA (KAP. 6-7)</p> <ul style="list-style-type: none"> Ushtrojeni deklaratën tuaj "Une në 30 Sekonda" për dy intervista të mundshme. Ushtrojeni kërkimin e përgjigjeve në pyetje për intervistat dhe përkrahje për formë tuaja. Ushtrojeni pesë pyetje që mund të bëni në fund të një interviste. Përkrahje të mënyrës se si mund të pyetni më afër se se të kërkoni informim në fund të një interviste. Ushtrojeni kërkimin e përgjigjeve për tri pyetje interviste dhe shëruaj informim nga intervistat.
Java 1											
Java 2											
Java 3											
Java 4											
Java 5											
Java 6											
Java 7											
Java 8											
Java 9											
Java 10											
Java 11											
Java 12											

HAPI 2: TREGOJINI GRUPIT (10 minuta)

Secili nga ju raporton se si shkoi me zotimet e veta duke treguar synimet e numrat realë dhe duke e deklaruar “të kuqe”, “të verdhë” ose “të gjelbër” përpjekjen e vet. Tregoni çfarë shkoi mirë dhe se si ju ndihmoi Ati Qiellor.

HAPI 3: ZGJIDHNI PARTNERË NË VEPRIM (2 minuta)

Zgjidhni një partner në veprim nga grupi për javën që vjen. Përgjithësisht, partnerët në veprim janë të së njëjtës gjini dhe nuk janë pjesëtarë të një familjeje.

Përdorni tani disa minuta për t’u takuar me partnerin tuaj në veprim. Prezantohuni vetë dhe diskutoni se si do të viheni në kontakt me njëri-tjetrin gjatë gjithë javës.

Emri i partnerit në veprim

Informacion kontakti

Shkruani se si dhe kur do të viheni në kontakt me njëri-tjetrin këtë javë.

DIE	HËN	MAR	MËR	ENJ	PRE	SHT


Plotësoni veprimtarinë në faqen pasuese.

VEPRIMTARI (5-8 minuta)

Le të ushtrojmë pohimet tona të fuqisë.

Hapi 1: Ndahuni në grupe me të paktën tre veta, por jo më shumë se gjashtë.

Hapi 2: Secili person ngrihet dhe thotë një pohim fuqie duke ndjekur këto hapa:



Hapi 3: Jepini shpejt përshtypje njëri-tjetrit:

- Çfarë aftësie pretendonin ata?
 - Cili ishte shembulli i tyre?
 - Cili qe rezultati?
 - Si e përshtatën me nevojat e punëdhënësit?
 - A ju la mbresa?
-



THEMELI IM – Koha Maksimale: 20 Minuta


Nëse ky është kapitulli juaj i parë i javës, plotësoni parimin pasues të *Themeli Im* që gjendet në fund të këtij libri. Pastaj kthehuni te faqja 98.





MËSONI – Koha Maksimale: 45 Minuta

SHTEGU DREJT NJË VENDI PUNE MË TË MIRË



Lexoni: Një kërkim i suksesshëm për vend pune ndjek këtë formulë të thjeshtë:

Veproni me Besim + Punoni Fort + Punoni me Mençuri = Sukses

Aftësitë për intervistë ju ndihmojnë të punoni më me mençuri. Ngaqë intervistat janë kaq të rëndësishme, ne do t'ia kushtojmë tre kapitujt e tjerë mësimi e ushtrimit të aftësive për intervista.



Kërkimi i Xhoshit për Vend Pune

Lexoni: Lajme të tjera të mira. Xhuli nga kompania ABC Marketing i telefonoi Xhoshit pasi mori jetëshkrimin dhe letrën paraqitëse të tij. Ajo caktoi një intervistë me të pas dy ditësh për vendin e punës të një tekniku në zyrën e ndihmës. Xhoshi gjithmonë ka qenë nervoz gjatë intervistave për vend pune dhe është i shqetësuar se çfarë pyetjesh mund t'i bëjë Xhuli. Ai është krejt i sigurt se nuk i bëri mirë dy intervistat që ka pasur deri tani, po nuk është i sigurt se çfarë mund të përmirësojë. Xhoshi do që të jetë i përgatitur.

Diskutoni: Në çfarë mënyrash mund të jeni të ngjashëm me Xhoshin?

Shikoni: "The Interview" ["Intervista"], në dispozicion te srs.ids.org/videos. (Nuk keni material filmik? Lexojeni faqen 109.)



Lexoni: Intervistat janë një nga hapat e fundit në marrjen e një vendi pune. Qëllimi i një interviste është të marrim një ofertë për vend pune. Zoti ka premtuar: “Nëse jeni të përgatitur, ju s’do të frikësoheni” (DeB 38:30). Nëse përgatiteni mirë, ju mund ta zëvendësoni frikën me vetëbesim.

Në këtë kapitull do të mësoni të punoni me mençuri duke zhvilluar aftësitë e mëposhtme për intervistat:

1. Përgatituni përpara intervistës.
2. Hapeni intervistën efektshëm.
3. Përdoreni deklaratën tuaj Unë në 30 sekonda.
4. Përdorni pohime fuqie.

1. PËRGATITUNI PËRPARA INTERVISTËS

Lexoni: A nuk do të ishte e mirë ta dinit se çfarë pyetjesh do t’ju bëheshin në një intervistë?

Ju mundeni.

Shumica e intervistuesve do të bëjnë një gërshetim pyetjesh të zakonshme interviste dhe pyetjesh të posaçme për vendin e punës. Ju e dini tashmë se si të përcaktoni nevojat e punëdhënësit, kështu që mund ta përdorni atë aftësi për ta kuptuar se çfarë ka gjasa t’ju kërkojë punëdhënësi. Për shembull, Xhoshi është mjaft i sigurt se do ta pyesin rreth shërbimit ndaj klientit, ndreqjes së defekteve dhe komunikimit të gjërave teknike me fjalë të thjeshta.

VEPRIMTARI (3 minuta)

Shikoni te përshkrimi i vendit të punës që sollët me vete, ose mendoni për vendin e punës që doni. Shkruani dy pyetje që mendoni se një intervistues mund t’ju pyesë dhe mandej tregojani grupit.

1. _____

2. _____


2. HAPENI INTERVISTËN EFEKTSHËM

Lexoni: Kur filloni një intervistë, ka disa gjëra të thjeshta që mund të bëni për të lënë një mbresë të parë të shkëlqyer. Si grup lexoni me radhë më poshtë listën e gjërave që duhen bërë e që nuk duhen bërë.

BËNI	MOS BËNI
Vishuni një nivel më lart se standardi i veshjes i kompanisë.	Vishuni tepër thjeshtë.
Mbërrini 5–10 minuta më herët.	Jini me vonesë ose më shumë se 10 minuta herët.
Përdorni gjuhë trupore pozitive.	Përdorni gjuhë trupore negative.

VEPRIMTARI (3 minuta)

Krahasoni figurat më poshtë. Në të dyja figurat personi në të majtë është atje për një intervistë. Si grup, diskutoni se çfarë përshtypjeje po lë punëkërkuksi në secilën figurë.



3. PËRDORENI DEKLARATËN TUAJ UNË NË 30 SEKONDA

Lexoni: Shpesh një nga pyetjet e para të intervistës që do t'ju bëhet, është: “Më tregoni për veten”. Një deklaratë Unë në 30 Sekonda, e përshtatur në një situatë interviste, është një përgjigje e shkëlqyer për këtë pyetje. Deklarata Unë në 30 Sekonda për një intervistë është paksa e ndryshme. Për shembull, zakonisht ju nuk keni nevojë ta përdorni emrin tuaj. Dhe në vend që të kërkonti rekomandime siç do të bënit në rrjetin e krijuar, ju e mbyllni duke treguar interes për kompaninë ose pozicionin.

VEPRIMTARI (4 minuta)

Le t'i lexojmë dy shembujt e njerëzve që u përgjigjen pyetjeve në hapje të intervistës. Zgjidhni role dhe interpretoni pjesën vijuese.

Shembulli i Keq

Intervistuesi: "Përpara se të fillojmë, ju lutem më tregoni pak rreth vetes suaj".

Punëkërkuksi: "E po, unë u rrita në Kanzas si pjesë e një familjeje të madhe. Jam i martuar dhe kam tre fëmijë dhe një qen të vogël. Neve na pëlqen të udhëtojmë dhe kalojmë sa më shumë kohë që mundemi te liqeni. Vitin e kaluar sapo blemë një barkë të re. Ishte goxha e shtrenjtë, gjë që është një nga arsyet pse po kërkoj punë. Kam shumë përvojë në të punuarit me njerëz. Unë fillova 20 vite përpara, kur isha 19 vjeç, si arkëtar në një bankë. Kështu mësova goxha rreth parasë dhe financave. Për shembull, mësova se bankat nuk i mbajnë paratë tuaja; ato vetëm i marrin dhe mandej i japin hua përsëri për të krijuar interesin. Sidoqoftë, unë e bëra këtë për disa vite dhe mandej shkova në kolegji. Nuk isha shumë i mirë në shkollë. Mua vërtet nuk më pëlqente studimi. Mora një vend pune në biznesin e marketingut të një miku. Unë bëra kryesisht punë administrative – ju e dini, si përgjigje të telefonave, postën, mbledhjet, gjëra të tilla. Por të punuarit me miq jo gjithmonë funksionon, kështu që e lashë atë pozicion dhe kërkova diçka më të mirë. Le ta shohim . . . punova në disa vende të tjera, por nuk i kujtoj dot emrat e tyre. Oh, vendi i punës më i mirë që pata, ishte ky pozicioni i shërbimit ndaj klientit ku punova nga shtëpia. Unë mund të punoja me pizhame, t'i përgjigjesha telefonit dhe thjesht të punoja në kompjuterin tim. Ajo ishte vërtet mirë. Sidoqoftë, mua më pëlqen të punoj dhe i pëlqej njerëzit. Unë do të bëj një punë të mirë për ju."

Shembulli i Mirë

Intervistuesi: "Përpara se të fillojmë, ju lutem më tregoni pak rreth vetes suaj".

Punëkërkuksi: "Pra, karriera ime 20-vjeçare ka qenë kryesisht në financë dhe punë bankare. Unë fillova si arkëtar në një bankë vendore dhe mandej përparova në menaxhim. Shpejt e kuptova vlerën e arsimimit dhe përfundova një diplomë për financë. Unë shquhem në menaxhimin e njerëzve, kostove dhe arritjen e synimeve të shitjes. Për shembull, në pozicionin tim të mëparshëm mora përsipër një degë që ishte me probleme, dhe brenda gjashtë muajsh po tejkalonim synimet tona për shitjet. Unë jam i interesuar për këtë pozicion, sepse duket se mund të jetë një sfidë e ngjashme."

Diskutoni: Përse ishte shembulli i dytë më i mirë?


VEPRIMTARI (4 minuta)

Shikoni përshkrimin e vendit të punës që sollët me vete, ose mendoni për vendin e punës që doni. Përfytyroni që do të keni intervistë pas dy ditësh për atë pozicion. Në hapësirën më poshtë shkruani një deklaratë Unë në 30 Sekonda në përgjigje të kërkesës: "Më tregoni rreth vetes suaj". Mandej ndahuni në dyshe dhe tregojani atë partnerit tuaj në veprim.

4. PËRDORNI POHIME FUQIE

Lexoni: Pohimet e fuqisë duhet të përdoren për t'iu përgjigjur shumicës së pyetjeve të intervistave. Ato janë mbresëlënëse e të fuqishme dhe do t'ju ndihmojnë të dilni në pah si zgjedhja e qartë.

Kujtohuni të ndiqni formulën e pohimit të fuqisë:



VEPRIMTARI (4 minuta)

Le t'i lexojmë këta shembuj intervistash nga kapitulli 4 përsëri. Zgjidhni role dhe interpretoni pjesën vijuese.

Shembulli Mesatar

Intervistuesi: "Më tregoni rreth një kohe kur ju ofruat një shërbim të shkëlqyer ndaj klientit".

Punëkërkuesi 2: "Shërbimi ndaj klientit është shumë i rëndësishëm për mua. Klientët janë çelësi i suksesit tonë të vazhdueshëm. Unë kam parë gjithmonë se nëse klientët trajtohen si duhet, ata do t'ju shpërblejnë me biznes të vazhdueshëm. Unë kam shumë përvojë me shërbimin ndaj klientit dhe jam shumë i mirë për këtë. Klientët duan të dëgohen dhe ta dinë se janë dëgjuar. Është e rëndësishme që ne të bëjmë më të mirën për ta bërë siç duhet që herën e parë dhe ta ndreqim sa më shpejt që është e mundur kur bëjmë gabim. Unë besoj te thënia se klienti ka gjithmonë të drejtë."

Shembulli i Mirë

Intervistuesi: "Më tregoni rreth një kohe kur ju ofruat një shërbim të shkëlqyer ndaj klientit".

Punëkërkuesi 3: "Unë jam shumë i aftë në shërbimin ndaj klientit. Për shembull, kur punoja për YZ Sales, ne patëm një klient afatgjatë, i cili, në një rast, nuk mori atë që pati porositur. Kur më telefanoi, ai ishte i nevrikosur dhe kërcënoi se do ta ndërpriste gjithë punën e tij me ne. Unë i kushtova kohë për ta dëgjuar dhe kuptuar gjendjen e tij dhe mandej ofrova një zgjidhje që klientit i pëlqeu. Si rezultat, ne jo vetëm që e mbajtëm klientin, por ai i shtoi porositë e tij te ne me 200 për qind. Unë jam i sigurt se po këto aftësi shërbimi ndaj klientit mund t'i vë në punë për ju."

Diskutoni: Si e bëri përdorimi i një pohimi fuqie më të efektshëm shembullin e dytë?

VEPRIMTARI (6 minuta)

Përfytyroni sikur tani jeni më thellë në intervistë. Intervistuesi ka gjasa se do t'ju bëjë disa pyetje të zakonshme interviste. Shkruani pohime fuqie për secilën nga pyetjet e mëposhtme.

Cila është një nga pikat tuaja të forta?

Cila është arritja juaj profesionale më e madhe?

Përse duhet t'ju marrim në punë?

VEPRIMTARI (6 minuta)

Si grup lexoni të gjitha udhëzimet, mandej filloni veprimtarinë.

Hapi 1: Ngrihuni që të gjithë dhe lëvizni te një vend i hapur për një ushtrim shpejtësie. Çdo person duhet të jetë përballë një personi tjetër.

Hapi 2: Personi i parë bën një nga tre pyetjet e faqes 105.

Hapi 3: Personi i dytë i përgjigjet pyetjes duke përdorur një pohim fuqie.

Hapi 4: Jepni përshtypje:

- A tregoi personi një shembull me rezultat?
- A ju la mbresa?

Hapi 5: Ndërrojini rolet dhe përsëriteni.

Hapi 6: Ndërroni partnerë dhe përsëriteni veprimtarinë pesë herë.

PËRFUNDIMI

Diskutoni: Cilat ishin gjërat më të rëndësishme që mësuat nga ky kapitull?

Lexoni: Ju keni filluar të mësoni disa aftësi interviste që do t'ju ndihmojnë të punoni me mençuri.

Veproni me Besim + Punoni Fort + Punoni me Mençuri = Sukses

Nëse jeni i përgatitur, nuk ka përse të keni frikë. Lutuni për ndihmë dhe mandej përgatituni dhe ushtrohuni sa më shumë që mundni. Në kapitullin tjetër do të mësojmë më shumë aftësi për intervistat.



PËRSIATNI – Koha Maksimale: 5 Minuta

Individualisht mendoni rreth asaj që keni mësuar sot, dhe merrni parasysh se çfarë do të donte Zoti të bënit. Lexoni shkrimin e shenjtë ose citimin më poshtë dhe shkruani përgjigje për pyetjet.

“Organizoni veten tuaj; përgatisni çdo gjë të nevojshme” (DeB 88:119).

Cilat janë gjërat më domethënëse që mësova sot?

Çfarë do të bëj si rrjedhojë e asaj që mësova sot?



ZOTOHUNI – Koha Maksimale: 10 Minuta

Nëse ky është kapitulli juaj i fundit për këtë javë, plotësoni pjesën “Zotohuni”. Ndryshe, kaloni te faqja 116.

Lexojani çdo zotim me zë të lartë partnerit tuaj në veprim. Premtoni se do t’i mbani zotimet tuaja dhe më pas nënshkruani më poshtë. Shënoni synimet tuaja në tabelën te faqet ii–iii.

ZOTIMET E MIA

(A) Do të përcaktoj së paku pesë burime çdo ditë. *Përzgjidhni synimin tuaj.*

Ditë/Javë	Ditë/Javë	Ditë/Javë	Ditë/Javë
5/25	10/50	15/75	20/100

(B) Do të bëj të paktën tri kontakte çdo ditë. *Përzgjidhni synimin tuaj.*

Ditë/Javë	Ditë/Javë	Ditë/Javë	Ditë/Javë
3/15	5/25	7/35	10/50

(C) Do të vihem në kontakt dhe do të mbështes partnerin tim në veprim.

(D) Do ta ushtroj dhe tregoj parimin e sotëm nga Themeli Im.

(E) Do të bëj dy prej ushtrimeve nga lista Aftësitë në faqen iii.

Nënshkrimi im

Nënshkrimi i partnerit në veprim



INTERVISTA

Zgjidhni role dhe interpretoni pjesën vijuese.

Intervistuesi: “Ç’mund të më thoni rreth vetes suaj?”

Kandidati 1: “E keni fjalën, çfarë më pëlqen të bëj? Jo shumë gjëra, në të vërtetë. Nuk kam ndonjë veprimtari të parapëlqyer apo interes në të vërtetë. Pak a shumë nuk bëj asgjë.”

Kandidati 2: “Ëëë . . . e po, unë . . .”

Kandidati 3: “O, do të më pëlqente shumë t’jua thosha. Siç mund ta shihni, shpenzoj shumë kohë duke ngritur pesha. Mendohet që të shkoj edhe në klasa për kontrollimin e zemërimit. Por kush dëshiron të shkojë tek ato? A e kuptoni se ç’dua të them?”

Kandidati 1: “Apo e keni fjalën si jam unë në punë? Në të vërtetë nuk kam qëndruar aq kohë në një vend pune që të mund ta them këtë. Mërzitem shpejt dhe thjesht ndaloj së paraqituri në punë. . . . Ndoshta nuk duhet ta kisha thënë këtë.”

Kandidati 2: “Ëëë . . .”

Kandidati 3: “Dua të them, tipin që e jep atë orë mësimi për kontrollimin e zemërimit, . . . mund ta ndaj më dysh. Pra, kush do të ishte shefi im? Ju? Ej, ju nuk jeni nga ai lloj që kontrollon gjithnjë për të parë nëse jemi të zënë me punë, apo jo? Sikur jemi një tufë kalamajsh të vegjël? Shefi im i fundit e bënte atë dhe nuk e pëlqejta.”

Intervistuesi: “Përse duhet t’ju marrim në punë?”

Kandidati 2: “Duhet të më merrni në punë sepse . . . ëë . . .”

Kandidati 1: E po, unë kam nevojë për një vend pune. Mendova se mami im erdhi këtu dhe bisedoi me ju për këtë dje. Ajo tha se duhet të gjej një vend pune. Apo jo?”

Vazhdoni leximin në faqen pasuese.

Kandidati 3: “Do të ishit i marrë po të mos më merrnit në punë. Vura re kur po hyja se disa gjëra kanë nevojë vërtet të ndryshohen këtu. Është çudi që ju djema jeni ende në biznes. Unë mund ta ndreq gjithë këtë. Po. Do të më falënderonit që jua shpëtova biznesin.”

Kandidati 2: “Sepse . . . ëë . . .”

Intervistuesi: “Cila është dobësia juaj më e madhe?”

Kandidati 3: “Nuk kam ndonjë dobësi. Cila është juaja? Zotëri, i urrej pyetjet si kjo.”

Kandidati 2: Dobësi? Ëë . . .”

Kandidati 1: Ëëë . . . vjedhja. Dua të them, jo vjedhja, vërtet. Nuk ishte vjedhja. Është një histori e gjatë. Dua të them që do ta ktheja përsëri. Mendova se shefi im do të më linte ta merrja borxh për pak kohë.”

Kthehuni te faqja 99.



7

KOPSITE INTERVISTËN: PJESA 2

PARIMET, AFTËSITË DHE SHPREHITË E KËRKIMIT PËR VEND PUNE

1. Kthejini Negativet në Pozitive
2. Bëni Pyetje
3. Mbylleni Intervistën Efektshëm



RAPORTONI – Koha Maksimale: 25 Minuta

Nëse ky është kapitulli juaj i parë i kësaj jave, plotësoni pjesën “Raportoni”. Ndryshe, kaloni te faqja 116.

ZOTIMET E JAVËS SË SHKUAR

- Ⓐ Të përcaktoj burime çdo ditë.
- Ⓑ Të bëj kontakte çdo ditë.
- Ⓒ Të vihem në kontakt dhe të mbështes partnerin tim në veprim.
- Ⓓ Ta ushtroj dhe tregoj parimin e sotëm nga Themeli Im.
- Ⓔ Të ushtroj aftësi për kërkimin e një vendi pune.

HAPI 1: VLERËSONI VETVETEN (5 minuta)

Përdoreni tabelën “Vlerësimi i Përppjekjeve të Mia” në faqet ii-iii për të rishikuar zotimet tuaja të mbledhjes së fundit. Së pari, shkruani numrin e vërtetë të burimeve që gjetët dhe kontakteve që bëtë. Pastaj vlerësojeni individualisht përppjekjen tuaj për ta mbajtur secilin zotim duke i shenjuar me të kuqe, të verdhë apo të gjelbër.

VLERËSIMI I PËRPPJEKJEVE TË MIA										AFTËSITË		
Data	Ⓐ I Përcaktoj Burimet Çdo Ditë		Ⓑ Krijoj Kontakte Çdo Ditë		Ⓒ Vihem në Kontakt dhe e Përkrah Partnerin Tim në Veprim	Ⓓ E ushtroj Parimin Themel Im dhe ua Tregoj të Tjerëve	Ⓔ I Ushtroj Aftësitë për Kërkimin e një Vendi Pune (Zgjidhni dy nga lista e Aftësive.)	LEGJENDA: ● Përppjekje Mëmirë ● Përppjekje Mënyrë ● Përppjekje Më së miri ● Përppjekje Më së miri				
	Syrimi Javor	Realja	Syrimi Javor	Realja				Aftësia 1	Aftësia 2	Përppjekja	Përppjekja	
Shëmbulli	25	21	25	27	●●●	●●●	E ushtroj parimin themel dhe ua tregoj të tjerëve	●●●	●●●	●●●	●●●	<p>PËRFSHJENI ZOTIN (KAP. 1)</p> <ul style="list-style-type: none"> Luajtur për ndihmë të posaçme për kërkimin tuaj për vend pune. Ajtuara për ndihmë të posaçme për kërkimin tuaj për vend pune. <p>LINE NË 30 SEKONDA (KAP. 2)</p> <ul style="list-style-type: none"> Luajtur për herë deklarimin tuaj "Line në 30 Sekonda" dhe merri përfitimet. Herëherë deklaruar tuaj "Line në 30 Sekonda" për përfitime të ndryshme. <p>INTERVISTA INFORMIMI (SHITËJA)</p> <ul style="list-style-type: none"> Shkruani një pyetje për një informacion, Shihfaqjen 201. Luajtur në faqe informata për informim dhe merri përfitimet. Shihfaqjen 201. <p>PËRKQINI AFTËSITË (KAP. 3)</p> <ul style="list-style-type: none"> Shkruani një parafrazë për vendin tuaj dhe përshkrimi aftësitë tuaja me mendjet e përdorshme. <p>POHIME FUGJE (KAP. 4)</p> <ul style="list-style-type: none"> Shkruani 10 pohime të ndryshme tuaja. Thirrni të qartë në pohime tuaja dy gjëra dhe merri përfitimet. <p>MATERIALI ME SHKRIM (KAP. 5)</p> <ul style="list-style-type: none"> Shkruani 10 pohime të ndryshme tuaja. Shkruani një parafrazë dhe merri përfitimet nga tre rrethet. Shkruani dy pohime tuaja për të filluar letrat parafrazë. Shkruani një letër parafrazë dhe merri përfitimet nga tre rrethet. <p>INTERVISTA (KAP. 6-7)</p> <ul style="list-style-type: none"> Luajtur deklarimin tuaj "Line në 30 Sekonda" për dy informata të mundshme. Luajtur kërkimin e përgjigjeve në pyetje për intervallat dhe përdorur pohime tuaja. Luajtur për pyetje që mund të bëni në fund të një interviste. Përcaktoni tri mënyra se si mund të pyetni më së shpejti se si të ndihmoni në fund të një interviste. Luajtur kërkimin e përgjigjeve për tri pyetje interviste dhe shprehni reagimet në pyetje.
Java 1												
Java 2												
Java 3												
Java 4												
Java 5												
Java 6												
Java 7												
Java 8												
Java 9												
Java 10												
Java 11												
Java 12												

HAPI 2: TREGOJINI GRUPIT (10 minuta)

Secili nga ju raporton se si shkoi me zotimet e veta duke treguar synimet e numrat realë dhe duke e deklaruar “të kuqe”, “të verdhë” ose “të gjelbër” përpjekjen e vet. Tregoni çfarë shkoi mirë dhe se si ju ndihmoi Ati Qiellor.

HAPI 3: ZGJIDHNI PARTNERË NË VEPRIM (2 minuta)

Zgjidhni një partner në veprim nga grupi për javën që vjen. Përgjithësisht, partnerët në veprim janë të së njëjtës gjini dhe nuk janë pjesëtarë të një familjeje.

Përdorni tani disa minuta për t’u takuar me partnerin tuaj në veprim. Prezantohuni vetë dhe diskutoni se si do të viheni në kontakt me njëri-tjetrin gjatë gjithë javës.

Emri i partnerit në veprim

Informacion kontakti

Shkruani se si dhe kur do të viheni në kontakt me njëri-tjetrin këtë javë.

DIE	HËN	MAR	MËR	ENJ	PRE	SHT


Plotësoni veprimtarinë në faqen pasuese.

VEPRIMTARI (5-8 minuta)

Le ta ushtrojmë pohimin tonë Unë në 30 Sekonda.

Hapi 1: Ndahuni në grupe me të paktën tre veta, por jo më shumë se gjashtë.

Hapi 2: Secili person ngrihet dhe tregon pohimin e tij Unë në 30 sekonda duke ndjekur këto hapa:



Hapi 3: Jepini shpejt përshtypje njëri-tjetrit:

- A e treguan se çfarë vendi pune po kërkonin?
 - A e treguan se përse janë të mirë për të?
 - A kërkuan ndihmë? Në ç'mënyrë?
 - A ishte afër te 30 sekonda?
-



THEMELI IM – Koha Maksimale: 20 Minuta


Nëse ky është kapitulli juaj i parë i javës, plotësoni parimin pasues të *Themeli Im* që gjendet në fund të këtij libri. Pastaj kthehuni te faqja 116.





MËSONI – Koha Maksimale: 45 Minuta

SHTEGU DREJT NJË VENDI PUNE MË TË MIRË



Lexoni: Një kërkim i suksesshëm për vend pune ndjek këtë formulë të thjeshtë:

Veproni me Besim + Punoni Fort + Punoni me Mençuri = Sukses

Në kapitullin e mëparshëm, ne mësuam aftësitë e mëposhtme për intervistat:

- Përgatituni përpara intervistës.
- Hapeni intervistën efektshëm.
- Përdoreni deklaratën tuaj Unë në 30 sekonda.
- Përdorni pohime fuqie.

Në këtë kapitull ne do të ushtrojmë disa aftësi të tjera interviste që na ndihmojnë të punojmë me mençuri.



Kërkimi i Xhoshit për Vend Pune

Lexoni: Xhoshi ka parashikuar disa pyetje dhe ka përgatitur disa pohime fuqie për intervistën e tij te kompania ABC Marketing. Ai ka përgatitur gjithashtu një deklaratë të fortë Unë në 30 Sekonda për ta hapur intervistën efektshëm. Xhoshi do të donte të jetë sa më i përgatitur që të jetë e mundur dhe vendos t'i telefonojë ungjit të tij, Dejvidit, për t'i kërkuar këshilla për intervistë.

Ungji Dejvid i tha Xhoshit se zakonisht një intervistues e pyet punëkërkuetin rreth një dobësie. Qëllimi kryesor i kësaj pyetjeje është të trajtojë shqetësime të mundshme rreth punëkërkuetit. Ai sugjeron pasjen e disa pyetjeve për t'i bërë në fund të intervistës dhe i jep Xhoshit disa këshilla mbi mbylljen efektshëm të intervistës.

Diskutoni: Çfarë mendoni për këshillën e Ungjit Dejvid?

Lexoni: Sa më shumë që i përmirësoni aftësitë tuaja për intervistë, aq më shumë sukses do të kenë. Ju do ta dini se po intervistoheni efektshëm kur të merrni oferta për vend pune. Në këtë kapitull ne do të mësojmë dhe ushtrime aftësitë e mëposhtme për intervistat:

1. Kthejini negativet në pozitive.
2. Bëni pyetje.
3. Mbylleni intervistën efektshëm.

1. KTHEJINI NEGATIVET NË POZITIVE

Lexoni: Një punëdhënës i mundshëm mund të ketë shqetësime lidhur me marrjen tuaj në punë. Këto mund të vijnë nga historia juaj e punësimit, përvoja, mosha apo lloj-lloj gjërash të tjera. Ata shpesh do t'ju pyesin rreth këtyre gjërave në intervistë. Për shembull, ata mund të bëjnë pyetje si këto që vijojnë:

- Përse e latë pozicionin tuaj të fundit?
- Më tregoni rreth një kohe kur nuk shkonit mirë me një bashkëpunëtor.
- Cila është një nga dobësitë tuaja?

Kur përballeni me këto lloj pyetjesh, përpiquni ta zgjidhni shqetësimin e mundshëm duke përdorur fjalë të ndershme e të favorshme, parapëlqehet me një shembull.



Kërkimi i Xhoshit për Vend Pune

Lexoni: Xhoshi pyet veten nëse punëdhënësi do ta ketë shqetësim ngaqë ai është i ri e ndoshta nuk ka mjaft përvojë. Ai përdori këtë tabelë të thjeshtë për të përgatitur një përgjigje.

DOBËSI E MUNDSHME	SHQETËSIM REAL I PUNËDHËNËSIT	SI E KAPËRCEVA (DO TA KAPËRCEJ)
Mosha e re	Mungesë e mundshme njohurie apo përvojë	Kam dy vite përvojë duke dhënë shërbim për kompjutera dhe mbaj disa certifikata teknike. Në vendin tim të fundit të punës si teknik i zyrës së ndihmës, krijova një mjet të thjeshtë diagnostikimi që më lejonte të vlerësoj e zgjidh me të shpejtë nevojat lidhur me teknologjinë e informacionit të duzina klientëve çdo ditë. Si rrjedhojë, unë zgjidha mbi 1 000 kërkesa të zyrës së ndihmës teknike për dy vjet, me një mesatare sa gjysma e kohës së kolegëve të mi. Jam i sigurt se përvoja dhe aftësitë e mia mund t'i shtojnë vlerë kompanisë suaj.

Diskutoni: Çfarë vutë re te mënyra si e trajtoi Xhoshi shqetësimin e mundshëm të punëdhënësit?

VEPRIMTARI (6 minuta)

Le të ushtrojmë kthimin e negativeve në pozitive.

Hapi 1: Rishikoni shembujt, mandej përcaktoni dhe shkruani përgjigje për një nga dobësitë tuaja të mundshme.

DOBËSI E MUNDSHME	SHQETËSIM REAL I PUNËDHËNËSIT	SI E KAPËRCEVA (DO TA KAPËRCEJ)
Shembulli 1 Moshë e re	Mund të ketë mungesë pjekurie apo përvojë	Unë kam mbi pesë vite përvojë që lidhet drejtpërdrejt me vendin e punës.
Shembulli 2 Shumë lloje vendi pune në një periudhë të shkurtër kohe	Mund ta lërë postin herët	Gjatë viteve të arsimit tim, unë pata sa më shumë vende pune që mundesha pranë kompleksit universitar për të mbështetur familjen time. Tani që kam diplomën time, po kërkoj një vend pune kohëplotë në të cilën mund të bëhem i përhershëm për 5 deri 10 vitet e ardhshme.

Hapi 2: Lidhuni me partnerin tuaj në veprim. Përgjigjiuni me radhë pyetjes: “Cila është një nga dobësitë tuaja?”

Lexoni: Gjatë javës, shihni faqen 214 të shtojca për më shumë ushtrim në kthimin e një negativeje në pozitive.

2. BËNI PYETJE

Lexoni: Diku nga fundi i një interviste, ju do t'ju pyesin zakonisht nëse keni ndonjë pyetje. Ju duhet të keni disa pyetje gati që t'ju ndihmojnë të merrni më shumë informacion dhe për të treguar interes të mirëfilltë për rastin. Këtu janë disa shembuj:

- Si e ndihmon organizatën ky pozicion?
- Çfarë trajnimi bëhet për këtë rol?
- Ku mendoni se do të arrijë kompania pas pesë vitesh?

Mos pyesni rreth parash, përfitimesh apo oraresh në këtë pikë të intervistës. Mos flisni rreth këtyre gjërave derisa punëdhënësi t'i prekë ose t'ju ketë dhënë një ofertë. Për të mësuar më shumë rreth rënies në ujdi, shihni vetë faqet 215-217 te shtojca gjatë kësaj jave.

VEPRIMTARI (5 minuta)

Bëni sikur po i afroheni fundit të një interviste për lajmërimin për vend pune që sollët me vete ose për një vend pune që ju intereson. Shkruani secili dy pyetje që mund të bëni dhe tregojani partnerit tuaj në veprim.

1. _____

2. _____

3. MBYLLENI INTERVISTËN EFEKTSHËM

- Lexoni:** Ajo që thoni dhe bëni në mbyllje të intervistës suaj, mund të ketë ndikim të qëndrueshëm në atë se sa pozitivisht do ta kujtojë intervistuesi bashkëbisedimin tuaj. Ndiqni këto udhëzime:
- Kur ngriheni për t'u larguar, bëni kontakt me shikim, buzëqeshni dhe shtrëngoni duart përsëri (nëse kjo është e përshtatshme në kulturën tuaj).
 - Drejtojuni intervistuesit me emër.
 - Falënderojeni intervistuesin për kohën dhe interesin e tij apo të saj.
 - Përcaktoni cilat janë hapat e tjera në proces dhe si duhet ta ndiqni ecurinë. Ju mund të thoni diçka të thjeshtë si: "Cilat janë hapat e tjera dhe si duhet ta ndjek ecurinë?"
 - Tregoni interesin tuaj duke thënë diçka si: "U kënaqa nga biseda dhe mezi pres të dëgjoj nga ju", ose "Jam i sigurt se mund të kem një ndikim pozitiv këtu".

Diskutoni: Si do t'ju ndihmojë bërja e këtyre gjërave që të keni intervista të suksesshme?

PËRFUNDIM

Shikoni: “Amy Nails Her Interview” [“Emi i Bie në Shenjë Intervistës së Saj”], në dispozicion te srs.ids.org/videos. (Nuk keni material filmik? Lexoni faqen 126.)



Diskutoni: Cilat janë gjërat më të rëndësishme që mësuat nga ky kapitull?

Lexoni: Ju keni tani disa aftësi interviste që t’ju ndihmojnë të punoni me mençuri.

Veproni me Besim + Punoni Fort + Punoni me Mençuri = Sukses

Zoti ka premtuar: “Nëse jeni të përgatitur, ju s’do të frikësoheni” (DeB 38:30). Përgatituni duke u lutur për ndihmë dhe duke u ushtruar sa më shumë që mundeni.



PËRSIATNI – Koha Maksimale: 5 Minuta

Individualisht mendoni rreth asaj që keni mësuar sot, dhe merrni parasysh se çfarë do të donte Zoti të bënit. Lexoni shkrimin e shenjtë ose citimin më poshtë dhe shkruani përgjigje për pyetjet.

“Sepse Perëndia nuk na ka dhënë frymë frike, por force, dashurie dhe urtësie” (2 Timoteut 1:7).

Cilat janë gjërat më domethënëse që mësova sot?

Çfarë do të bëj si rezultat i asaj që mësova sot?



ZOTOHUNI – Koha Maksimale: 10 Minuta

**Nëse ky është kapitulli juaj i fundit për këtë javë, plotësoni pjesën “Zotohuni”.
Ndryshe, kaloni te faqja 132.**

Lexojani çdo zotim me zë të lartë partnerit tuaj në veprim. Premtoni se do t'i mbani zotimet tuaja dhe më pas nënshkruani më poshtë. Shënoni synimet tuaja në tabelën te faqet ii-iii.

ZOTIMET E MIA

Ⓐ Do të përcaktoj së paku pesë burime çdo ditë. *Përzgjidhni synimin tuaj.*

Ditë/Javë	Ditë/Javë	Ditë/Javë	Ditë/Javë
5/25	10/50	15/75	20/100

Ⓑ Do të bëj të paktën tri kontakte çdo ditë. *Përzgjidhni synimin tuaj.*

Ditë/Javë	Ditë/Javë	Ditë/Javë	Ditë/Javë
3/15	5/25	7/35	10/50

Ⓒ Do të vihem në kontakt dhe do të mbështes partnerin tim në veprim.

Ⓓ Do ta ushtroj dhe tregoj parimin e sotëm nga Themeli Im.

Ⓔ Do të bëj dy prej ushtrimeve nga lista e Aftësive në faqen iii.

Nënshkrimi im

Nënshkrimi i partnerit në veprim



BURIMET

EMI I BIE NË SHENJË INTERVISTËS SË SAJ

Le të lexojmë se si përgatitja dhe ushtrimi i Emit e ndihmuan që të ketë një intervistë të shkëlqyer.

“Kur mora diplomën, mendova se do të gjeja punë shpejt. E kisha gabim. Arsimi im nuk kishte mbaruar ende. Më duhej të mësoja se si të gjeja një vend pune. Kështu që iu futa punës – mësova si të krijosh një rrjet. Mësova si të bëja jetëshkrimin tim që të ketë më shumë lidhje me vendet [e punës] që kërkoja. Dhe duhej të ushtroja aftësitë e mia për intervistë. Intervistat gjithnjë më kanë bërë nervoze dhe kur bëhem nervoze, më mbahet goja dhe truri më bllokohet. Kështu që doja të përgatitesha sa më shumë që mundesha. Një mik në kishë më rekomandoi te një menaxher në një punëdhënës vendor. Menaxheri më telefonoi dhe caktuam një intervistë. Bëra një frymëmarrje të thellë dhe i ushtrova përgjigjet e mia për çdo pyetje shumë herë përpara pasqyrës dhe me miq duke përdorur deklaratat Unë në 30 Sekonda, pohimet e fuqisë, dhe kthimin e negativeve në pozitive. Gjithashtu u luta për vetëbesim dhe ndihmë nga Ati im Qiellor.

Kur erdhi dita për intervistën time, unë ende isha nervoze, por gjithashtu ndihesha e përgatitur. U veshja pak më mirë sesa veshja e zakonshme e punës dhe arrita shtatë minuta më herët. Përfundova duke u intervistuar nga një grup menaxherësh. E hapa intervistën me deklaratën *Unë në 30 Sekonda* dhe gjërat përparuan prej atje. Isha ushtruar thuajse për çdo pyetje që më bënë. Edhe nëse do të më bënë një pyetje që nuk e pata ushtruar, unë do të kisha diçka për të thënë sepse isha aq e familjarizuar me aftësitë për intervistë. Intervista dukej më shumë si një bashkëbisedim dhe e dija se Ati Qiellor po më ndihmonte. Kur intervista përfundoi, unë e dija se kisha dalë mirë. Disa ditë më vonë, ma ofruan vendin e punës. Unë e di se të qenit e përgatitur dhe plot lutje më ndihmuan të kem sukses në intervistën për vend punë.”

Kthehuni te faqja 123.



8

INTERVISTA USHTRIMORE

PARIMET, AFTËSITË DHE SHPREHITË E KËRKIMIT PËR VEND PUNE

1. Ushtrimi të Bën të Përsosur



RAPORTONI – Koha Maksimale: 25 Minuta

Nëse ky është kapitulli juaj i parë i kësaj jave, plotësoni pjesën “Raportoni”. Ndryshe, kaloni te faqja 132.

ZOTIMET E JAVËS SË SHKUAR

- Ⓐ Të gjej burime çdo ditë.
- Ⓑ Të krijoj kontakte çdo ditë.
- Ⓒ Të vihem në kontakt dhe të mbështes partnerin tim në veprim.
- Ⓓ Ta ushtroj dhe tregoj parimin e sotëm nga Themeli Im.
- Ⓔ Të ushtroj aftësi për kërkimin e një vendi pune.

HAPI 1: VLERËSONI VETVETEN (5 minuta)

Përdoreni tabelën “Vlerësimi i Përpjekjeve të Mia” në faqet ii-iii për të rishikuar zotimet tuaja të mbledhjes së fundit. Së pari, shkruani numrin e vërtetë të burimeve që gjetët dhe të kontakteve që bëtë. Pastaj vlerësojeni individualisht përpjekjen tuaj për ta mbajtur secilin zotim duke i shenjuar me të kuqe, të verdhë apo të gjelbër.

VLERËSIMI I PËRPJEKJEVE TË MIA										AFTËSITË		
Data	Ⓐ I Përcaktoj Burimet Çdo Ditë		Ⓑ Krijoj Kontakte Çdo Ditë		Ⓒ Vihem në Kon- takti dhe e Për- krak Partnerin Tim në Veprim	Ⓓ E ushtroj Parimin Themeli Im dhe ua Tregoj të Tjerëve	Ⓔ I Ushtroj Aftësitë për Kërki- min e një Vendi Pune (Zgjidhni dy nga lista e Aftësive.)	LEGJENDA: ● Përpjekje Mundësisht ● Përpjekje Mundësisht ● Përpjekje të Bashkëkohshme				
	Syrimi javor	Realja	Syrimi javor	Realja				Aftësia 1	Për- pjekja	Aftësia 2	Për- pjekja	
Sham- bulli	25	21	25	27	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●
Java 1		●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●
Java 2		●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●
Java 3		●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●
Java 4		●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●
Java 5		●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●
Java 6		●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●
Java 7		●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●
Java 8		●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●
Java 9		●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●
Java 10		●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●
Java 11		●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●
Java 12		●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●

PËRSHENI ZOTIN (KAP. 1)
 • Luajni për ndihmë të posaçme për kërkimin tuaj për vend pune.
 • Agjëroni për ndihmë të posaçme për kërkimin tuaj për vend pune.

LINE NË 25 SEKONDA (KAP. 2)
 • Ushtrojeni pesë herë deklaratën tuaj "Line në 30 Sekonda" dhe merri përfitimet.
 • Përdoret deklarata tuaj "Line në 30 Sekonda" për përkrahje të ndihmës.

INTERVISTA INFORMIMI (SHITJA)
 • Shikoni pjesë të pyetjeve për informacione të reja.
 • Shikoni faqen 201.

PËRKOHINI AFTËSITË (KAP. 3)
 • Shikoni pjesë të pyetjeve për vend pune dhe përkrahje të ndihmës tuaj me mjetet e punës.

POHIME FUNDI (KAP. 4)
 • Shikoni 10 pohime të ndihmës tuaj.
 • Thirrni të qendrën e ndihmës tuaj dhe merri përfitimet.

MATERIALI ME SHIKIM (KAP. 5)
 • Shikoni 10 pohime të ndihmës tuaj.
 • Shikoni një pjesë të ndihmës tuaj dhe merri përfitimet nga tre rrethet.
 • Shikoni dy pohime tuaj për të filluar letrat.
 • Shikoni një listë paraqitje dhe merri përfitimet nga tre rrethet.

INTERVISTI (KAP. 6-7)
 • Ushtrojeni pesë herë deklaratën tuaj "Line në 30 Sekonda" për dy intervista të mundshme.
 • Ushtrojeni intervistën e përgjigjeve në pyetje për intervistën dhe përkrahje të ndihmës tuaj.
 • Ushtrojeni pjesë të pyetjeve që mund të bëjnë në fund të një interviste.
 • Përdoret tri mënyra të shtuar të pyetjeve për të filluar letrat.
 • Ushtrojeni intervistën e përgjigjeve për tri pyetje inter-
 visticë dhe përkrahje të ndihmës tuaj.

HAPI 2: TREGOJINI GRUPIT (10 minuta)

Secili nga ju raporton se si shkoi me zotimet e veta duke treguar synimet e numrat realë dhe duke e deklaruar “të kuqe”, “të verdhë” ose “të gjelbër” përpjekjen e vet. Tregoni çfarë shkoi mirë dhe se si ju ndihmoi Ati Qiellor.

HAPI 3: ZGJIDHNI PARTNERË NË VEPRIM (2 minuta)

Zgjidhni një partner në veprim nga grupi për javën që vjen. Përgjithësisht, partnerët në veprim janë të së njëjtës gjini dhe nuk janë pjesëtarë të një familjeje.

Përdorni tani disa minuta për t’u takuar me partnerin tuaj në veprim. Prezantohuni vetë dhe diskutoni se si do të viheni në kontakt me njëri-tjetrin gjatë gjithë javës.

Emri i partnerit në veprim

Informacion kontakti

Shkruani se si dhe kur do të viheni në kontakt me njëri-tjetrin këtë javë.

DIE	HËN	MAR	MËR	ENJ	PRE	SHT


Plotësoni veprimtarinë në faqen pasuese.

VEPRIMTARI (5-8 minuta)

Le t'i ushtrojmë pohimet tona të fuqisë.

Hapi 1: Ndahuni në grupe me të paktën tre veta, por jo më shumë se gjashtë.

Hapi 2: Secili person ngrihet dhe thotë një pohim fuqie duke ndjekur këto hapa:



Hapi 3: Jepini shpejt përshtypje njëri-tjetrit:

- Çfarë aftësie pretendonin ata?
 - Cili ishte shembulli i tyre?
 - Cili qe rezultati?
 - Si e përshtatën me nevojat e punëdhënësit?
 - A ju la mbresa?
-



THEMELI IM – Koha Maximale: 20 Minuta


Nëse ky është kapitulli juaj i parë i javës, plotësoni parimin pasues të *Themeli Im* që gjendet në fund të këtij libri. Pastaj kthehuni te faqja 132.





MËSONI – Koha Maksimale: 45 Minuta

SHTEGU DREJT NJË VENDI PUNE MË TË MIRË



Lexoni: Një kërkim i suksesshëm për vend pune ndjek këtë formulë të thjeshtë:

Veproni me Besim + Punoni Fort + Punoni me Mençuri = Sukses

Në dy kapitujt e fundit mësuat disa aftësi interviste që t'ju ndihmojnë të punoni me mençuri. Në këtë kapitull ju do t'i ushtroni ato.

1. USHTRIMI TË BËN TË PËRSOSUR

Lexoni: Ushtrimi për një intervistë do ta rritë suksesin tuaj. Do t'ju ndihmojë të ndiheni më këndshëm dhe më të përgatitur kur të jeni në një intervistë të vërtetë pune.

Këtu janë disa aftësi interviste që keni mësuar:

- Përgatituni përpara intervistës.
- Hapeni intervistën efektshëm.
- Përdoreni deklaratën tuaj Unë në 30 sekonda.
- Kthejini negativet e mundshme në pozitive.
- Bëni pyetje.
- Mbylleni intervistën efektshëm.

Secili nga ne me radhë do të bëjë një intervistë ushtrimore.

Në secilin ushtrim ka tri role:

1. Punëkërkuesi/ja
2. Intervistuesi/ja
3. Grupi që jep përshtypje

Ndërsa secili nga ju do të bëjë intervistën e vet ushtrimore, shihni së pari këtë material filmik për të parë se si duhet bërë kjo. Pastaj lexoni dhe ndiqni udhëzimet e veprimtarisë.

Shikoni: “Practice Interview Example” [“Shembull Interviste Ushtrimore”], në dispozicion te srs.ids.org/videos. (Nuk keni material filmik? Shihni faqen 138.)



VEPRIMTARI (35 minuta)

Si grup, lexoni të gjitha hapat përpara fillimit të kësaj veprimtarie.

Hapi 1: Ndahuni në grupe me të paktën tre veta, por jo më shumë se gjashtë.

Hapi 2: Përpara grupit tuaj vendosni dy karrige përballë njëra-tjetrës.

Hapi 3: Për radhën e parë secili grup ka nevojë për një vullnetar që të jetë intervistuesi i parë dhe një tjetër që të jetë punëkërkuues i parë. Gjithkush tjetër do të jetë në grupin që jep përshtypje. Kush dëshiron të fillojë i pari?

Hapi 4: Lexojini deri në fund udhëzimet për rolin tuaj përpara se të filloni intervistën ushtrimore.

1. Punëkërkuuesi, faqe 143.
2. Intervistuesi, faqe 144.
3. Grupi që jep përshtypje faqe 145.

Hapi 5: Bëni intervistën ushtrimore. Ajo duhet të jetë gjashtë deri në tetë minuta për intervistë, përfshirë përshtypjet.

Hapi 6: Ndërroni rolet dhe përsëriteni intervistën ushtrimore derisa secili të ketë pasur mundësi të jetë punëkërkuuesi.

Diskutoni:

- Si ju ndihmoi të ushtruarit në përgatitjen për intervistën tuaj?
- Si mund të jetë të ushtruarit për intervistë një shprehje besimi?

PËRFUNDIM

Shikoni: “Practice Makes Perfect” [“Ushtrimi të Bën të Përsosur”], në dispozicion te srs.ids.org/videos. (Nuk keni material filmik? (Shihni faqen 146.)



Diskutoni: Cilat janë gjërat më të rëndësishme që mësuat nga ky kapitull?

Lexoni: Të ushtruarit për intervista ju ndihmon të përmirësoni aftësitë tuaja dhe të punoni me mençuri.

Veproni me Besim + Punoni Fort + Punoni me Mençuri = Sukses

Ju e dini që po intervistoheni suksesshëm kur merrni oferta për vend pune. Nëse po merreni vazhdimisht në intervista, por nuk po merrni oferta për vend pune, përmirësojini aftësitë tuaja me më shumë ushtrim dhe do të shihni më shumë sukses. Ati Qiellor do t’ju bekojë që e shfaqni besimin tuaj ndërsa ushtroheni.



PËRSIATNI – Koha Maksimale: 5 Minuta

Individualisht mendoni rreth asaj që keni mësuar sot, dhe merrni parasysh se çfarë do të donte Zoti të bënit. Lexoni shkrimin e shenjtë ose citimin më poshtë dhe shkruani përgjigje për pyetjet.

“Mos kërko të shpallësh fjalën time, por së pari ta fitosh fjalën time dhe atëherë gjuha jote do të zgjidhet; atëherë, nëse dëshiron, ti do të kesh Shpirtin tim dhe fjalën time, po, fuqinë e Perëndisë për të bindur njerëzit” (DeB 11:21).

Cilat janë gjërat më domethënëse që mësova sot?

Çfarë do të bëj si rezultat i asaj që mësova sot?



ZOTOHUNI – Koha Maksimale: 10 Minuta

Nëse ky është kapitulli juaj i fundit për këtë javë, plotësoni pjesën “Zotohuni”. Përndryshe, kaloni te faqja 152.

Lexojani çdo zotim me zë të lartë partnerit tuaj në veprim. Premtoni se do t'i mbani zotimet tuaja dhe më pas nënshkruani më poshtë. Shënoni synimet tuaja në tabelën te faqet ii-iii.

ZOTIMET E MIA

Ⓐ Do të përcaktoj së paku pesë burime çdo ditë. *Përzgjidhni synimin tuaj.*

Ditë/Javë	Ditë/Javë	Ditë/Javë	Ditë/Javë
5/25	10/50	15/75	20/100

Ⓑ Do të bëj të paktën tri kontakte çdo ditë. *Përzgjidhni synimin tuaj.*

Ditë/Javë	Ditë/Javë	Ditë/Javë	Ditë/Javë
3/15	5/25	7/35	10/50

Ⓒ Do të vihem në kontakt dhe do të mbështes partnerin tim në veprim.

Ⓓ Do ta ushtroj dhe tregoj parimin e sotëm nga Themeli Im.

Ⓔ Do të bëj dy prej ushtrimeve nga lista e Aftësive në faqen iii.

Nënshkrimi im

Nënshkrimi i partnerit në veprim



BURIMET

SHEMBULL INTERVISTE USHTRIMORE

Zgjidhni rolet dhe interpretoni skenarin vijues. Në varësi të madhësisë së grupit, ju mund të luani disa role.

- Tregimtari
- Ndërmjetësi
- Dejvidi (Intervistuesi)
- Xheniferi (Punëkërkesja)
- Anëtar Grupi 1
- Anëtar Grupi 2
- Anëtar Grupi 3

Përfytyroni sikur po kërkoni në një grup të mbështetjes te vetja lidhur me bërjen e veprimtarisë së intervistës ushtrimore.

Ndërmjetësi: Pra, për të filluar me intervistat tona ushtrimore, duket se na nevojiten dy vullnetarë – njëri do të jetë intervistuesi dhe tjetri do të jetë punëkërkesi. A ka vullnetarë?

Dejvidi: Unë do të përpiqem të jem intervistuesi për këtë radhë.

Xheniferi: Unë do të jem punëkërkesja. Mund të filloj e para gjithashtu.

Ndërmjetësi: Bukur! Përpara se të dilni këtu përpara, Xhenifer, a mund të na tregoni shkurt rreth vendit të punës për të cilën jeni e interesuar?

Xheniferi: Sigurisht. Unë jam e interesuar për një pozicion si arkëtare në një bankë vendore.

Ndërmjetësi: Faleminderit. Tani, ejani ju lutem të dy përpara që të filloni intervistën ushtrimore. Dejvid, kujtoni që keni një skenar dhe pyetje model për t'i ndjekur si intervistuesi.

Vazhdoni te faqja tjetër.

Dejvidi (intervistuesi): Mirë se erdhët, Xhenifer. Mezi po pres të bisedoj me ju. Ju lutem, uluni.

Xheniferi (punëkërkesja): Faleminderit.

Dejvidi (intervistuesi): Xhenifer, për ta filluar, ju lutem a mund të më tregoni pak rreth vetes suaj?

Xheniferi (punëkërkesja): Me kënaqësi. Gjithmonë më ka pëlqyer të punoj me klientë. Kam më shumë se gjashtë vjet përvojë me shërbim ndaj klientit, përfshirë tre me një institucion tjetër financiar. Në secilin nga pozicionet e mia të mëparshme kam arritur me shpejtësi një emër të mirë për qëndrueshmëri dhe saktësi. Për shembull, te ABC Bank, m'u kërkua të kryeja kontrollin e përditshëm financiar vetëm pas një muaji në punë. Përveç kësaj, unë kam një diplomë për studime dyvjeçare në financë. Jam e sigurt se përvoja dhe aftësitë e mia do t'u përshtaten mirë nevojave tuaja.

Dejvidi (intervistuesi): Faleminderit. A mund të më tregoni ju lutem rreth një problemi që keni zgjidhur?

Xheniferi (punëkërkesja): Po. Kur isha arkëtare në ABC Bank, po përpunoja depozitën tonë të natës dhe ishte mangët disa mijëra dollarë. E numërova edhe dy herë të tjera për të qenë e sigurt. Depozita jonë nuk kishte dalë kurrë aq shumë mangët. Fola me arkëtarët e tjerë dhe ndoqa procedurën tonë për të vërtetuar transaksionet e tyre. Isha në gjendje të zbuloja një gabim nga njëri prej arkëtarëve. Ne punuam së bashku dhe e korrigjuam shpejt gabimin. Si rezultat, ne patëm një depozitë të bilancuar dhe ishte një mundësi mësimi për arkëtarin. Unë besoj se aftësitë e mia për të zgjidhur probleme do ta ndihmojnë këtë bankë gjithashtu.

Dejvidi (intervistuesi): Faleminderit. A mund të më tregoni përse e latë pozicionin tuaj të fundit?

Vazhdoni te faqja pasuese.

Xheniferi (punëkërkuësja): Faleminderit që më pyesni. Mua më pëlqeu koha ime në ABC Bank dhe fitova përvojë të vlefshme atje. Kohët e fundit unë u shpërngula në këtë zonë për të ndjekur arsimit tim. Si rezultat, duhej ta lija pozicionin tim. Sidoqoftë, u kënaqa shumë që gjeta një mundësi ku mund t'i vë përsëri në punë aftësitë dhe përvojën time. Unë planifikoj të jem këtu për disa vite. A i dha ajo përgjigje pyetjes suaj?

Dejvidi (intervistuesi): Po. Ju faleminderit. Xhenifer, a keni ndonjë pyetje për mua?

Xheniferi (punëkërkuësja): Po, kam. A mund të më thoni se si është një ditë normale në këtë pozicion?

Dejvidi (intervistuesi): Sigurisht. Shumica e kohës suaj do të shpenzohet duke ndërvepruar me klientët tanë. Ne kemi disa që vijnë në bankë çdo ditë, si dhe ata që kryejnë veprime nga automjeti. Ju do të ndihmoni gjithashtu që të reklamohen produkte të tjera financiare, si llogaritë rrjedhëse ose huadhëniet. Ju përmendët bilancimin e depozitave, që është një tjetër detyrë e përditshme.

Xheniferi (punëkërkuësja): Faleminderit. Puna me klientët ishte një nga gjërat e mia të parapëlqyera në pozicionin e mëparshëm.

Dejvidi (intervistuesi): Mirë. A keni ndonjë pyetje tjetër?

Xheniferi (punëkërkuësja): Jo. Faleminderit për mundësinë që të bisedoj me ju. Mezi pres të dëgjoj nga ju.

Dejvidi (Intervistuesi): Mua më pëlqeu biseda jonë gjithashtu. Do të mbetemi në kontakt. Ju faleminderit.

Tregimtari: Dejvidi dhe Xheniferi marrin frymë të lehtësuar e kthehen dhe i buzëqeshin pjesës tjetër të grupit. Grupi duartroket për ta.

Xheniferi: Në rregull, të gjithëve, si veprova unë?

Vazhdoni te faqja tjetër.

Anëtar Grupi 1: Xhenifer, unë mendova se bëre mirë shumë gjëra. Për shembull, kur Dejvidi të kërkoi t'i tregoje rreth vetes, ti i re në shenjë me një deklaratë të mirë Unë në 30 Sekonda. Ajo lidhej me punën, jo tepër e gjatë as tepër e shkurtër dhe ti madje fute një shembull të shkurtër atje për të krijuar besueshmëri. Punë e bukur!

Xheniferi: Ua, ma merr mendja se e bëra atë! Faleminderit. Çfarë tjetër?

Anëtar Grupi 2: Mua më pëlqeu që përdore pohim fuqie për t'iu përgjigjur pyetjes së Dejvidit rreth zgjidhjes së një problemi. Ti tregove një shembull të rregullimit të një depozite. Pyes veten gjithsesi, a ka shembuj të tjerë problemesh më të vështira që mund t'i kesh zgjidhur? A ishte depozita një problem i zakonshëm?

Xheniferi: Ke të drejtë. Sigurisht ishte e lidhur me nevojat e bankës, por çështjet e depozitave ishin të zakonshme. Unë do të punoj për një pohim fuqie të lidhur me një problem më të vështirë, ngaqë ajo pyetje mund të më dalë përsëri. Kjo është e mrekullueshme. Çfarë përshtypjesh të tjera keni?

Anëtar Grupi 3: Punë e bukur në kthimin e negatives në pozitive me lënien e punës suaj të fundit. Vë bast se punëdhënësi do të shqetësohej edhe rreth qëndrimit gjatë për ta. Ju u thatë se planifikoni të ishit atje për disa vite. Mendoj se kjo i ndihmoi të ndiheshin më rehat.

Xheniferi: Faleminderit.

Dejvidi: Vura re diçka me të cilën mund të doni të punoni.

Xheniferi: Oh, mirë. Çfarë ishte?

Vazhdoni te faqja pasuese.

Dejvidi: Në fund të intervistës, kur pyeta nëse kishit ndonjë pyetje, pyetja juaj e parë ishte e shkëlqyer. Sidoqoftë, vura re se ju nuk pyetët për mënyrën si të ndiqni ecurinë se si ose kur punëdhënësi do të merrte një vendim. Unë mbaj mend se kishte një këshillë nga mbyllja efektshëm e një interviste – që ne duhet të përpiqemi të kuptojmë se si mund të ndjekim ecurinë. Në njëfarë mënyre kjo e vendos disi në kontrollin tonë këtë, në vend që thjesht të presim të marrim përgjigje.

Xheniferi: Ke të drejtë! Isha aq e lumtur që pata mbajtur mend të bëja çfarëdo pyetje saqë e harrova tërësisht atë. Unë do të duhet të vazhdoj të ushtrohem. Ndonjë gjë tjetër?

Anëtar Grupi 1: Mos harro t'i dërgosh Dejvidit menjëherë një kartë falënderimi!

Xheniferi: Ide e mirë. Në rregull, tani është radha ime të jem intervistuesja dhe më bie të zgjedh personin tjetër. Olivia, do të doje të vije tani? Të premtoj se do të jem e mirë!

Kthehuni te faqja 134.

PUNËKËRKUESI

Bëni sikur jeni në një intervistë për pozicionin e reklamuar të vendit të punës që e sollët me vete sot, ose një vend pune për të cilën interesoheni.

- Përpara se të filloni intervistën, tregojini grupit një përshkrim të shkurtër të vendit të punës.
- Intervistuesi do t'ju mirëpresë atëherë dhe do të fillojë intervistën.
- Përgjigjiuni pyetjeve të intervistuesit duke përdorur aftësitë tuaja për intervistë.
- Pasi të mbarohet ushtrimi juaj, kërkoni përshtypje nga grupi.
- Pas diskutimit me përshtypjet, kaloni te roli i intervistuesit dhe zgjidhni personin tjetër për t'u intervistuar.

Për udhëzime mbi mënyrën se si të luani rolin e intervistuesit, shkoni te faqja 144.

Për udhëzime mbi mënyrën se si të luhet roli i grupit që jep përshtypje, shkoni te faqja 145.

Kthehuni te faqja 134.

INTERVISTUESI

- Pasi punëkërkuksi i ka përshkruar punën grupit, ndiqni këtë shënim.
- Përshëndetni intervistuesin, shtrëngoni duart dhe i thoni punëkërkuksit të ulet. Uluni. Falënderojeni që erdhi për intervistë.
 - Bëni pyetjen 1: "Më tregoni diçka rreth vetes suaj".
 - Bëni pyetjen 2: (Zgjidhni një pyetje nga lista "Modele Pyetjesh Interviste" më poshtë.)
 - Bëni pyetjen 3: (Zgjidhni një pyetje nga lista "Modele Pyetjesh Interviste" më poshtë.)
 - Pyetja 4: "A keni ndonjë pyetje për mua?" (Ju mund të krijoni përgjigje për pyetjet e punëkërkuksit.)
 - Falënderojeni punëkërkuksin për kohën e tij apo të saj. I thoni punëkërkuksit se do ta kontaktoni lidhur me vendimin tuaj.

Modele Pyetjesh Interviste

- Më tregoni për një kohë kur nuk ratë dakord me një mbikëqyrës dhe si e trajtuat problemin.
- Më tregoni rreth një problemi të vështirë që keni zgjidhur.
- Cilat janë anët tuaja të forta?
- Cila është arritja juaj profesionale më e fortë?
- Më tregoni për një dështim që e përjetuat në punë dhe çfarë mësuat prej tij?
- Me çfarë lloj mbikëqyrësi punoni më mirë?
- Çfarë pritni nga ne si punëdhënës që ju të jeni i suksesshëm?
- Përse e doni këtë vend pune?
- Përse duhet t'ju marrim ju në punë?
- Çfarë ju kualifikon për këtë pozicion?
- Cila është dobësia juaj më e madhe?
- Përse e latë pozicionin tuaj të fundit? Ose përse po merrni parasysh ta lini pozicionin tuaj të tanishëm?

Për udhëzime mbi mënyrën se si të luhet roli i punëkërkuksit, shkoni te faqja 143.

Për udhëzime mbi mënyrën se si të luhet roli i grupit që jep përshtypje, shihni pjesën më poshtë.

Kthehuni te faqja 134.

GRUPI QË JEP PËRSHTYPJE

Roli juaj është të jepni përshtypje.

- Vëreni si vepron punëkërkuessi. Vëzhgoni ato që ai apo ajo i bën mirë dhe çfarë mund të përmirësohet. Nxitjet nga përshtypjet më poshtë do t'ju ndihmojnë të dini se çfarë të vëzhgoni.
- Në fund të intervistës, punëkërkuessi do të kërkojë përshtypjet. Tregojeni atë që vutë re.

Nxitjet nga Përshtypjet

- A la personi një mbresë të parë të mirë duke shtrënguar duart dhe duke e përshëndetur intervistuesin?
- Si ishte gjuha e trupit e punëkërkuessit gjatë intervistës?
- A e përdori punëkërkuessi/ja deklaratën e tij/saj Unë në 30 Sekonda? A lidhej ajo me vendin e punës? A ishte tepër e gjatë apo tepër e shkurtër?
- A i përdori punëkërkuessi pohimet e fuqisë për t'iu përgjigjur pyetjeve të intervistës?
- A kishte një mundësi për të kthyer diçka negative në pozitive? Si e bëri punëkërkuessi këtë?
- A bëri pyetje punëkërkuessi në fund?
- A përcaktoi punëkërkuessi cilët ishin hapat e tjerë dhe si do ta ndiqte ecurinë?

Për udhëzime mbi mënyrën se si të luhet roli i punëkërkuessit, shkoni te faqja 143.

Për udhëzime mbi mënyrën se si të luhet roli i intervistuesit, shkoni te faqja 144.

Kthehuni te faqja 134.

USHTRIMI BËN PËRSOSMËRI

Henri tregon se si ushtrimi e ndihmoi të ketë intervista të shkëlqyera.

“Unë kalova nëpër pesë cikle intervistash për ta gjetur punën time. Secili ishte i vështirë, por isha i përgatitur. Do të ishte e lehtë të shpërqendrohesha ose të lija jashtë informacione të rëndësishme rreth vetes, por siç po them, unë u përgatita . . . mendoj se u tejpreparova! Disa nga intervistat e mia qenë me telefon, të tjera me pajisje për material filmik dhe e fundit ishte personalisht. Për t’u përgatitur për çdo intervistë, u ushtrova me të tjerë. Unë do t’u bëja pyetje që parashikoja se do t’ua bënte një intervistues dhe ata do të m’i bënin mua për të parë si do të reagoja. Kur erdhi koha e intervistave reale, unë isha ushtruar thuhet për çdo pyetje. Kjo solli një ndryshim tepër të madh te vetëbesimi im. Unë përdora deklaratat Unë në 30 Sekonda, pohimet e fuqisë dhe aftësi të tjera dhe e di se ishte kjo që më bëri të dallohem. Kompania e dinte se unë do të bëja një punë të mirë për ta ngaqë munda ta demonstroj suksesin tim të mëparshëm dhe isha i mirë nën presion.

Një nga aspektet më të rëndësishme të përgatitjes sime ishte lutja. Unë i kërkova Atit Qiellor të më ndihmonte të isha i përgatitur dhe i qetë. Unë bëra pjesën time gjatë gjithë ushtrimit dhe unë e di se Ai më ndihmoi ngaqë unë shfaqja besim. Unë e di se sukcesi im erdhi ngaqë unë bëra përpjekjen për t’u ushtruar e përgatitur për intervistat e mia.”

Kthehuni te faqja 135.



9

PËRSHPEJTONI KËRKIMIN TUAJ PËR VEND PUNE

PARIMET, AFTËSITË DHE SHPREHITË E KËRKIMIT PËR VEND PUNE

1. Punoni Fort: 15-10-2
2. Punoni me Mençuri



RAPORTONI – Koha Maksimale: 25 Minuta

Nëse ky është kapitulli juaj i parë i kësaj jave, plotësoni pjesën “Raportoni”. Përndryshe, kaloni te faqja 152.

ZOTIME TË JAVËS SË SHKUAR

- Ⓐ Të gjej burime çdo ditë.
- Ⓑ Të bëj kontakte çdo ditë.
- Ⓒ Të vihem në kontakt dhe të mbështes partnerin tim në veprim.
- Ⓓ Ta ushtroj dhe tregoj parimin e sotëm nga Themeli Im.
- Ⓔ Të ushtroj aftësi për kërkimin e një vendi pune.

HAPI 1: VLERËSONI VETVETEN (5 minuta)

Përdoreni tabelën “Vlerësimi i Përpjekjeve të Mia” në faqet ii-iii për të rishikuar zotimet tuaja të mbledhjes së fundit. Së pari, shkruani numrin e vërtetë të burimeve që gjetët dhe kontaktet që bëtë. Pastaj vlerësojeni individualisht përpjekjen tuaj për ta mbajtur secilin zotim duke i shenjuar me të kuqe, të verdhë apo të gjelbër.

VLERËSIMI I PËRPPJEKJEVE TË MIA										AFTËSITË		
Data	Ⓐ I Përcaktoj Burimet Çdo Ditë		Ⓑ Krijoj Kontakte Çdo Ditë		Ⓒ Vihem në Kontakt dhe e Përkrah Partnerin Tim në Veprim	Ⓓ E ushtroj Parimin Themeli Im dhe ua Tregoj të Tjerëve	Ⓔ I Ushtroj Aftësitë për Kërkimin e një Vendi Pune (Zgjidhni dy nga lista e Aftësive.)	LEGJENDA: ● Përpjekje Mësimore ● Përpjekje Mbrojtëse ● Përpjekje të Bërditshme				
	Syrimi Javor	Realizoj	Syrimi Javor	Realizoj				Aftësia 1	Përpjekja	Aftësia 2	Përpjekja	
Shëmbull	25	21	25	27	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●	●●●
Java 1												
Java 2												
Java 3												
Java 4												
Java 5												
Java 6												
Java 7												
Java 8												
Java 9												
Java 10												
Java 11												
Java 12												

PËRSHËNI ZOTIN (KAP. 1)

- Luloni për ndihmë të posaçme për kërkimin tuaj për vend pune.
- Agjëroni për ndihmë të posaçme për kërkimin tuaj për vend pune.

LINE NË 25 SEKONDA (KAP. 2)

- Ushtrojeni pesë herë deklaratën tuaj “Line në 30 Sekonda” dhe merri përfitime.
- Përdoroni deklaratën tuaj “Line në 30 Sekonda” për përkrahje të ndihmës.

INTERVISTA INFORMIMI (SHITJA)

- Shkruani pesë pyetje për të marrë informim, Shihfaqen 201.
- Ushtrojeni në të njëjtën mënyrë për informim dhe merri përfitime. Shihfaqen 201.

PËRKOHINI AFTËSITË (KAP. 3)

- Shqyrtoni pesë parashkrimet për vendet tuaja dhe përkrahje afërsisht tuaja me mësuesit e punëdhënës.

POHIME FUGUE (KAP. 4)

- Shkruani 10 pohime të ndryshme tuaja.
- Thirrni të qatën në pohime tuaja dhe pyetje dhe merri përfitime.

MATERIALI ME SHKRIM (KAP. 5)

- Shkruani 10 pohime të ndryshme tuaja.
- Shkruani një parashkrim dhe merri përfitime nga tre rrethet.
- Shkruani dy pohime tuaja për të filluar letrat parashkrim.
- Shkruani një letër parashkrim dhe merri përfitime nga tre rrethet.

INTERVISTA (KAP. 6-7)

- Ushtrojeni deklaratën tuaj “Line në 30 Sekonda” për dy intervista të mundshme.
- Ushtrojeni kërkimin e përgjigjeve në dy pyetje të intervistës dhe përkrahje tuaja.
- Ushtrojeni pesë pyetje që mund të bëhen në fund të një interviste.
- Përdoroni tri mënyra të si mund të pyetni më afër se si të kërkoni informim në fund të një interviste.
- Ushtrojeni kërkimin e përgjigjeve për tri pyetje interviste tuaja e përkrahjeve nga intervistat.

HAPI 2: TREGOJINI GRUPIT (10 minuta)

Secili nga ju raporton se si shkoi me zotimet e veta duke treguar synimet e numrat realë dhe duke e deklaruar “të kuqe”, “të verdhë” ose “të gjelbër” përpjekjen e vet. Tregoni çfarë shkoi mirë dhe se si ju ndihmoi Ati Qiellor.

HAPI 3: ZGJIDHNI PARTNERË NË VEPRIM (2 minuta)

Zgjidhni një partner në veprim nga grupi për javën që vjen. Përgjithësisht, partnerët në veprim janë të së njëjtës gjini dhe nuk janë pjesëtarë të një familjeje.

Përdorni tani disa minuta për t’u takuar me partnerin tuaj në veprim. Prezantohuni vetë dhe diskutoni se si do të viheni në kontakt me njëri-tjetrin gjatë gjithë javës.

Emri i partnerit në veprim

Informacion kontakti

Shkruani se si dhe kur do të viheni në kontakt me njëri-tjetrin këtë javë.

DIE	HËN	MAR	MËR	ENJ	PRE	SHT


Plotësoni veprimtarinë në faqen pasuese.

VEPRIMTARI (5-8 minuta)

Le ta ushtrojmë deklaratën tonë Unë në 30 Sekonda.

Hapi 1: Ndahuni në grupe me të paktën tre veta, por jo më shumë se gjashtë.

Hapi 2: Secili person ngrihet dhe tregon deklaratën e vet Unë në 30 Sekonda duke ndjekur këta hapa:



Hapi 3: Jepini shpejt njëri-tjetrit përshtypje:

- A e treguan se çfarë vendi pune po kërkonin?
 - A e treguan se përse janë të mirë për të?
 - A kërkuan ndihmë? Në ç'mënyrë?
 - A ishte afër te 30 sekonda?
-



THEMELI IM – Koha Maximale: 20 Minuta


Nëse ky është kapitulli juaj i parë i javës, plotësoni parimin pasues të *Themeli Im* që gjendet në fund të këtij libri. Pastaj kthehuni te faqja 152.





MËSONI – Koha Maksimale: 45 Minuta

**SHTEGU DREJT NJË
VENDI PUNE MË TË MIRË**



Lexoni: Një kërkim i suksesshëm për vend pune ndjek këtë formulë të thjeshtë:

Veproni me Besim + Punoni Fort + Punoni me Mençuri = Sukses

Nëse do të mund ta shkurtonit kohën që ju desh për të gjetur një vend pune me 90 për qind, a do të ishit të interesuar? Ju mundeni. Në këtë kapitull do të ftoheni ta ndiqni këtë formulë në një mënyrë që do ta përshpejtojë së tepërmi kërkimin tuaj për vend pune.




Kërkimi i Xhoshit për Vend Pune

Lexoni: Xhoshi u intervistua për pozicionin te kompania ABC Marketing. Mendoi se doli mirë dhe ishte i gëzuar që ishte ushtruar. Ai duhej të dëgjonte prej tyre gjatë kësaj jave. Është i emocionuar rreth asaj mundësie, por nuk dëshiron t'i varë të gjitha shpresat atje. Ai mund të mos e marrë atë vend pune. Ai ka nevojë të marrë sa më shumë orientime të mira për vend pune që të mund të gjejë shpejt një vend pune, por si?

Diskutoni: Në çfarë mënyrash mund të jeni të ngjashëm me Xhoshin?

Lexoni: Në shumë mënyra, kërkimi juaj për vend pune ngjan shumë me këtë hinkë. Kërkohen shumë përpjekje që të bësh gjërat bazë të gjetjes së burimeve dhe të bësh kontakte deri në fund të hinkës te orientimet për vend pune, intervistat dhe ofertat për vend pune. Sa më shumë burime dhe kontakte që bëni duke punuar fort, aq më shumë intervista dhe oferta për vend pune do të merrni. Sidoqoftë, të punuarit fort nuk mjafton. Është e rëndësishme gjithashtu të punoni me mençuri që sa më shumë nga kontaktet e burimet tuaja të kthehen në orientime, intervista dhe oferta për vend pune.



1. PUNONI FORT: 15-10-2

Lexoni: Ka një strategji kërkimi për vend pune të provuar që quhet 15-10-2, e cila shpesh e ka shkurtuar kohën që u duhet njerëzve për të gjetur punë nga 200 ditë në 20 ditë! Ajo përfshin një plan bazë për përpjekjet tuaja të përditshme në kërkim të vendit të punës.

- Gjeni 15 burime të reja çdo ditë.
- Bëni 10 kontakte çdo ditë.
- Bëjini ballë për ballë dy nga ato kontakte.

Kujtoni, **burim** është një burim informacioni apo kontaktesh që do të ndihmojë në një kërkim të suksesshëm për vend pune. Ai mund të jetë një person, vend, apo send.

Një **kontakt** është çfarëdo komunikim punësimi me një burim. Ky mund të jetë një takim me dikë ballë për ballë, bërja e një telefonate, dërgimi i një postimi elektronik, dorëzimi i një aplikimi ose jetëshkrimi, ose dërgimi i një shënimi për ndjekje ecurie. Sa më personale që mund t'i bëni kontaktet tuaja, aq më shpejt do të merrni vend pune, gjë që është arsyeja përse doni të bëni të paktën dy kontakte ballë për ballë çdo ditë.

Metoda 15-10-2 do të shkurtojë së tepërmi kohën e kërkimit të punës. 15-10-2 mund të mos jetë e mundur për cilindo, prandaj përshtateni me rrethanat tuaja. Për disa, një metodë 10-8-2 ose edhe 7-7-2 mund të jetë ajo që ua lejon koha e tyre. Çështja është të bëni sa më shumë punë që mundeni në kërkimin tuaj për vend pune. Sa më shumë burime dhe kontakte që futni në hinkën tuaj, aq më shumë orientime, intervista dhe oferta për vend pune do të merrni.

Përsiatni: Si do të ishte të gjeje vend pune shpejt? Sa fort doni të punoni për të gjetur një vend pune?

2. PUNONI ME MENÇURI

Lexoni: Ndërsa është thelbësore, vetëm të punuarit fort nuk do ta përshpejtonte kërkimin tuaj për vend pune. Ju duhet të punoni gjithashtu me mençuri.

Punëkërkuesit e efektshëm punojnë fort duke ndjekur mundësi të shumëfishta për vend pune njëkohësisht. Ata punojnë me mençuri duke gjetur e duke u vënë në kontakt drejtpërdrejt me njerëzit që mund t'i ndihmojnë për t'i marrë ato vende pune. Ata punojnë me mençuri edhe duke përshtatur mjetet e tyre të kërkimit për vend pune, të tilla si deklaratat Unë në 30 Sekonda dhe jetëshkrimet, për çdo vend pune.

Kujtoni, ju merrni nga kërkimi për vend pune atë që futni në të.

VEPRIMTARI (7 minuta)

Le të shohim një shembull se si Xhoshi ndoqi një rast të mundshëm duke punuar fort dhe me mençuri.

Hapi 1: Ka një tabelë në faqen pasuese. Ndërsa shikoni materialin filmik, mbani shënim sa më shumë që mundeni nga burimet, kontaktet dhe kontaktet ballë për ballë të Xhoshit.

Hapi 2: Shikoni "Josh Works Smart" ["Xhoshi Punon me Mençuri"] në dispozicion te srs.ids.org/videos. (Nuk keni material filmik? Lexoni faqen 162.)



Diskutoni: Tregoni planin tuaj se si do të punoni me mençuri.

Lexoni: Të punuarit me mençuri është më i efektshëm sesa thjesht të punuarit fort. Mbajeni në mendje se edhe kur punohet me mençuri, ndonjëherë gjërat nuk japin rezultat. Herë-herë, ju nuk do të keni rezultate. Vijoni të punoni fort e me mençuri dhe kini besim. Zoti e di se çfarë po ju ndodh dhe do t'ju bekojë.

Diskutoni: Çfarë mund të bëni për të vazhduar të punoni fort dhe me mençuri, edhe kur kërkimi për vend pune është i vështirë?

PËRFUNDIMI

Shikoni: “Rafael: Job in 6 Days!” [“Rafaeli: Vend Pune brenda 6 Ditësh!”], në dispozicion te srs.ids.org/videos. (Nuk keni material filmik? Lexoni faqen 165.)



Diskutoni: Cilat ishin gjërat më të rëndësishme që mësuat nga ky kapitull?

Lexoni: Një kërkim i suksesshëm për vend pune ndjek këtë formulë të thjeshtë:

Veproni me Besim + Punoni Fort + Punoni me Mençuri = Sukses

Nëse doni ta shkurtoni kohën që ju duhet për të gjetur vend pune, punoni fort dhe me mençuri. Zoti ka thënë: “Njerëzit duhet të përfshihen me zell në një kauzë të mirë dhe të bëjnë shumë gjëra me vullnetin e tyre të lirë. . . . Sepse është në ta fuqia, me anë të së cilës ata janë veprues për veten.” Dhe ky urdhërim vjen me një premtim: “Për aq sa njerëzit të bëjnë mirë, ata në asnjë mënyrë s’do ta humbasin shpërbli-min e tyre” (DeB 58:27–28). Mbusheni hinkën tuaj me sa më shumë burime dhe kontakte të efektshme që mundni, dhe do të jeni të bekuar.



PËRSIATNI – Koha Maksimale: 5 Minuta

Individualisht mendoni rreth asaj që keni mësuar sot, dhe merrni parasysh se çfarë do të donte Zoti të bënit. Lexoni shkrimin e shenjtë ose citimin më poshtë dhe shkruani përgjigje për pyetjet.

“Qëllimi im është të jap vetëbesim se ne, duke bërë gjëra të vogla, mund të presim rezultate të mëdha për shkak të përgatitjeve që Zoti ka bërë për të përmirësuar rezultatet e punës sonë” (Henry B. Eyring, “The Lord Will Multiply the Harvest”, *Teaching Seminary Preservice Readings Religion 370, 471 dhe 475* [2004], f. 94).
Cilat janë gjërat më domethënëse që mësova sot?

Çfarë do të bëj si rezultat i asaj që mësova sot?



ZOTOHUNI – Koha Maksimale: 10 Minuta

**Nëse ky është kapitulli juaj i fundit për këtë javë, plotësoni pjesën “Zotohuni”.
Ndryshe, kaloni te faqja 172.**

Lexojani çdo zotim me zë të lartë partnerit tuaj në veprim. Premtoni se do t'i mbani zotimet tuaja dhe më pas nënshkruani më poshtë. Shënoni synimet tuaja në tabelën te faqet ii-iii.

ZOTIMET E MIA

Ⓐ Do të përcaktoj së paku pesë burime çdo ditë. *Përzgjidhni synimin tuaj.*

Ditë/Javë	Ditë/Javë	Ditë/Javë	Ditë/Javë
5/25	10/50	15/75	20/100

Ⓑ Do të bëj të paktën tre kontakte çdo ditë. *Përzgjidhni objektivin tuaj.*

Ditë/Javë	Ditë/Javë	Ditë/Javë	Ditë/Javë
3/15	5/25	7/35	10/50

Ⓒ Do të vihem në kontakt dhe do të mbështes partnerin tim në veprim.

Ⓓ Do ta ushtroj dhe tregoj parimin e sotëm nga Themeli Im.

Ⓔ Do të bëj dy prej ushtrimeve nga lista e Aftësive në faqen iii.

Nënshkrimi im

Nënshkrimi i partnerit në veprim



BURIMET

XHOSHI PUNON ME MENÇURI

E hënë

Mbrëmë, një mik i tregoi Xhoshit për Computer Central, një kompani e përqendruar në shërbime kompjuterash. Tingëllon premtuese, prandaj Xhoshi vendos ta shohë.

Faqja e internetit e kompanisë rendit dy vende pune – Teknik Kompjuteri 1 dhe Përfaqësues Shërbimi Klientësh 2. Të dyja duken mjaft të përshtatshme. Xhoshi e përshtat jetëshkrimin e tij për secilin pozicion dhe bën kërkesa për të dyja.

Shumica e punëkërkesve do të ishin ndalur atje dhe do të prisnin që të binte telefoni. Por Xhoshi e di se do të ketë mundësi më të mirë për t'u marrë në punë po të mund të bisedonte me menaxherët që marrin në punë.

Duke iu kthyer faqes së internetit, Xhoshi kërkon listën telefonike për këdo që mund të ndikojë te vendimi për marrje në punë. Më në fund ai gjen tre emra.

Duke e ditur se referencat janë më të efektshme se bisedat e ftohta telefonike, Xhoshi takohet me dy nga mësuesit e tij pas klasës për të parë nëse njohin ndonjë që punon për kompaninë. Ata i rekomandojnë Elisa Pejtënin, sekretare pikërisht te departamenti i marrjes në punë për të dy pozicionet.

Xhoshi mëson pak më shumë rreth Elisës nga mësuesi i tij, por, për të qenë i përgatitur, ai sheh gjithashtu profilin e saj profesional në mjetet shoqërore të komunikimit. Atëherë ai i telefonon asaj, i thotë pohimin e tij Unë në 30 Sekonda dhe e pyet se me cilin duhet të bisedojë mbi 2 pozicionet për të cilat bëri kërkesë. Elisa e rekomandon te menaxheri i vërtetë i marrjes në punë – Uilliam Stivensoni – një nga tre personat që ai pati gjetur më herët.

Xhoshi e kalon pjesën tjetër të ditës së vet duke ndjekur mundësi të tjera për vend pune.

Vazhdon në faqen tjetër.

E martë

Xhoshi fillon përpjekjet e tij për vend pune duke parë profilin profesional të Uilliam Stivensonit. Më pas i telefonon atij, i thotë pohimin e tij Unë në 30 Sekonda dhe verifikon se aplikimi i tij është marrë. Pasi mëson më shumë rreth pozicionit, Xhoshi kërkon t'i dërgojë sërish një jetëshkrim të përditësuar drejtpërsëdrejti Uilliamit. Xhoshi gjithashtu mëson nga Uilliami se Sara Xhonsoni është menaxhere e marrjes në punë për pozicionin tjetër.

Xhoshi përsërit të njëjtin proces me Sarën. Duke ditur se ka pozicione ndoshta të papublikuara, Xhoshi pyet rreth nevojash të tjera të kompanisë. Sara e informon Xhoshin rreth dy pozicioneve të tjera.

Pas telefonatës, Xhoshi i përditëson të dy variantet e jetëshkrimit të tij dhe i dërgon ato tek Uilliami dhe Sara. Ai gjithashtu shkruan dhe dërgon shënime falënderimi për Elisën, Uilliamin dhe Sarën.

Xhoshi e kalon pjesën tjetër të ditës duke ndjekur mundësi të tjera për vend pune.

KOMPANIA COMPUTER CENTRAL

Burimet	Kontaktet	Ballë për Ballë
III III III III	III III III	II

Kthehuni te faqja 156.

BURIME (Njerëz, vende ose gjëra)	KONTAKTET (Komunikim punësimi)	KONTAKTET BALLË PËR BALLË
<ul style="list-style-type: none"> ◦ Miku i Xhoshit ◦ Computer Central ◦ Faqja e kompanisë në internet ◦ Teknik Kompjuterash 1 ◦ Përfaqësues i Shërbimit për Klientët 2 ◦ Lista telefonike e kompanisë ◦ Emri i listës telefonike 1 ◦ Emri i listës telefonike 2 ◦ Emri i listës telefonike 3 ◦ Mësuesi 1 ◦ Mësuesi 2 ◦ Elisa Pejtëni ◦ Profili i Elisës ◦ Uilliam Stivensoni ◦ Profili i Uilliamit ◦ Sara Xhonsoni ◦ Profili i Sarës ◦ Vend pune i papublikuar 1 ◦ Vend pune i papublikuar 2 	<ul style="list-style-type: none"> ◦ Bisedoi me mikun e Xhoshit ◦ Dorëzoi jetëshkrimin për Teknik Kompjuterash 1 ◦ Dorëzoi jetëshkrimin për Përfaqësues të Shërbimit për Klientët 2 ◦ Takoi mësuesin 1 ◦ Takoi mësuesin 2 ◦ I telefonoi Elisa Pejtënit ◦ I telefonoi Uilliam Stivensoni ◦ I telefonoi Sara Xhonsonit ◦ I dërgoi jetëshkrim të përditësuar Uilliamit ◦ I dërgoi jetëshkrim të përditësuar Sarës ◦ I dërgoi shënim falënderimi Elisës ◦ I dërgoi shënim falënderimi Uilliamit ◦ I dërgoi shënim falënderimi Sarës 	<ul style="list-style-type: none"> ◦ Takoi mësuesin 1 ◦ Takoi mësuesin 2
Gjithsej: 19	Gjithsej: 13	Gjithsej: 2

RAFAELI: VEND PUNE BREND A 6 DITËSH!

Le të lexojmë se si e përshpejtoi Rafaeli kërkimin e tij për vend pune me një plan të përditshëm burimesh, kontaktesh dhe takimesh ballë për ballë.

“Unë isha i papunë për shtatë muaj. Pastaj dëgjova rreth programit të ri që Kisha pati filluar. Kisha nevojë vërtet për punë që të bëhesha i mbështetur te vetja, kështu që shkova me besim. Kur dëgjova rreth qasjes 15-10-2, isha nervoz. Dukej aq shumë punë. Mendova rreth saj dhe u luta që Ati Qiellor të më ndihmonte. Vendosa të bëja më të mirën time dhe ta provoja.

Ditën tjetër fillova me burime si interneti ose gazeta. Pas kësaj bëra kontakte. Fola me miq të mi kolegë; fola me disa miq nga kisha dhe pastaj me disa kontakte që punonin në biznese. Brenda asaj jave të shkurtër, munda të gjej 75 burime, të bëj 50 kontakte dhe të kem gjashtë intervista. Mësova pohimin tim Unë në 30 Sekonda dhe e përdora në çdo kontakt që bëra. Unë mësova rreth pohimeve të fuqisë dhe i përdora në kontaktet dhe intervistat e mia. Munda të gjej një vend pune brenda vetëm gjashtë ditësh!

Ishte vërtet një mrekulli. Kjo përvojë e ndërtoi besimin tim tek Ati Qiellor. Dëshmia ime u forcua. Unë e di se Ai nuk më braktisi kurrë në asnjë çast kur zbatova atë që kisha mësuar. E ndjeva këtë në çdo kontakt që bëra. E ndjeva te njerëzit me të cilët fola. Unë e di se Ati Qiellor ishte përkrah meje. Kjo e lumturoi aq shumë familjen time. Bashkëshortja ime ishte shumë e lumtur. Në të njëjtën kohë, ajo ndien paqe sepse jemi të mbështetur te vetja. Unë tani mund të siguroj për shtëpinë tonë dhe fëmijët tanë.”

Kthehuni te faqja 159.



10

KINI SUKSES NË PUNË

PARIMET, AFTËSITË DHE SHPREHITË E KËRKIMIT PËR VEND PUNE

1. Jini një Punonjës i Shkëlqyer
2. Krijoni Synime Punësimi



RAPORTONI – Koha Maksimale: 25 Minuta

Nëse ky është kapitulli juaj i parë i kësaj jave, plotësoni pjesën “Raportoni”. Ndryshe, kaloni te faqja 172.

ZOTIMET E JAVËS SË SHKUAR

- Ⓐ Të përcaktoj burime çdo ditë.
- Ⓑ Të bëj kontakte çdo ditë.
- Ⓒ Të vihem në kontakt dhe të mbështes partnerin tim në veprim.
- Ⓓ Ta ushtroj dhe tregoj parimin e sotëm nga Themeli Im.
- Ⓔ Të ushtroj aftësi për kërkimin e një vendi pune.

HAPI 1: VLERËSONI VETVETEN (5 minuta)

Përdoreni tabelën “Vlerësimi i Përppjekjeve të Mia” në faqet ii-iii për të rishikuar zotimet tuaja të mbledhjes së fundit. Së pari, shkruani numrin e vërtetë të burimeve që gjetët dhe kontaktet që bëtë. Pastaj vlerësojeni individualisht përppjekjen tuaj për ta mbajtur secilin zotim duke i shenjuar me të kuqe, të verdhë apo të gjelbër.

VLERËSIMI I PËRPPJEKJEVE TË MIA										AFTËSITË		
Data	Ⓐ I Përcaktoj Burimet Çdo Ditë		Ⓑ Krijoj Kontakte Çdo Ditë		Ⓒ Vihem në Kontakt dhe e Përkrah Partnerin Tim në Veprim	Ⓓ E ushtroj Parimin Themel (m dhe ua Tregoj të Tjerëve	Ⓔ I Ushtroj Aftësitë për Kërkimin e një Vendi Pune (Zgjidhni dy nga lista e Aftësive)	LEGJENDA: ● Përppjekje Mëmirëse ● Përppjekje Mësimtare ● Përppjekje Mëkufizuese ● Përppjekje të Bërditshme				
	Symlimi Javor	Realiza	Symlimi Javor	Realiza				Aftësia 1	Përppjekja	Aftësia 2	Përppjekja	
Shëmbulli	25	21	25	27	●●●●	●●●●	●●●●	●●●●	●●●●	●●●●	●●●●	●●●●
Java 1												
Java 2												
Java 3												
Java 4												
Java 5												
Java 6												
Java 7												
Java 8												
Java 9												
Java 10												
Java 11												
Java 12												

PËRSHENI ZOTIN (KAP. 1)
 ● Luatni për ndihmë të posaçme për kërkimin tuaj për vend pune.
 ● Agjëroni për ndihmë të posaçme për kërkimin tuaj për vend pune.

LINE NË 30 SEKONDA (KAP. 2)
 ● Ushtrojeni pesë herë deklaratën tuaj "Line në 30 Sekonda" dhe merri përfitime.
 ● Përdoroni deklaratën tuaj "Line në 30 Sekonda" për përkrahje të ndihmës.

INTERVISTA INFORMIMI (SHITËJA)
 ● Shkruani pesë pyetje për të marrë informata.
 ● Shikojnë 201.

PËRKOHINI AFTËSITË (KAP. 3)
 ● Shqyrtoni pesë parimet për vend pune dhe përkrahje aftësi tuaja me mësuesit e punëdhënës.

POHIME FUGUE (KAP. 4)
 ● Shkruani 10 pohime të ndihmës tuaj.
 ● Thirrni të qatën në pohime tuaj dhe pyetje dhe merri përfitime.

MATERIALI ME SHKRIM (KAP. 5)
 ● Shkruani 10 pohime të ndihmës tuaj.
 ● Shkruani një parafjalë dhe merri përfitime nga tre rrethet.
 ● Shkruani dy pohime tuaj për të filluar letrat parafjalë.
 ● Shkruani një letër parafjalë dhe merri përfitime nga tre rrethet.

INTERVISTA (KAP. 6-7)
 ● Ushtrojeni deklaratën tuaj "Line në 30 Sekonda" për dy intervista të mundshme.
 ● Ushtrojeni kërkimin e përgjigjeve në pyetje për intervistat dhe përkrahje tuaj.
 ● Luatni pesë pyetje që mund të bëni në fund të një interviste.
 ● Përdoroni tri mënyra të sëmundit të pyetjes më të mëdha të tërësive tuaja të fundit të një interviste.
 ● Ushtrojeni kërkimin e përgjigjeve për tri pyetje interviste dhe përkrahje tuaj nga intervistat.

HAPI 2: TREGOJINI GRUPIT (10 minuta)

Secili nga ju raporton se si shkoi me zotimet e veta duke treguar synimet e numrat realë dhe duke e deklaruar “të kuqe”, “të verdhë” ose “të gjelbër” përpjekjen e vet. Tregoni çfarë shkoi mirë dhe se si ju ndihmoi Ati Qiellor.

HAPI 3: ZGJIDHNI PARTNERË NË VEPRIM (2 minuta)

Zgjidhni një partner në veprim nga grupi për javën që vjen. Përgjithësisht, partnerët në veprim janë të së njëjtës gjini dhe nuk janë pjesëtarë të një familjeje.

Përdorni tani disa minuta për t’u takuar me partnerin tuaj në veprim. Prezantohuni vetë dhe diskutoni se si do të viheni në kontakt me njëri-tjetrin gjatë gjithë javës.

Emri i partnerit në veprim

Informacion kontakti

Shkruani se si dhe kur do të viheni në kontakt me njëri-tjetrin këtë javë.

DIE	HËN	MAR	MËR	ENJ	PRE	SHT


Plotësoni veprimtarinë në faqen pasuese.

VEPRIMTARI (5-8 minuta)

Le të ushtrojmë pohimet tona të fuqisë.

Hapi 1: Ndahuni në grupe me të paktën tre veta, por jo më shumë se gjashtë.

Hapi 2: Secili nga ju ngrihet dhe thotë një pohim fuqie duke ndjekur këto hapa:



Hapi 3: Jepini shpejt përshtypje njëri-tjetrit:

- Çfarë aftësie pretendonin ata?
 - Cili ishte shembulli i tyre?
 - Cili qe rezultati?
 - Si e përshtatën me nevojat e punëdhënësit?
 - A ju la mbresa?
-




THEMELI IM – Koha Maksimale: 20 Minuta

Nëse ky është kapitulli juaj i parë i javës, plotësoni parimin pasues të *Themeli Im* që gjendet në fund të këtij libri. Mandej kthehuni te faqja 172.





MËSONI – Koha Maksimale: 45 Minuta



Lexoni: Një kërkim i suksesshëm për vend pune ndjek këtë formulë të thjeshtë:

Veproni me Besim + Punoni Fort + Punoni me Mençuri = Sukses

Në këtë kapitull ju do të mësoni se si po këto parime zbatohen për të pasur sukses në punë dhe se si punësimi ndihmon në mbështetjen tuaj te vetja.



Kërkimi i Xhoshit për Vend Pune

Lexoni: Lajme të mira! Xhuli nga ABC Marketing i telefonoi Xhoshit dhe i ofroi pozicionin si Teknik në Zyrën e Ndhmës. Ai fillon këtë javë. Xhoshi dhe familja e tij janë gëzuar pa masë! Ky është hap i madh drejt mbështetjes te vetja, që Xhoshi e di se është më shumë sesa thjesht të kesh vend pune.

Diskutoni: Si lidhet punësimi me mbështetjen te vetja?

Lexoni: Shkrimi i shenjtë na mëson: “Pasi ju nuk keni arritur deri këtu përveçse me anë të fjalës së Krishtit, me besim të patundur në të, duke u mbështetur tërësisht në meritat e atij që është i fuqishëm të shpëtojë” (2 Nefi 31:19). Ne pamë se Xhoshi punonte fort, ushtronte besim dhe u bekua me një vend pune. Sidoqoftë, thjesht të jesh i punësuar nuk do të thotë vetvetiu se dikush është i mbështetur te vetja. Ju keni nevojë gjithashtu të jeni i mirë në vendin e punës dhe ndoshta të shihni për synime më të mira punësimi. Ati Qiellor mund t’ju ndihmojë për këtë synim.

Diskutoni: Si mund t’ju bekojë Ati Qiellor në punësimin tuaj?

1. JINI NJË PUNONJËS I SHKËLQYER

Lexoni: Të qenit punonjës i shkëlqyer do t'ju ndihmojë ta mbani vendin tuaj të punës, të rriteni në punë dhe të fitoni më shumë para. Kjo mund t'ju ndihmojë të bëheni më i mbështetur te vetja.

Nëse jeni në vendin tuaj të punës të parapëlqyer ose ende nuk jeni, kujtoni, ka gjithmonë vlerë e përvojë që fitohet prej çfarëdo vendi pune.

Punonjësit e shkëlqyer e shohin çdo vend pune si mundësi, edhe nëse do të parapëlqenin një vend pune më të mirë. Mos u përpiqni ta lini një vend pune derisa të keni një vend pune tjetër që ju pret. Për mundësi kërkohet punë dhe të jesh një punonjës i shkëlqyer do t'ju sjellë më shumë mundësi. Pothuajse e gjithë puna është fisnike.

Diskutoni: Përse duhet të jeni punonjës i shkëlqyer, pavarësisht nga vendi i punës?

Shikoni: "Keep it Simple" ["Thjeshtojeni Punën"], në dispozicion te srs.ids.org/ videos. (Nuk keni material filmik? Lexoni faqen 182.)



VEPRIMTARI (5 minuta)

Hapi 1: Mendoni rreth vendit të punës që keni ose vendit të punës që doni. Individu-
alisht shkruani tri gjëra konkrete që mund të bëni për të qenë punonjës i shkëlqyer
për atë vend pune.

1. _____

2. _____

3. _____

Hapi 2: Secili nga ju tregojini një prej ideve tuaja pjesës tjetër të grupit. Nëse dëgjoni
diçka që doni ta bëni, shkruajeni.

2. KRIJONI SYNIME PUNËSIMI

Lexoni: Që të bëheni i mbështetur te vetja, mund t'ju duhet të merrni parasysh një gamë më të gjerë synimesh punësimi.

Përsiatni: A do t'ju ndihmojë vendi juaj i tanishëm i punës (ose vendi i punës që po kërkonte) për t'u bërë i/e mbështetur te vetja?

VEPRIMTARI (8 minuta)

Lëvizeni karrigen tuaj për të folur me një person tjetër në grup.

Hapi 1: Përshkruani vendin e tanishëm të punës ose vendin e punës që po kërkonte.

Hapi 2: Përshkruani vendin e punës që dëshironi të keni brenda dy deri katër vjetësh. A është e njëjta punë apo diçka e ndryshme?

Hapi 3: Diskutoni se si do të ishte të kishit para të mjaftueshme për të udhëtuar për në tempull, për të shërbyer në misione apo për të ndihmuar të tjerët.

Hapi 4: Shkruajeni në këto kuti atë që keni diskutuar.

KU JENI TANI	KU DONI TË JENI

Lexoni: Tani që e keni një ide rreth vendit ku doni të shkoni, si do të shkoni atje? Për të përparuar në punën tuaj, ju mund të keni nevojë për aftësi apo arsimim shtesë. Ajo që keni mësuar rreth kërkimit për vend pune, do t'ju ndihmojë edhe për synimet tuaja të punësimit. Gjetja e burimeve dhe bërja e kontakteve do t'ju ndihmojë të kualifikoheni për pozicionet që mund të doni në të ardhmen.



Kërkimi i Xhoshit për Vend Pune

Lexoni: Xhoshi është i lumtur që ka një vend pune, por ai dëshiron të bëhet inxhinier rrjeti kompjuterash. Ajo punë do ta ndihmojë të fitojë më shumë dhe të jetë më i mbështetur te vetja. Për ta ndihmuar të shohë se çfarë ka nevojë të bëjë më pas, ai përdori këtë mjet.

POZICIONET QË DONI	AFTËSITË DHE DIJA QË JU NEVOJITEN	MËNYRAT PËR T'I FITUAR AFTËSITË DHE DIJEN	HAPA TË MËTEJSHËM
<ul style="list-style-type: none"> Inxhinier rrjeti kompjuterash 	<ul style="list-style-type: none"> Diplomë në shkencat kompjuterike Certifikata për rrjet kompjuterash Më shumë përvojë 	<ul style="list-style-type: none"> Mbaroni shkollën Kërkoni projekte të veçanta Flisni me inxhinierë të tjerë të rrjeteve kompjuterike 	<ul style="list-style-type: none"> Intervista informuese me disa inxhinierë rrjeti kompjuterash

VEPRIMTARI (8 minuta)

Mendoni rreth pozicionit që doni, ose si të përmirësoheni në rolin tuaj të tanishëm. Plotësojeni tabelën më poshtë. Mandej tregojani partnerit tuaj në veprim.

POZICIONET QË DONI	AFTËSITË DHE DIJA QË JU NEVOJITEN	MËNYRAT PËR T'I FITUAR AFTËSITË DHE DIJEN	HAPA TË MËTEJSHËM

Diskutoni: Si do të ndihmojnë këta hapa të mëtejshëm për një mbështetje më të madhe te vetja?

PËRFUNDIMI

Shikoni: “Growing” [“Rritja”], në dispozicion te srs.lds.org/videos. (Nuk keni material filmik? Lexoni faqen 183.)



Diskutoni: Cilat janë gjërat më të rëndësishme që mësuat nga ky kapitull?

Lexoni: Formula për kërkim të suksesshëm për vend pune është:

Veproni me Besim + Punoni Fort + Punoni me Mençuri = Sukses

Po të njëjtat parime zbatohen për të pasur sukses në punë. Perëndia ju do dhe dëshiron që të jeni të mbështetur te vetja. Tregojeni besimin tuaj duke u përpjekur të jeni punonjës i shkëlqyer e duke planifikuar për një vend pune që do t’ju ndihmojë të jeni i mbështetur te vetja. Ai do t’ju bekojë ndërsa punoni fort dhe veproni me besim.



PËRSIATNI – Koha Maksimale: 5 Minuta

Individualisht mendoni rreth asaj që keni mësuar sot, dhe merrni parasysh se çfarë do të donte Zoti të bënit. Lexoni shkrimin e shenjtë ose citimin më poshtë dhe shkruani përgjigje për pyetjet.

“Vini re, unë ju them se është vullneti im që ju duhet të shkoni dhe të mos qëndroni, as mos jini dembelë, por të punoni me fuqi. . . . Dhe kështu, nëse jeni besnikë, ju do të ngarkoheni me shumë duaj dhe do të kurorëzoheni me nder dhe lavdi, dhe pavdekësi, dhe jetë të përjetshme” (DeB 75:3, 5).

Cilat janë gjërat më domethënëse që mësova sot?

Çfarë do të bëj si rezultat i asaj që mësova sot?



ZOTOHUNI – Koha Maximale: 10 Minuta

Nëse ky është kapitulli juaj i fundit për këtë javë, plotësoni pjesën “Zotohuni”. Përndryshe, kaloni te faqja 189.

Lexojani çdo zotim me zë të lartë partnerit tuaj në veprim. Premtoni se do t'i mbani zotimet tuaja dhe më pas nënshkruani më poshtë. Shënoni synimet tuaja në tabelën te faqet ii-iii.

ZOTIMET E MIA

Ⓐ Do të përcaktoj së paku pesë burime çdo ditë. *Përzgjidhni synimin tuaj.*

Ditë/Javë	Ditë/Javë	Ditë/Javë	Ditë/Javë
5/25	10/50	15/75	20/100

Ⓑ Do të bëj të paktën tri kontakte çdo ditë. *Përzgjidhni synimin tuaj.*

Ditë/Javë	Ditë/Javë	Ditë/Javë	Ditë/Javë
3/15.	5/25	7/35	10/50

Ⓒ Do të vihem në kontakt dhe do të mbështes partnerin tim në veprim.

Ⓓ Do ta ushtroj dhe tregoj parimin e sotëm nga Themeli Im.

Ⓔ Do të bëj dy prej ushtrimeve nga lista e Aftësive në faqen iii.

Nënshkrimi im

Nënshkrimi i partnerit në veprim



BURIMET

THJESHTOJENI PUNËN

Le të dëgjojmë një punëdhënës që përshkruan disa pika kyç për të qenë një punonjës i shkëlqyer.

“Unë punësoj njerëz çdo vit dhe i vëzhgoj ata ose të rriten profesionalisht në vendin e punës ose ta lënë vendin e punës për një tjetër. Më lejoni t’ju tregoj gjërat bazë që presim nga punonjësit tanë. Së pari, ata duhet të jenë të besueshëm. Së dyti, ata duhet të jenë në gjendje të punojnë efektshëm me njëri-tjetrin. Dhe së treti, ne duam që ata të japin ndihmesë. Thjesht bërija e këtyre tri gjërave sjell një ndryshim të madh në suksesin e tyre me ne. Më lejoni të tregoj një përvojë si shembull.

Kohët e fundit, ne punësuam dy vetë që të punonin këtu. Pozicionet e tyre ishin njëlloj. Ata filluan afërsisht në të njëjtën kohë. E para ka qenë e shkëlqyer. Ajo nuk vjen kurrë me vonesë në punë, rrallë telefonon se është e sëmurë dhe është e zonja në punën e vet. Nuk ka nevojë që të tjerët të bëjnë punën e saj. Ajo përshtatet mirë dhe shkon mirë me të tjerët. Për më tepër, ajo gjithashtu bën një punë të shkëlqyer. Jo vetëm që e bën punën, por kërkon të bëjë më shumë. Ka qenë këtu prej disa muajsh dhe tashmë po shohim për ngritje të mundshme në përgjegjësi ose në pagesë.

Personi i dytë nuk po shkon mirë. Ai vjen shpesh vonë dhe gjithmonë ka një justifikim, nga një fëmijë i sëmurë deri tek i iku autobusi. Ai nuk duket se mund t’ia dalë dhe të tjerët duhet ta kryejnë punën e pabërë prej tij. Kam vënë re edhe se ai është shqetësues kur është këtu. Ai nuk duket se mund ta kalojë javën pa u futur në ndonjë lloj mosmarrëveshjeje. Punonjësit e mi kanë ardhur për t’u ankuar për gjëra që ai ka thënë apo bërë. Vërtet nuk dua të merrem me gjëra të tilla në punë. Unë dua vetëm që ai të mund të shkojë më mirë me të tjerët ose të sillet më mirë në punë. Së fundi, ai thjesht nuk është aq i mirë në punën e vet. Po plotëson minimumin e pritshmërive, por nuk do të thosha se po marrim ndonjë lloj përfitimi ngaqë e morëm në punë. Unë po planifikoj ta heq nga puna.

Mbajtja e një vendi pune është e thjeshtë. Jini të besueshëm, jini të lehtë për bashkëpunim dhe bëni punë të mirë. Nëse mund t’i bëni ato gjëra, ju ndoshta gjithmonë do të keni vend pune dhe më shumë mundësi kur keni nevojë për to.”

Kthehuni te faqja 175.

RRITJA NË PËRGJEGJËSI

Anxhela tregon çfarë po bën për t'u rritur në punë.

“Unë punova fort për të pasur vendin e punës që kam, dhe mendoj se kjo më bën ta vlerësoj atë. Është një vend pune i shkëlqyer që më pëlqen dhe që siguron për familjen time. Unë kam plane të ngrihem në përgjegjësi, por gjithashtu dua të bëj një punë të mirë pikërisht tani. Prandaj jam duke i përdorur aftësitë e mia për kërkim vendi pune që të rritem në përgjegjësi këtu në punë. Dijenia se ka gjithmonë më shumë për të mësuar, më motivon dhe plotësimi i punëve të mia të përditshme më mban në përparim drejt synimeve afatgjata. Çdo ditë dua të jem më e mirë.

Gjithnjë po kërkoj se si mund të bëj një punë më të mirë. Gjeta disa burime që vërtet kanë ndihmuar, përfshirë disa libra. Por njerëzit kanë qenë burimi im më i mirë. Disa nga kolegët e mi më me përvojë dhe menaxherë të tjerë kanë qenë shumë të gatshëm të më ndihmojnë. Gjithçka duhet të bëni, është të pyetni dhe shumica e njerëzve janë të gëzuar t'ju ndihmojnë të bëheni më mirë. Dhe kjo ju bën të doni t'i tejkalonit pritshmëritë e tyre.

Unë gjithashtu po vazhdoj të krijoj rrjetin. Shumë nga pozicionet që ka kompania ime, mbushen nëpërmjet ngritjeve në përgjegjësi. Unë kam vazhduar të bëj intervista informuese me njerëz të tjerë këtu për të mësuar më shumë rreth roleve të tyre dhe për të kërkuar këshillën e tyre. Kjo më ka ndihmuar të krijoj disa lidhje të shkëlqyera dhe të mësoj gjëra që përndryshe nuk do t'i kisha ditur. E di se ka një mundësi më të mirë që njerëzit do të mendojnë për mua kur të hapen vende pune, për dy arsye: e para, unë jam punonjëse e mirë, dhe e dyta, ata më njohin dhe më mirëbesojnë mua.

Gjithashtu e di se Ati Qiellor do që unë të kem sukses dhe të jem në gjendje të rritem profesionalisht. Ai më bekoi me këtë vend pune dhe unë e di se Ai mund të më ndihmojë ndërkohë që punoj dhe përpiqem të rritem.”

Kthehuni te faqja 179.



MPRIHINI AFTËSITË TUAJA

PARIMET, AFTËSITË DHE SHPREHITË E KËRKIMIT PËR VEND PUNE

1. Mprihimi Aftësitë Tuaja



RAPORTONI – Koha Maksimale: 25 Minuta

Ju do të përsëritni Mprihini Aftësitë Tuaja në pjesën e mbetur të mbledhjeve tuaja.

ZOTIMET E JAVËS SË SHKUAR

- Ⓐ Të gjej burime çdo ditë.
- Ⓑ Të bëj kontakte çdo ditë.
- Ⓒ Të vihem në kontakt dhe të mbështes partnerin tim në veprim.
- Ⓓ Ta ushtroj dhe tregoj parimin e sotëm nga Themeli Im.
- Ⓔ Të ushtroj aftësi për kërkimin e një vendi pune.

HAPI 1: VLERËSONI VETVETEN (5 minuta)

Përdoreni tabelën “Vlerësimi i Përpjekjeve të Mia” në faqet ii-iii për të rishikuar zotimet tuaja të mbledhjes së fundit. Së pari, shkruani numrin e vërtetë të burimeve që gjetët dhe kontaktet që bëtë. Pastaj vlerësojeni individualisht përpjekjen tuaj për ta mbajtur secilin zotim duke i shenjuar me të kuqe, të verdhë apo të gjelbër.

VLERËSIMI I PËRPJEKJEVE TË MIA										AFTËSITË	
Data	Ⓐ I Përcakttoj Burimet Çdo Ditë		Ⓑ Krijoj Kontakte Çdo Ditë		Ⓒ Vihem në Kontakt dhe e Përkrah Partnerin Tim në Veprim	Ⓓ E ushtroj Parimin Themel (m dhe ua Tregoj të Tjerëve	Ⓔ I Ushtroj Aftësitë për Kërkimin e një Vendi Pune (Zgjidhni dy nga lista e Aftësive.)	LEGJENDA:			
	Synimi Javor	Realizoj	Synimi Javor	Realizoj				Përpjekja E suksesshme	Përpjekja E pasuksesshme	Përpjekja e rëndësishme	
Shëmbull	25	21	25	27	●●●	●●●	E ushtroj parimin themel 30 sekonda	●●●	Aftësia 1	Aftësia 2	●●●
Java 1											
Java 2											
Java 3											
Java 4											
Java 5											
Java 6											
Java 7											
Java 8											
Java 9											
Java 10											
Java 11											
Java 12											

PËRSHËNI ZOTIN (KAP. 1)

- Leksi për ndërmarrje të pasqirave për kërkimin tuaj për vend pune.
- Agjencitë për ndërmarrje të pasqirave për kërkimin tuaj për vend pune.

LINE NË 25 SEKONDA (KAP. 2)

- Ushtrojeni pesë herë deklaratën tuaj "Unë në 30 Sekonda" dhe merri përfitimet.
- Përdoroni deklaratën tuaj "Unë në 30 Sekonda" për përkrahje të ndërmarrjes.

INTERVISTA INFORMIMI (SHITJA)

- Shikoni pesë pyetje për të marrë informim, Shihfaqjen 201.
- Ushtrojeni të paktën një pyetje për informim dhe merri përfitimet. Shihfaqjen 201.

PËRKOHINI AFTËSITË (KAP. 3)

- Shikoni pesë përkohime për vend pune dhe përkohjet afësisht tuaja me mjetet e punësimit.

POHIME FUNDI (KAP. 4)

- Shikoni 10 pohime të ndërmarrjes tuaj.
- Thirrni të paktën në paktën katër nga këto pohime dhe merri përfitimet.

MATERIALI ME SHIKIM (KAP. 5)

- Shikoni 10 pohime të ndërmarrjes tuaj.
- Shikoni një përkohim dhe merri përfitimet nga të rëndësishme.
- Shikoni dy pohime tuaja për të filluar letrat përkohim.
- Shikoni një listë paraqitja dhe merri përfitimet nga të rëndësishme.

INTERVISTA (KAP. 6-7)

- Ushtrojeni deklaratën tuaj "Unë në 30 Sekonda" për të marrë informim të mundshme.
- Ushtrojeni kërkimin e përgjigjeve në pyetje për intervistën dhe përkohjet tuaja.
- Ushtrojeni pesë pyetje që mund të bëhen në fund të një interviste.
- Përdoroni të njëjtën ose të shtuar të pyetjeve më të mira se të njëjtat që bëhen në fund të një interviste.
- Ushtrojeni kërkimin e përgjigjeve për të pyetje intervistuesit të përdoruesit të përkohjes tuaj.



THEMELI IM – Koha Maksimale: 20 Minuta


Nëse ky është kapitulli juaj i parë i javës, plotësoni parimin pasues te *Themeli Im* që gjendet në fund të këtij libri. Pastaj kthehuni te faqja 189.





MËSONI – Koha Maksimale: 45 Minuta

SHTEGU DREJT NJË VENDI PUNE MË TË MIRË



1. MPRIHINI AFTËSITË TUAJA

Lexoni: Formula për kërkim të suksesshëm për vend pune është:

Veproni me Besim + Punoni Fort + Punoni me Mençuri = Sukses

Përsiatni: Nëse nuk po keni aq sukses sa do të donit, cili/ët element/e i/të formulës duket se mungon nga kërkimi juaj për vend pune?

Nëse po punoni por nuk po keni sukses, shihni tek aftësitë tuaja për të kërkuar vend pune. Është e zakonshme për punëkërkuesit që të hasin vështirësi për disa aspekte të kërkimit të tyre për vend pune dhe kjo kërkon kohë që të zhvillohen aftësitë. Është me rëndësi të dalloni ku po hasni vështirësi dhe çfarë mund të bëni rreth saj.

VEPRIMTARI (10-15 minuta)

Për t'ju ndihmuar të kapërceni sfida të zakonshme të kërkimit për vend pune, secili nga ju zgjidhni një nga vështirësitë e zakonshme nga tabela e mëposhtme. Shpjegoja-ni grupit ose partnerit tuaj në veprim. Pastaj punoni së bashku për të ushtruar një ose më shumë nga aftësitë e sugjeruara. Ju gjithashtu mund të doni të rishikoni kapitullin përkatës ose të ushtroheni më shumë gjatë javës.

VËSHIRËSI TË ZAKONSHME	AFTËSI PËR TË USHTRUAR
1. Nuk di se çfarë vendi pune dua.	Kapitulli 1: Çështjet Bazë Përqendrohuni në një deri në tri vende pune (f. 7)
2. Nuk po gjej orientime për vende pune.	Kapitulli 2: Krijimi i Rrjetit Unë në 30 Sekonda (f. 29)
3. Unë po has vështirësi për krijimin e rrjetit.	Kapitulli 2: Krijimi i Rrjetit Unë në 30 Sekonda (f. 29)
4. Nuk po marr intervista për vende pune.	Kapitujt 2, 3, 4 Përputhni aftësitë (f. 48) Jetëshkrimet (f. 79) Letra paraqitëse (f. 85) Aplikime (f. 88)
5. Po marr intervista por jo oferta.	Kapitujt 3-8 Përputhni aftësitë (f. 48) Përdorni pohime fuqie (f. 63) Përgatituni përpara intervistës (f. 100) Fillojeni intervistën efektshëm (f. 101) Unë në 30 Sekonda (f. 101) Kthejini negativet në pozitive (f. 118) Bëni pyetje (f. 121)



ZOTOHUNI – Koha Maksimale: 10 Minuta

Lexojani çdo zotim me zë të lartë partnerit tuaj në veprim. Premtoni se do t'i mbani zotimet tuaja dhe më pas nënshkruani më poshtë. Shënoni synimet tuaja në tabelën te faqet ii–iii.

ZOTIMET E MIA

Ⓐ Do të përcaktoj së paku pesë burime çdo ditë. *Përzgjidhni synimin tuaj.*

Ditë/Javë	Ditë/Javë	Ditë/Javë	Ditë/Javë
5/25	10/50	15/75	20/100

Ⓑ Do të bëj të paktën tri kontakte çdo ditë. *Përzgjidhni synimin tuaj.*

Ditë/Javë	Ditë/Javë	Ditë/Javë	Ditë/Javë
3/15	5/25	7/35	10/50

Ⓒ Do të vihem në kontakt e do të mbështes partnerin tim në veprim.

Ⓓ Do ta ushtroj dhe tregoj parimin e sotëm nga Themeli Im.

Ⓔ Do të bëj dy prej ushtrimeve nga lista e Aftësive në faqen iii.

JAVA NR.	NËNSHKRIMI IM	NËNSHKRIMI I PARTNERIT NË VEPRIM



SHTOJCA

REGJISTRI PËR GJURMIMIN E KËRKIMIT PËR VEND PUNE

DITA 1

Burimet: Gjithsej në DitëKontaktet: Gjithsej në DitëMbledhjet: Gjithsej në Ditë

Shënime:

DITA 2

Burimet: Gjithsej në DitëKontaktet: Gjithsej në DitëMbledhjet: Gjithsej në Ditë

Shënime:

DITA 3

Burimet: Gjithsej në DitëKontaktet: Gjithsej në DitëMbledhjet: Gjithsej në Ditë

Shënime:

DITA 4

Burimet: Gjithsej në DitëKontaktet: Gjithsej në DitëMbledhjet: Gjithsej në Ditë

Shënime:

DITA 5

Burimet: Gjithsej në DitëKontaktet: Gjithsej në DitëMbledhjet: Gjithsej në Ditë

Shënime:

FORMULARI PËR NDJEKJEN E ECURISË ME KONTAKTIN

KONTAKTI

Personi ose organizata: _____

Telefoni: _____ Adresa: _____

Posta Elektronike: _____ Më rekomandoi: _____

U vura në kontakt me këtë

person Po Jo

Data: _____

ÇËSHTJET E DISKUTUARA:

1. _____

2. _____

3. _____

VEPRIMTARI PËR NDJEKJEN E ECURISË

1. _____

2. _____

3. _____

REKOMANDIME TË REJA

1. Emri: _____ Telefoni: _____ Faksi: _____

Posta Elektronike: _____ Adresa: _____

2. Emri: _____ Telefoni: _____ Faksi: _____

Posta Elektronike: _____ Adresa: _____

INTERVISTA DHE VLERËSIMI I TAKIMIT**Data:** _____

Bëni kopje të këtij formulari përpara se ta plotësoni. Përdoreni këtë formular për të vlerësuar intervistat dhe mbledhjet tuaja dhe ndiqni përparimin tuaj. Shtoni rekomandime të reja në listën tuaj të rrjetit.

Personi ose organizata: _____

Unë isha i përgatitur. Po Jo Komente: _____Unë i arrita synimet e mia. Po Jo Komente: _____Unë u prezantova mirë. Po Jo Komente: _____**ÇËSHTJET E DISKUTUARA:**

1. _____

2. _____

3. _____

ÇFARË SHKOI MIRË

ÇFARË KAM NEVOJË TË PËRMIRËSOJ

VEPRIMTARI PËR NDJEKJEN E ECURISË:

1. _____

2. _____

3. _____

REKOMANDIME TË REJA:

1. Emri: _____ Telefoni: _____ Faksi: _____

Posta Elektronike: _____ Adresa: _____

2. Emri: _____ Telefoni: _____ Faksi: _____

Posta Elektronike: _____ Adresa: _____

KRIJIMI I RRJETIT TË ZGJERUAR

Përcaktoni Vendimmarrësit

Lexoni: Përtej bisedimit me ata që njihni, ju duhet të viheni në kontakt gjithashtu me biznese. Kur viheni në kontakt me biznese, përpjekjet tuaja do të jenë më të efektshme nëse bisedoni me njerëz që marrin vendimet për punësime. Përdoreni internetin dhe faqet e mjeteve shoqërore profesionale të komunikimit për të përcaktuar se me kë duhet të flitni.

Për shembull, Xhoshi dëshiron të punojë në shërbime kompjuterash. Ai mund të shohë një kompani dhe të përpiqet të gjejë njerëz që menaxhojnë Sektorin e Teknologjisë së Informacionit. Ai mund të kontrollojë listën telefonike të kompanisë ose të bëjë kërkim për njerëz të kompanisë në një faqe interneti të mjeteve shoqërore. Më pas mund t'i telefonojë kompanisë dhe t'i kërkojë me emër këta njerëz. Kur përdorni emra, është befasuese sa shpesh do të lidheni drejtpërsëdrejti me njerëzit.

Çdo biznes dhe person që gjeni, është një burim. Secili ndërveprim punësimit që keni me një biznes ose person në një biznes, është një kontakt. Sa më shumë kontakte personale që bëni me biznese dhe njerëz në ato biznese, aq më shpejt do të gjeni një vend pune.

Përdorni Tekste të Shkruara

Lexoni: Shkrimi i teksteve mund të jetë një mënyrë e shkëlqyer për t'ju përgatitur për ndërveprime të efektshme. Kjo do t'ju ndihmojë të flitni me më shumë besim te vetja dhe të keni më shumë sukses. Për t'ju ndihmuar për këtë gjë, këtu janë disa modele tekstesh për tre skenarë bazë për t'u vënë në kontakt me njerëz apo biznese.

VËNIA NË KONTAKT ME DIKË QË E NJIHNI

Thoni: "Tungjatjeta, _____ (emri i kontaktit), unë jam _____ (emri juaj). A mund të flisni me mua për tre ose katër minuta?"

Shpjegoni shkurt përse po telefononi (mos u zgjatni më shumë se 15 sekonda).

Përdoreni pohimin tuaj Unë në 30 Sekonda.

Përdorni një pyetje mbyllëse për të kërkuar ndihmë (kujtohuni të përfshini kontakte, rekomandime dhe orientime).

Falënderojeni personin për kohën e tij apo të saj.

VËNIA NË KONTAKT ME DIKË QË JUA KANË REKOMANDUAR

Thoni: "Tungjatjeta, _____ (emri i kontaktit), quhem _____ (emri juaj) dhe _____ (emri i personit që jua rekomandoi) më sugjeroi t'ju telefonoj. A mund të flisni me mua për tre ose katër minuta?"
Shpjegoni shkurt përse po telefononi (mos u zgjatni më shumë se 15 sekonda).

Përdoreni pohimin tuaj Unë në 30 Sekonda.

Përdorni një pyetje mbyllëse për të kërkuar ndihmë (kujtohuni të përfshini kontakte, rekomandime dhe orientime).

Nëse personi me të cilin po bisedoni, përmend hapjen e një vendi pune të brendshëm, kërkon një intervistë. (Sigurohuni që të ofroni dy zgjedhje për një kohë takimi.)

Falënderojeni personin për kohën e tij apo të saj.

VËNIA NË KONTAKT ME DIKË QË NUK E NJIHNI (NJË BIZNES)

Pyetni për emrin e pronarit, menaxherit apo mbikëqyrësit.

Thoni: "Faleminderit. A mund të flas me _____ (emri mbikëqyrësit), ju lutem?"

Kur mbikëqyrësi përgjigjet, thoni: "Tungjatjeta, _____ (emri i mbikëqyrësit), qhem _____ (emri juaj). A mund të flisni me mua për tre ose katër minuta?"

Shpjegoni shkurt përse po telefononi (mos u zgjatni më shumë se 15 sekonda).

Përdoreni pohimin tuaj Unë në 30 Sekonda.

Përdorni një pyetje mbyllëse për të kërkuar ndihmë (kujtohuni të përfshini kontakte, orientues, intervistë informuese etj.).

Nëse personi me të cilin po bisedoni, përmend hapjen e një vendi pune të brendshëm, kërkon një intervistë. (Sigurohuni që të ofroni dy zgjedhje për një kohë takimi.)

Falënderojeni personin për kohën e tij apo të saj.

Intervista Informuese

Lexoni: Intervistat informuese janë një mjet tjetër i fuqishëm i krijimit të rrjetit. Në intervistat informuese ju takoheni me njerëz për të marrë këshillë mbi punën tuaj, për të mësuar më shumë rreth tyre apo punës së tyre dhe për të krijuar një lidhje të shkëlqyer. Ato ngjajnë shumë me intervistat për vend pune, por ka më pak presion për të dyja palët ngaqë nuk ka domosdoshmërisht një vend pune në mes. Sidoqoftë, nëse dilni mirë, është sikur sapo keni pasur një intervistë të shkëlqyer shqyrtuese dhe mund t'ju rekomandojnë te më shumë njerëz e mundësi. Këto intervista janë një mënyrë e shkëlqyer për të ndërtuar marrëdhënie rrjeti.

Majkëlli tregoi përvojën e mëposhtme se si intervistat informuese e çuan drejt një suksesi të pabesueshëm në kërkimin për vend pune dhe karrierë.

“Kur po kërkoja punë, mësova se shumica e vendeve zihen pa u publikuar. Unë e dija se duhej të kishte diku një mundësi për mua. Nëse mund të bëja kontaktet e duhura, isha i sigurt se mund të bëja përshtypje të mirë. Disa nga kontaktet që kisha, më rekomantuan te njerëz që e dinin se punonin në sektorin që më interesonte. Unë iu drejtova atyre me telefon, postë elektronike ose personalisht. U shpjegova interesimin tim për sektorin apo kompaninë dhe i pyeta nëse mund t'u merrja 15 minuta kohë. Ata thujse të gjithë pranuan!

Shpejt mësova se duhej të isha i përgatitur për këto biseda dhe të kisha gati disa pyetje. Mësova gjithashtu se këto bashkëbisedime ishin një proces këqyrjeje, shumë i ngjashëm me një intervistë të parë. Njerëzit po më matnin, duke parë nëse mund të isha një përshtatje e mirë për kompaninë e tyre. Nëse do të pëlqehesha, ne do të bisedonim përsëri ose do të më referonin te kontakte shtesë. Fillova ta kuptoj se intervistat informuese më dhanë fuqinë të krijoja mundësi këqyrjeje pa pritur për një intervistë formale për vend pune. Intervistat e mia informuese filluan të kthehen në intervista të vërteta për punësim, duke qenë të gjitha për vende pune që nuk ishin publikuar. Kjo kulmoi kur në një javë mora katër oferta për vende pune! Që nga ajo kohë, çdo ngritje në përgjegjësi që më është dhënë, apo çdo vend pune që kam marrë, ka qenë nëpërmjet krijimit të rrjetit dhe intervistave informuese.”

VEPRIMTARI

Shkruani emrat e tre personave apo kompanive me të cilat doni të viheni në kontakt për të caktuar një intervistë informuese.

1. _____

2. _____

3. _____

INTERVISTA INFORMUESE: SUGJERIME PËR SUKSES

Lexoni: Kujtohuni, kur e filloni një intervistë informuese, personi që po takoni, po ju bën një favor. Këtu janë disa sugjerime për t'ju ndihmuar që të përdorni sa më mirë kohën e personit dhe të keni një përvojë të shkëlqyer. Bëjeni me radhë, duke lexuar secili nga një sugjerim me zë të lartë ndërsa kaloni përreth grupit.

- Përdorni një tekst të shkruar (shihni faqet 198–200) për të kërkuar për një intervistë informuese.
- Informohuni paraprakisht rreth sektorit ose kompanisë së personit.
- Përgatitni që më parë pyetje të përshtatshme.
- Po të nevojitet, bëni kontakte të shumëfishta për të kërkuar të intervistoheni.
- Mos kërkoni më shumë se 15 deri 30 minuta nga koha e një personi.
- Mos shkoni përtej kohës së rënë dakord.
- Përgatituni t'u përgjigjeni pyetjeve vijuese:
 - A mund të na tregoni diçka rreth vetes?
(Përdorni pohimin tuaj Unë në 30 Sekonda.)
 - Përse jeni i interesuar për këtë punë?
- Ndërsa zhvillohet bashkëbisedimi, mund të jetë e volitshme të kërkoni për kontakte apo orientime të tjera.
- Vijoni menjëherë me një falënderim.
- Ndiqeni deri në fund çfarëdo zotimi që bëtë.

MATERIALET ME SHKRIM

Shembuj të Arritjeve në Jetëshkrime

- Grumbullova mbi 10 000 dollarë për pesë vjet nëpërmjet planifikimit të veprimtarive, komunikimit dhe rekrutimit të vullnetarëve. (Nëna)
- Arritanotën mesatare 9 në shkollën e mesme ndërsa punoja dhe luaja në shumë sporte duke planifikuar e duke u dhënë përparësi veprimtarive dhe detyrave. (Studenti/ja)
- Kurseva mbi 200 000 dollarë vitin e parë me administrimin aktiv të buxhetit dhe kontrollet e përmirësuara të kostove. (Menaxheri i Biznesit)
- Arrita një vlerësim 99 për qind të cilësisë në mijëra saldime komplekse me metale të pazakonta, krahasuar me mesataren e cilësisë së kompanisë prej 92 për qind. (Saldatori)

Këshilla për Jetëshkrimin

1. **Shkruani sipas nevojave të punëdhënësit.** Shumë punëdhënës shpenzojnë më pak se 10 sekonda duke i hedhur një sy jetëshkrimit tuaj, prandaj duhet ta bëni të lehtë për ta që të shohin si u përshtateni.
2. **Mbusheni lart dhe majtas jetëshkrimin tuaj.** Kur punëdhënësit i hedhin një sy jetëshkrimit tuaj, ata shohin së pari pjesët e sipërme dhe majtas, ndaj vendoseni atje informacionin tuaj më të rëndësishëm.
3. **Përdorni ndarje me pika, jo paragrafë.** Bëjeni të lehtë për punëdhënësit që ta gjejnë informacionin tuaj.
4. **Përdorni formatim që është i lehtë të ndiqet.** Organizojeni jetëshkrimin tuaj në një model shkallë-shkallë, me të njëjtat lloje të informacion të lidhura, që punëdhënësit të mund ta gjejnë e kuptojnë natyrshëm përmbajtjen tuaj.
5. **Mos përdorni shabllone jetëshkrimi.** Programet kompjuterike që përdorin punëdhënësit për të skanuar jetëshkrimet, që quhen sisteme ndjekjeje të kërkuesve (SNK), nuk mund t'i lexojnë shabllonet dhe shabllonet normalisht nuk duken aq mirë sa jetëshkrimet që i bëni tërësisht vetë.
6. **Mos përdorni synime.** Ato janë të vjetruara dhe mund të përjash-toheni pasi keni dështuar të jeni i kohës.
7. **Përfshini një përmbledhje të qendërzuar te nevojat e punëdhënësit.** Përdorni një të katërtën deri një të tretën e sipërme të faqes për të shkruar një përmbledhje të thjeshtë që përfshin një titull, një përmbledhje dhe fjalët kyç.
8. **Përdorini fjalët kyç nga përshkrimi i vendit të punës.** Fjalët kyç kapin interesin e punëdhënësit dhe sistemet SNK janë programuar që t'i kërkojnë.

9. **Përshkruajini arritjet tuaja duke përdorur variantin e jetëshkrimit të pohimeve të fuqisë.** Këto pohime fuqie duhet të përfshijnë hollësi me numra, përqindje, shuma në dollarë e kështu me radhë.
10. **Jepni kontekst.** Duke dhënë një krahasim apo histori të vogël të një situatë, ju veçoni veten nga të tjerët si ju.
11. **Përfshini gjithë përvojën tuaj arsimore, edhe nëse është ende në vijim.** Sigurohuni të shënoni se është në vijim ose se ka një datë diplomimi të pritshme.
12. **Mbajeni jetëshkrimin tuaj të sistemuar.** Përdorni tituj të rregullt pjesësh, formatim të rregullt dhe hapësira të mira bosh.
13. **Sigurohuni të mos ketë gabime shkrimi apo gramatikore.** Këto gabime do t'ju përjashtojnë shpejt.
14. **Përdorni forma shkronjash tradicionale.** Qëndroni te formate tradicionale "serif" ose "sans serif".
15. **Mos shkoni nën madhësinë 11 pikë të shkronjave.** Ju doni që jetëshkrimi juaj të jetë sa më i lehtë që të jetë e mundur për punëdhënësin që ta lexojë.
16. **Mbajeni jetëshkrimin tuaj në një faqe.** Qëndroni te një faqe derisa të keni të paktën shtatë vite përvojë përkatëse profesionale.
17. **Përdorni të njëjtin titull për të gjitha dokumentet tuaja të karrierës.** Një titull është pjesë e jetëshkrimit tuaj që normalisht përmban emrin dhe informacionin tuaj të kontaktit.
18. **Mos përfshini referenca në jetëshkrimin tuaj.** Punëdhënësit e marrin me mend se keni referenca dhe nëse do t'i duan, do t'ju kërkojnë.
19. **Kthejeni jetëshkrimin tuaj në format PDF.** Nëse e dërgoni me postë elektronike ose e dërgoni elektronikisht jetëshkrimin tuaj, kthejeni në dokument PDF. Nëse nuk e bëni këtë, keni rrezikun që programi kompjuterik i punëdhënësit të mos përputhet me tuajin. Kjo mund të çojë te ndryshimi i formatimit dhe që punëdhënësi të mos jetë në gjendje ta lexojë jetëshkrimin tuaj.
20. **Kërkoni ndihmë për kompjuterin.** Gjeni miq, burime familjare, komunitare ose mjete në internet që t'ju ndihmojnë të krijoni dokumente që duken shkëlqyeshëm.

Këshilla për Letrat Paraqitëse

1. **Shkruajeni posaçërisht për biznesin, organizatën apo rastin e vendit të punës së mundshme.**
2. **Përdorni pohime fuqie për ta tërhequr interesin e lexuesit dhe për t'ju veçuar.** Në letrat tuaja paraqitëse, përdorni stil të thjeshtë dhe të drejtpërdrejtë shkrimi.
3. **Shkruani shkurt.** Zakonisht letra paraqitëse nuk duhet të jetë më shumë se tre paragrafë të thjeshtë e kurrë më shumë se gjysmë faqe.
4. **Kërkoni një intervistë.**
5. **Përdorni të njëjtin titull në të gjitha dokumentet tuaja të karrierës.** Një titull është pjesa e jetëshkrimit tuaj që normalisht përmban emrin dhe informacionin tuaj të kontaktit.

Këshilla për Aplikimin

1. Shkruajeni për vendin e punës.
2. Përdorni arritje për të përshkruar përvojën tuaj të punës.
3. Plotësojeni informacionin tërësisht dhe saktësisht.
4. Sigurohuni të mos ketë gabime shkrimi apo gramatikore.
5. Gjeni fjalët kyç dhe përdorini te aplikimi juaj.

Jetëshkrimi Kronologjik

Një jetëshkrim kronologjik rendit përvojën tuaj të punës në rend kronologjik duke filluar nga pozicioni juaj më i fundit.

Ky format së pari ju lejon të tregoni gjithë historinë tuaj të punës, por mund të mos tregojë efektshëm se si i përshtateni më mirë pozicionit për të cilin po kërkoni.

STEPHEN ALBERT CLARK

123 Nowhere Street
Anywhere, IN

Celulari: 123-456-7891
stephen.clark@email.com

MEKANIK AUTOMJETESH

Me përvojë në identifikimin dhe zgjidhjen e shpejtë të problemeve të ndërlikuara për riparimin e automjeteve, veçanërisht në problemet me sisteme elektrike.

Njohuria dhe Aftësitë Bazë

- Komunikimi
- Shërbimi ndaj klientit
- Diagnostikimet
- Riparim i përgjithshëm
- Inspektimet
- Inventari
- Parandalimi i problemeve të mirëmbajtjes
- Zgjidhja e problemeve
- Heqja e gomave dhe zëvendësimi i tyre

ARSIMI

Certifikatë në Teknologjinë Automotive, Shkolla Teknologjike "Graden" 2009–2012

- Funksionimi i motorit
- Karburanti dhe sistemet e nxjerrjes së gazrave
- Sistemet elektrike
- Diagnostikimet
- Ndërrimi i marsheve
- Elektronikë e përparuar
- Sistemet e frenave
- Sistemi i drejtimit dhe balestrat
- Drejtim i oficinës së shërbimit

Diplomë e Shkollës së mesme, Anywhere High

- Komunikimet
- Bazat e të shkruarit
- Prodhimi i materialeve filmike
- Formim i përgjithshëm në financë
- Gjermanisht 1 vit
- Gjermanisht 2 vjet

PËRVOJA E PUNËS

Udhëheqës Ekipi për Ankesat e Klientëve, Qendra Telefonike The Falls 2014–Present

Përfaqësues për Shërbimin ndaj Klientit, Qendra Telefonike The Falls 2014

Drejtova ekipin përgjegjës për kërkesat e klientëve, duke u shërbyer mbi 5000 klientëve në tre rajone. Përdora analiza, të dëgjuarin me vëmendje, problemet me sistemin dhe ndreqjen e problemeve për të zgjidhur shpejt ankesat e klientëve.

- Mora çmimin "Përfaqësuesi i Muajit" për tre muaj rresht si rrjedhojë e rendimentit të lartë për korrektësinë, nivelin energjik, zgjidhjen e problemeve me sistemin, kohëzgjatjen e telefonatave dhe kënaqësinë e klientit.
- U ngrita në detyrën e udhëheqësit të ekipit për ankesat e klientit, duke drejtuar një ekip prej 15 përfaqësuesish dhe duke kryer shërbime në tre rajone.

Mekanik Automjetesh, Value Tires 2013

Kreva riparime dhe mirëmbajtje automjetesh në përputhje me marrëveshjen dhe standardet e fabrikës.

- I ula shpenzimet e ditës së punës me 3% duke përditësuar dhe thjeshtuar listat e detyrave për mirëmbajtjen që përdoren për t'u siguruar nëse e gjithë puna është kryer.
- E zvogëlova diagnostikimin e frenave me 8 minuta nëpërmjet paraqitjes së një procesi të ri diagnostikues.
- E rrita shitjen e gomave me 12% duke siguruar ndërrimin e gomave dhe pritjen për riparimin e gomave të shpuara me kronometrimin më të shkurtër nga të gjitha oficinat e shërbimit në zonë.
- Kreva 10% më shumë prova për sigurinë dhe nxjerrjen e gazrave sesa konkurrentët vendas për shkak të shërbimit të shpejtë dhe çmimeve konkurruese.
- Riparova mosfunksionimin e motorit dhe keqfunksionimin e sistemeve elektrike nëpërmjet saktësisë në analizë, diagnostikim dhe riparim.

Stazhi për Mekanik Automjetesh, Value Tires 2012

Përgjegjës për mirëmbajtjen e inventarit të dyqanit, blerjen e pjesëve të këmbimit, përgjigjen ndaj telefonatave për shërbimin ndaj klientit dhe kryerjen e mirëmbajtjes parandaluese të pajisjeve.

- Rrita saktësinë tek të dhënat e inventarit duke kryer kontrolle financiare javore.
- Zvogëlova kohën që duhej për gjetjen e pjesëve të automjeteve në inventar me 10 minuta duke standardizuar emërtimet, duke rritur saktësinë e të dhënave dhe duke riorganizuar vendet e ruajtjes për gjetjen e shpejtë të artikujve më të kërkuar në inventar.
- Rrita me 3% pikët për kënaqësinë e klientit, nëpërmjet dëgjimit të vëmendshëm, vendosjes së të dhënave të sakta dhe vlerësimit në mënyrë korrekte të nevojave të klientit dhe për riparimet e automjetit.

Përfaqësues për Shërbimin ndaj Klientit, Qendra Telefonike The Falls 2009–2012

Zgjidha mbi 100 kërkesa, ankesa dhe porosi ditore të klientëve.

Punova për një sërë restorantesh dhe pika të vogla shitjesh nga viti 1994 deri në vitin 2009.

Jetëshkrimi Funkcional

Një jetëshkrim funksional rendit aftësitë dhe përvojat tuaja që kanë lidhje [me vendin e punës]. Ky format ju lejon të theksoni se si i përshtateni më mirë pozicionit për të cilin po kërkon.

<h1>SUMMER HILLS</h1>		123456 Sunshine Dr. Anywhere, CA, 12345 123.456.7891 summerhills@email.com
<h2>Mësuese në Shkollë Fillore</h2>		
PËRMBLEDHJE	<p>Më shumë se 10 vjet përvojë në punën me fëmijët e shkollës fillore për të zhvilluar vlera kulturore, zakone pozitive të karakterit dhe njohuri të përgjithshme në fusha të caktuara sipas standardeve. E kam përdorur teknologjinë e programeve të reja kompjuterike për të zhvilluar programe mësimore për çdo student dhe përbushjen e planeve mësimore.</p> <p>Aftësi të Përgjithshme</p> <ul style="list-style-type: none"> Zhvillimi i karakterit Zhvillimi i programit mësimor Planifikimi i mësimi Futja e teknologjisë Vlerësimi Të dëgjuarit me vëmendje Mendimi kritik Mbikëqyrja Të kuptuarit e leximit Drejtimi i klasës Bisedime për marrëveshje Zgjidhja e problemeve Administrimi i kohës Spanjisht Shkrimi 	
ARSIMI	<p>Certifikatë e mësuesit 1987</p> <p>Diplomë Universitare e Profilizuar për Shkollën Fillore, Universiteti i Ajouas, Ajoua-Siti, AS 1982–1987</p> <p>Kurse Përkatese</p> <ul style="list-style-type: none"> Bazat e Arsimit Psikologji Për Arsimin Teknologji për Arsimin Programi Mësimor dhe Metodat Zbatimi i Teknologjisë në Klasë Mësimdhënia ndaj Nxënësve <p>Diploma e Shkollës së Mesme, Jackson High, Jackson, IA 1975–1979</p>	
PËRVOJA PROFESIONALE	<p>Zhvillimi i Programit Mësimor</p> <ul style="list-style-type: none"> Rrita notat e nxënësve për leximin duke krijuar 3D Read [Leximin 3D], një program i ri mësimor për leximin hartuar për ta bërë leximin një përvojë argëtuese, ndërvepruese, me mjete të shumta komunikimi dhe arti. Nxita zakone pozitive të karakterit nëpërmjet vendosjes së standardeve që në fillim dhe drejtimin të efektshëm të klasës. I përmirësova notat e nxënësve që kanë vështirësi duke i çuar në një nivel note, nëpërmjet zhvillimit bashkëpunues të veprimtarive të reja që përfshijnë strategji të ndryshme mësimore. <p>Futja e Teknologjisë</p> <ul style="list-style-type: none"> Rrita notën e nxënësve me 20% duke krijuar dhe zhvilluar programe të të mësuarit të përshtatura për çdo student duke përdorur programin Të Mësojmë sipas Mënyrës Sime. E shtova përfshirjen e nxënësve dhe ruajtjen e njohurisë tek ata, nëpërmjet mësimi për përdorimin e faqeve të internetit, materialeve filmike, lojërave mësimore në internet dhe programeve kompjuterike. E rrita zotimin e nxënësve ndaj standardeve të larta duke u dhënë mundësi për të bashkëpunuar, ndërvepruar dhe për të treguar në grupet private të mediave shoqërore. <p>Komunikimi</p> <ul style="list-style-type: none"> E rrita efektshmërinë e programit mësimor duke krijuar Kapitujt e Mësuesit, një forum në internet ku më shumë se 50 arsimtarë zhvillojnë në mënyrë bashkëvepruese veprimtari, plane mësimore dhe vlerësime që përqendrohen te standardet bazë. Ndërtova marrëdhënie pozitive dhe mirëbesimi me nxënësit nëpërmjet mbajtjes së kanaleve të hapura të komunikimit dhe duke respektuar privatësinë e nxënësve atje ku lejohet nga ligji. 	
HISTORIA E PUNËSIMIT	<p>Shtëpiake, Shtëpitë Hills, Anywhere, CA 1993–Deri Tani</p> <p>Mësuese, Shkolla Fillore Allen, Somewhere, IA 1988–1990</p> <p>Mësuese Praktikante, Shkolla Fillore Allen, Somewhere, IA 1987</p> <p>Mësuese Private, Jackson High, Jackson, IA 1977–1979</p>	
PËRVOJA E PUNËS VULLNETARE	<p>Presidente, Shoqata e Ndihmës, Anywhere, CA 2011–2014</p> <p>Misionare, Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, Where, NY 1990–1992</p>	

Jetëshkrimi i Kombinuar

Një jetëshkrimi i kombinuar rendit aftësitë, përvojat dhe historinë tuaj të punës. Ky format ju lejon të theksoni se si i përshtateni më mirë vendit të punës për të cilin po kërkon, ndërsa jep gjithashtu një histori kronologjike të punës.

23 North Main Street
Nowhere, FL 12345

JASON HERNANDEZ, MAB

123.456.7892
jasonmh@email.com

PËRGJEGJËSI I TRAJNIMEVE

Më shumë se 10 vjet përvojë në administrimin e shërbimeve njerëzore.

Historia e përmirësimit të organizatave për zgjidhjen e problemeve ndërsa ndërtojmë marrëdhënie.

Tregova efektshmëri duke krijuar dhe forcuar marrëdhëniet në punë me udhëheqësit, punonjësit e Kishës dhe me burimet në komunitet. Ekspertizë në administrimin dhe mbikëqyrjen e stafit, udhëheqjen dhe administrimin e buxheteve shumë milionë dollarëshe.

NJOHURITË BAZË DHE FUSHAT E ZOTËSIVE

- Zhvillimi i burimeve
- Trajnim dhe ndërmjetësim
- Këshillim për karrierë
- Administrim projekti
- Zhvillimi i punës
- Këshillim për financat
- Administrimi i buxhetit
- Fjalimi në publik
- Analizë e të dhënave
- Ngritja e ekipit
- Zgjidhja e problemit
- Marrëdhëniet me publikun

PËRVOJA PROFESIONALE

SHËRBIMET E BURIMEVE TË PUNËSIMIT

2014–DERI TANI

Ndihmëspërgjegjës

Administrova një nga zyrat më të mëdha në Amerikën Veriore, duke shërbyer në një zonë të dendur në popullsi, në 3 qarqe me mbi 500000 banorë. Administrova stafin me mbi 40 misionarë me shërbim në Kishë; u këshillova me udhëheqës priftërie; zhvillova punësimin, vetëpunësimin dhe burimet për arsimin dhe dhashë trajnim çdo vit për më tepër se 5000 klientë.

- **Përmirësova mbështetjen te vetja për mbi 2000 njerëz brenda 20 muajve nëpërmjet punësimit.**
- **Ndërtova marrëdhënie mirëbesimi me qindra anëtarë të Kishës** nëpërmjet komunikimit duke u përqendruar te njerëz të veçantë, duke ndjekur ecurinë dhe duke bërë trajnime tremujore.
- **Rrita listën për vendet e lira të punëve me 30%** nëpërmjet qasjes së efektshme ndaj punëdhënësve dhe rrjetit në internet.
- **Arrita të gjej 20% më shumë vende pune** sesa zyrat e tjera në organizatë.
- **U përzgjodha në programe të rëndësishme pilot** për shkak të famës për cilësi të shkëlqyera, profesionalizëm, besueshmëri.

SHTETI I MONTANËS, SEKTORI I SHËRBIMEVE PËR FUQINË PUNËTORE 2010–2014

Drejtor Rajonal

2012–2014

Përgjegjës

2010–2012

Unë u zgjodha në këtë pozicion nga shefi i zyrës për t'u bërë udhëheqësi i një zone që nuk kishte drejtues të vazhdueshëm për më shumë se dy vjet. Drejtova sektorët në të gjitha aspektet e 10 qarqeve rajonale me më shumë se 30 punëtorë dhe mbi 100000 klientë. E administrova buxhetin vjetor me 2,5 milionë dollarë dhe mora pjesë në ekipin drejtues ekzekutiv prej 6 personash.

- **Rindërtova sërish marrëdhëniet problematike të mëparshme midis grupeve të jashtme të interesit** duke marrë një rol aktiv për nevojat e fuqisë punëtoare në komunitet.
- **E shpëtova fondin e një ndihme financiare prej 600000 dollarësh për Sektorin e Arsimit** nëpërmjet bashkëpunimit, krijimit të rrjeteve dhe bisedimeve.

Faqja 2 në faqen pasuese.

23 North Main Street
Nowhere, FL 12345

JASON HERNANDEZ, MAB

123.456.7892
jasonmh@email.com

- **Krijova dhe zhvillova Billings Works**, një këshill për zhvillimin e fuqisë punëtore në komunitet, për të zgjidhur nevojat e fuqisë punëtore rajonale duke përfshirë grupet kryesore të interesit.
- **U përzgjodha nga kolegët që t'u jepja trajnim mbi zgjidhjen e konfliktit për temën Bashkëbisedimet e Vështira** më shumë se 500 punonjësve dhe grupeve kryesore të interesit, përmes më shumë se 20 seancave brenda 2 vjetëve.

RURAL DYNAMICS, INC./CCCS OF MONTANA

2005–2010

Drejtor i Këshillimit

U dhashë këshillim dhe mësim çdo vit më shumë se 10000 klientëve mbi kreditë bankare, borxhet, falimentimin, parandalimin e përvetësimit të pronës dhe rimarrjen e një forme kredie për hipotekën. Administrova 25 punëtorë në 9 zyra të degës kudo në Montana dhe Uajoming. Përgjegjës për një buxhet të rrjedhshëm prej 1,6 milion dollarësh.

- **Iu përgjigja nevojave të tregut duke zgjeruar programet këshilluese të kompanisë** për të përfshirë 4 zona të tjera të shërbimeve këshilluese vetjake financiare.
- **Ringrita të ardhurat e kompanisë** për herë të parë në 8 vjet, duke i rritur fitimet me 25% në kohën kur biznese të ngjashme po mbylleshin apo po bliheshin nga kompani të tjera.
- **Mbikëqyra aplikimin e suksesshëm të organizatës** për t'u bërë një agjenci këshillimi për strehimin sipas standardit shtetëror, duke arritur miliona dollarë në financimin shtesë.
- **Drejtova turneun e të folurit në publik me Prokurorin e Përgjithshëm të Shtetit të Montanës** për të krijuar mbështetje për një referendum, për të zhdukur marrjen abuzive të tokës ndaj huamarrësve.

ARRITJET

VITAL SMARTS

2010

Certifikuar me Nivelin e Artë Elitar si Trajnues në degën Bashkëbisedimet e Vështira

ORGANIZATA KOMBËTARE E SKAUTISTËVE SHQIPONJË
Skautist Shqiponjë

2000

ARSIMI

UNIVERSITETI I MONTANËS
Master në Administrim Biznes (MAB)

2005–2009

UNIVERSITETI "BRIGAM JANG" – AJDAHO
Diplomë Universitare për Shkenca në Menaxhim Biznes

2000–2004

Model Letre Paraqitëse 1

STEPHEN ALBERT CLARK

123 Nowhere Street
Anywhere, IN

Celulari: 123-456-7891
stephen.clark@email.com

1 gusht 2016

David King
Përgjegjësi i Distriktit
Your Neighborhood Tires
987 Nowhere Street
Anywhere, IN

I nderuar z. King,

Një nga pikat e mia të forta si mekanik automjetesh është diagnostikimi i saktë i çdo lloj problemi të makinës. Për shembull, në një rast, një klient solli një makinë Honda Civic Hybrid 2002. Ndër shtatë shokët e mi të skuadrës, unë isha i vetmi me njohuritë që nevojiteshin për ta identifikuar saktësisht problemin. Si rrjedhojë, ne ishim në gjendje t'i mbanim lidhjet e punës me klientin dhe të krijojmë një marrëdhënie besueshmërie me të. Që nga ajo kohë, klienti ua ka rekomanduar oficinën tonë tre prej shokëve të tij. Unë mund t'ju ndihmoj që të përmirësoni besueshmërinë dhe kënaqësinë e klientit nëpërmjet identifikimit të saktë të problemeve.

Ndërkohë që përvoja ime për riparimet është e kufizuar, unë jam përkushtuar që t'i bëj gjërat siç duhen. Jam i gatshëm dhe i aftë të mësoj çfarëdo që do të më nevojitet të di. Kur punoja për Value Tires, isha në gjendje të:

- Ulja kostot e ditës së punës me 3 %.
- Minimizoja kohën e diagnostikimit me 8 minuta.
- Rritja shitjet me 12 përqind.
- Rritja kënaqësinë e klientit me 3 përqind.

Do të më pëlqente shumë të kisha mundësinë të diskutoja mbi mënyrën se si mund t'i bëja këto gjëra edhe për ju. Do të lidhem me ju brenda kësaj jave.

Sinqerisht,



Stephen Clark

Model Letre Paraqitëse 2

SUMMER HILLS

Mësuese në Shkollë Fillore

123456 Sunshine Dr.
Anywhere, CA, 12345
123.456.7891
summerhills@email.com

1 gusht 2016

Derek Garcia
Mbikëqyrës
Dodger School District
123 Dodger Street
Anywhere, CA 12345

I nderuar z. Garsia,

Një nga pikat e mia të forta si mësuese është të krijoj një program të posaçëm mësuesor që i ndihmon nxënësit të mësojnë. Për shembull, disa nga nxënësit e mi të mëparshëm kishin vështirësi në lexim. Për t'i ndihmuar, përdora programin kompjuterik Learn My Way [Mëso sipas Mënyrës Sime], për të krijuar dhe përdorur programe leximi të përshtatura, në mënyrë që çdo nxënës të mund ta fillonte aty ku kishin mbetur dhe të zhvilloheshin që nga ajo pikë. Unë zhvillova gjithashtu një program të ri mësuesor leximi të quajtur Leximi në 3D që ndërthuri përvojat e mjeteve të shumta të komunikimit dhe artit me leximin. Si rrjedhojë, notat për leximin e nxënësve arritën thuajse në një nivel të lartë, por më e rëndësishmja ishte se nxënësit e mi filluan ta pëlqenin leximin.

Për mua, të jesh mësuese do të thotë ta përmirësosh cilësinë e jetës së nxënësve. Do të thotë t'i nxitësh ata, t'i ndihmosh të kenë arritje të larta dhe ta zhvillojnë karakterin e tyre. Ja përse dëshiroj që të punoj në Shkollën Fillore "Doxher". Misionet tona janë të njëjta – t'i ndihmojmë fëmijët tanë që ata të jenë gjithçka që mund të jenë si në klasë edhe në komunitet.

Jam e lumtur të diskutoj se si aftësia ime për të krijuar një program mësuesor të posaçëm mund të sjellë një ndryshim të qëndrueshëm për nxënësit tanë. Pres me padurim të bëj një intervistë me ju në kohën më të afërt që e shihni të përshtatshme. Faleminderit shumë për këtë mundësi!

Sinqerisht,

Summer Hills

Summer Hills

Model Letre Paraqitëse 3

23 North Main Street
Nowhere, FL 12345

JASON HERNANDEZ, MAB

123.456.7892
jasonmh@email.com

1 gusht 2016

Judy Watson
Përfaqësuese e Burimeve Njerëzore
Training Made Easy
561 South Oceanside Drive
Nowhere, FL 12345

E nderuar znj. Uatson,

Përvojat e mia në administrimin e projekteve të trajnimit në një shkallë të gjerë më bëjnë kandidatin ideal për pozicionin e parë tuajin si Përgjegjës Projekti. Unë i administroj në mënyrë të efektshme projektet dhe ekipet. Për shembull, aktualisht po mbikëqyr një ekip që u bën trajnime pune 5 000 klientëve në vit. Si rrjedhojë e organizimit të punës dhe e bashkëpunimit të shpeshtë, ne përmirësuam mbështetjen te vetja të mbi 2000 njerëzve dhe arritëm 20 përqind më shumë vende pune sesa zyrat e tjera në organizatë. Unë e di se mund t'i zbatoj të njëjtat zotësi për ju.

Do ta vlerësoja mundësinë që të takohem me ju për të diskutuar se si kualifikimet dhe përvojat e mia do të sjellin përfitim për suksesin e organizatës suaj. Mund të viheni në kontakt me mua në numrin 123-456-7892.

Sinqerisht,

Jason Hernandez

Jason Hernandez

KTHIMI I NJË NEGATIVEJE NË POZITIVE

NEGATIVE E MUNDSHME	SHQETËSIMI REAL I PUNËDHËNËSIT MUND TË JETË
Më i kualifikuar nga sa kërkohet	Pritshmëri për pagë të lartë Do të lëvizë shpejt në një pozicion më të mirë
Boshllëqe në historinë e punësimit	Mund të mos jetë i besueshëm Nuk do të qëndrojë në punë
Pa përvojë të drejtpërdrejtë	Trajnimi mund të jetë i shtrenjtë dhe të kërkojë kohë të gjatë I paaftë për ta bërë punën
Punëtor më i ri në moshë	Mungesë pjekurie Mungesë përvojë
Punëtor më i moshuar	Aftësi e vjetruar Mund ta lërë pozicionin herët
Mungesë përvojë pune	Aftësi për të mësuar Të përshtaturit te një vend pune Etikë pune
Mungesë diplome apo vërtetimesh për aftësi	Njohuri të pamjaftueshme për ta bërë punën Mund t'i nevojitet trajnim
Shumë lloje vendi pune në një periudhë të shkurtër kohe	Mund ta lërë pozicionin herët Mungesë angazhimi
I pushuar ose i shkurtuar nga pozicioni i mëparshëm	Nuk shkon mirë me të tjerët Etikë pune e dobët
Ka qenë pa punë kohët e fundit	Aftësi të vjetruara Të përshtaturit te një vend pune Mund të ketë nevojë për trajnim
Historia kriminale	Jo i besueshëm

Vazhdoni te faqja pasuese.

Këtu janë disa pyetje model për intervistë, në të cilat do të dëshironit ta ktheni një negative në pozitive.

- Përse e latë pozicionin tuaj të fundit?
- Cili ishte dështimi juaj më i madh në punë dhe çfarë mësuat prej tij?
- Cila është dobësia juaj më e madhe?
- Më tregoni rreth një kohe kur nuk ratë dakord me bosin tuaj.
- Më tregoni për një kohë kur punuat me një klient ose bashkëpunëtor të vështirë.

BINI NË UJDI EFEKTSHËM

Ju duhet t'u përgjigjeni vetë disa pyetjeve përpara se të hyni në ujdin për punësim. Lista vijuese mund të jetë e dobishme.

- Cili është niveli më i ulët i pagës që mund ta pranoni?
- Sa paguan në përgjithësi sektori për aftësitë tuaja?
- Cilat përfitime janë të rëndësishme për ju?
 - Shërbim shëndetësor
 - Dalja në pension
 - Leja shëndetësore
 - Leja për pushime vjetore
 - Shpërblime
- Si ndiheni rreth udhëtimit vajtje-ardhje në punë?
- Si ndiheni rreth orarit të punës?

Parashikoni fusha që mund të paraqesin probleme dhe pastaj renditni disa variante për t'i zgjidhur ato çështje.

VEPRIMTARI

Në ushtrimin e mëposhtëm zgjidhni përgjigjen që ndieni se do të ishte më e përshtatshme në rënien në ujd. (Përgjigjet janë në faqen pasuese.)

1. Rënia në ujd mbi pritshmëritë monetare duhet të ndodhë:
 - a. Në fillim të një interviste për marrje në punë.
 - b. Pasi keni marrë një ofertë të sigurt.
2. Nëse duhet të diskutoni pritshmëri monetare:
 - a. Jepni një shifër të saktë.
 - b. Jepni një nivel midis dy shifrash.
3. Nëse organizata mendon se pritshmëritë tuaja monetare janë tepër të larta:
 - a. Ofroni pritshmëritë e të tjerëve në atë sektor për t'i dhënë vlerë pretendimit tuaj.
 - b. Tregoni atë që mendoni se do të jetë ndihmesa juaj për organizatën.
4. Në përgjigje të një oferte që nuk e pëlqeni:
 - a. Thoni: "Faleminderit" dhe pranojeni.
 - b. Thoni sërish ofertën, qëndroni i ulur qetësisht dhe numëroni në heshtje deri në 10.
5. Kur kërkimi i ujdisë po përfundon dhe oferta e fundit është e pamjaftueshme:
 - a. Kundërshtoni ofertën dhe largohuni.
 - b. Ofroni ta diskutoni rënien në ujd më vonë.
6. Nëse rënia në ujd mbaron me një ofertë për një rritje të ardhshme në pagë pas një periudhe të caktuar kohe:
 - a. Shtrëngoni duart mbi marrëveshjen dhe largohuni.
 - b. Kërkoni që oferta të jetë e shkruar në kontratë.


Përgjigjet e Duhura

1. b. Pasi keni marrë një ofertë të sigurt.
 2. b. Jepni një nivel midis dy shifrash.
 3. b. Tregoni atë që mendoni se do të jetë ndihmesa juaj për organizatën.
 4. b. Thoni sërish ofertën, qëndroni i ulur qetësisht dhe numëroni në heshtje deri në 10. (Personi me të cilin po bini në ujdë mund të bëjë një ofertë më të mirë për të prishur heshtjen.)
 5. b. Ofroni ta diskutoni rënien në ujdë më vonë.
 6. b. Kërkoni që oferta të jetë e shkruar në kontratë.
-



THEMELI IM

PËR MBËSHTETJEN TE VETJA



SI TË PËRDORET KY MANUAL

Manuali *Themeli Im* i ndihmon individët të mësojnë dhe të jetojnë parime doktrinale që çojnë drejt mbështetjes shpirtërore dhe materiale te vetja. Ai funksionon më mirë kur shqyrtohet në një grup të vogël me 8 deri në 12 veta ose si një familje. Çdo javë, një anëtar i ndryshëm i grupit ndjek radhën për të qenë ndërmjetësi. Ndërmjetësi nuk ia jep mësim grupit parimin. Përkundrazi, ai ose ajo ndjek materialin dhe i nxit të gjithë të marrin pjesë. Të gjitha materialet filmike mund të gjenden në internet te srs.lds.org/facilitator.

KUR T'I SHIHNI KËTO NXITJE, NDIQNI KËTO UDHËZIME						
Raportoni	Përsiatni	Shikoni	Diskutoni	Lexoni	Veprimtari	Zotohuni
Grupi flet për 3–4 minuta rreth përparimit të tij në mbajtjen e zotimeve.	Në mënyrë individuale përsiatni dhe shkruani në heshtje për rreth 2–3 minuta.	Grupi shikon një material filmik.	Shprehini mendimet si një grup për rreth 2–4 minuta.	Një person lexon me zë të lartë për të gjithë grupin.	Punoni individualisht ose së bashku për rreth 5 minuta.	Çdo person premtan të veprojë sipas këtyre gjërave gjatë javës.

GRUPET PËR MBËSHTETJEN TE VETJA

Grupet për mbështetjen te vetja mund t'ju ndihmojnë që t'i përmirësoni financat vetjake, punën, biznesin tuaj të vogël apo arsimin tuaj. Për t'ju bashkuar një grupi të mbështetjes te vetja, vihuni në kontakt me specialistin e kunjit tuaj për mbështetjen te vetja.

PËRMBAJTJA

1: Mbështetja te Vetja Është një Parim Shpëtimi	222
2: Ushtroni Besim te Jezu Krishti	224
3: Administrojini Paratë	226
4: Pendohuni dhe Jini i Bindur	230
5: Përdoreni Kohën me Mençuri	232
6: Punoni: Merrni Përgjegjësi dhe Këmbëngulni	234
7: Zgjidhni Problemet	236
8: Bëhuni Një, Shërbeni së Bashku	238
9: Komunikoni: Bëni Kërkesa dhe Dëgjoni	240
10: Tregoni Integritet Moral	242
11: Kërkoni të Mësoni: Zgjidhni se Ku po Shkoni dhe Si të Arrini Atje	244
12: Merrini Ordinancat e Tempullit	248
Letër Përfundimi	251



“Le të punojmë për atë që na nevojitet. Le të bëhemi të mbështetur te vetja dhe të pavarur. Shpëtimi nuk mund të sigurohet mbi bazën e asnjë parimi tjetër.”

THOMAS S. MONSON,
“Guiding Principles of Personal and Family Welfare”, *Ensign*, shtator 1986, f. 3; duke cituar Marion G. Romney-n, në Conference Report, tetor 1976, f. 167



1: MBËSHTETJA TE VETJA ËSHTË NJË PARIM SHPËTIMI

Përpara se të filloni, lexoni pjesën “Si të Përdoret Ky Manual” në anën e brendshme të kapakut të përparmë.

Përsiatni: Gjoni 10:10 (në të djathtë)

Diskutoni: Çfarë është një jetë me bollëk?

Shikoni: “He Polished My Toe” [“Më Lustrroi Gishtin e Këmbës”], në dispozicion te srs.lds.org/videos. (Nuk keni material filmik? Lexoni faqen 5.)

Diskutoni: A besoni se ka zgjidhje për problemet tuaja? Si mund të kualifikohemi që fuqia e Zotit të na ndihmojë?

Lexoni: Referenca nga *Manuali 2* dhe citimi nga Plaku Dallin H. Oaks (në të djathtë). Të jesh i mbështetur te vetja nuk do të thotë që ne mund të bëjmë apo arrijmë çdo gjë që na vjen në mendje. Përkundrazi, do të thotë të besojmë se nëpërmjet hirit apo fuqisë aftësuese të Jezu Krishtit dhe vetë përpjekjes sonë, ne jemi në gjendje t’i plotësojmë të gjitha nevojat shpirtërore e materiale të jetës që kërkojmë për veten tonë dhe familjet tona. Mbështetja te vetja është provë e mirëbesimit apo besimit tonë te fuqia e Perëndisë për të lëvizur male në jetën tonë dhe për të na dhënë forcë që të triumfojmë mbi sprovat dhe vuajtjet.

Diskutoni: Si ju ka ndihmuar hiri i Krishtit për t’i plotësuar nevojat shpirtërore dhe materiale të jetës?

VEPRIMTARI

Hapi 1: Zgjidhni një partner dhe lexojeni secilin nga parimet më poshtë.

Hapi 2: Diskutoni përse besimi te këto të vërteta mund t’ju ndihmojë të bëheni më të mbështetur te vetja.

PARIMET DOKTRINORE TË MBËSHTETJES TE VETJA

1. Mbështetja te vetja është një urdhërim.	“Kisha dhe anëtarët e saj urdhërohen nga Zoti që të jenë të mbështetur te vetja dhe të pavarur” (<i>Teachings of Presidents of the Church: Spencer W. Kimball</i> [2006], f. 116).
2. Perëndia mund dhe do të sigurojë një mënyrë që fëmijët e Tij të drejtë të bëhen të mbështetur te vetja.	“Dhe është qëllimi im për të siguruar për shenjtoret e mi, sepse gjithë gjërat janë të miat” (DeB 104:15).
3. Materialja dhe shpirtërorja janë një për Perëndinë.	“Si rrjedhim, me të vërtetë unë ju them se gjithë gjërat për mua janë shpirtërore” (DeB 29:34).

“Unë kam ardhur që të kenë jetë e ta kenë me bollëk.”

GJONI 10:10

“Mbështetja tek vetja është aftësia, zotimi dhe përpjekja për të siguruar nevojat shpirtërore dhe fizike të jetës për veten dhe familjen. Kur anëtarët bëhen të mbështetur tek vetja, ata janë gjithashtu më të aftë që të shërbejnë e të kujdesen për të tjerët.”

MANUALI 2: ADMINISTRIMI I KISHËS (2010), 6.1.1

“Çfarëdo që na bën të jemi të varur nga dikush tjetër për vendime apo burime që mund t’i siguronim vetë, na dobëson shpirtërisht dhe e vonon rritjen tonë drejt asaj që plani i ungjillit synon që ne të jemi.”

DALLIN H. OAKS,
“Repentance and Change”, *Ensign ose Liahona*, nëntor 2003, f. 40

Diskutoni: Lexojeni citimin nga Presidenti Marion G. Romney (në të djathtë). Si e dini nëse po bëheni më i mbështetur te vetja?

Zotohuni: Zotohuni që t'i bëni veprimet vijuese gjatë javës. Shenjojeni kutinë kur ta përmbushni secilin zotim.

- Lexojeni letrën nga Presidenca e Parë në faqen 3 dhe nënvizojini bekimet e premtuara. Çfarë duhet të bëni për t'i marrë ato? Shkruajini mendimet tuaja më poshtë.
-
-

- Tregojani familjes apo miqve tuaj atë që keni mësuar sot rreth mbështetjes te vetja.

MË LUSTROI GISHTIN E KËMBËS

Nëse nuk jeni në gjendje ta shihni materialin filmik, lexoni këtë tekst.



PLAKU ENRIKE R. FALABELA: Kur po rritesha, ne nuk kishim shumë të ardhura. Më kujtohet një ditë kur iu afrova babait tim dhe i thashë: "Baba, më nevojiten një palë këpucë të reja. Këto që kam thujse janë grisur tashmë." Ai ndaloi dhe vështrroi këpucët e mia dhe pa që vërtet ishin të grisura. Ai tha: "Mendoj se kjo është diçka që mund ta rregullojmë". Ai mori pak bojë të zezë dhe m'i lustroi këpucët, duke i bërë me shkëlqim dhe të bukura. Ai më tha: "Tani i ke në rregull, bir". U përgjigja: "Jo, ende jo. Prapë mund ta shohësh gishtin e madh që më del nga këpuca." Ai tha: "Epo, mund ta rregullojmë edhe

atë!" Ai mori edhe pak bojë dhe lustroi gishtin tim!

Atë ditë mësova se ka zgjidhje për çdo problem. Unë jam i bindur se ky parim i mbështetjes te vetja dhe kjo nismë është një mënyrë për ta përsheptuar punën e Zotit. Ajo është pjesë e punës për shpëtim. Të gjithë ne mund të bëhemi më të mirë nga sa jemi tani. Ju duhet ta largoni plogështinë. Shumë herë, ne bëhemi të vetëkënaqur dhe kjo e shkatërron përparimin tonë. Çdo ditë është një ditë që mund të përparoj nëse vendos të bëj diçka ndryshe për ta përmirësuar atë që e kam bërë dobët në të kaluarën. Nëse e bëni me besim, duke ushtruar besim e shpresë në Krishtin, që Ai do të jetë atje për t'ju ndihmuar, ju do ta gjeni mënyrën për të përparuar në gjëra materiale dhe shpirtërore. Kjo ndodh sepse Perëndia jeton dhe ju jeni biri apo bija e Tij.

Kthehuni te faqja 222.

"Pa mbështetje te vetja një njeri nuk mund t'i ushtrojë këto dëshira të brendshme për të shërbyer. Si mundemi të japim nëse nuk kemi asgjë? Ushqimi për të uriturit nuk mund të vijë nga raftet bosh. Paratë për të ndihmuar nevojtarët nuk mund të vijnë nga një portofol bosh. Përkrahja dhe mirëkuptimi nuk mund të vijnë nga dikush i etur emocionalisht. Mësimdhënia nuk mund të vijë nga një i pamësuar. Dhe më e rëndësishmja nga të gjitha, udhërrëfimi shpirtëror nuk mund të vijë nga ai që është i dobët shpirtërisht."

MARION G. ROMNEY,
"The Celestial Nature of Self-Reliance",
Ensign, nëntor 1982,
f. 93



2: USHTRONI BESIM TE JEZU KRISHTI

Raportoni: Tregojini shkurtimisht grupit mënyrën se si ishit më të mbështetur te vetja javën e kaluar.

Përsiatni: Si ndikon besimi im te Jezu Krishti në mbështetjen time te vetja?

Shikoni: “Exercise Faith in Jesus Christ” [“Ushtroni Besim te Jezu Krishti”], në dispozicion te srs.lds.org/videos. (Nuk keni material filmik? Lexoni faqen 7.)

Diskutoni: Përse besimi i vërtetë çon gjithnjë në veprim? Përse besimi është i nevojshëm që Perëndia të na ndihmojë materialisht dhe shpirtërisht?

Lexoni: Mateu 6:30 dhe citimi nga *Lectures on Faith* [Leksione mbi Besimin] (në të djathtë)

VEPRIMTARI

Shtegu i mbështetjes te vetja është një udhëtim besimi. Presidenca e Parë dhe Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve janë duke na ftuar që ta bëjmë rritjen e besimit tonë tek Ati Qiellor dhe Biri i Tij një përparësi në jetën tonë.

Hapi 1: Si grup, lexoni përparësitë profetike në kutinë më poshtë.

Hapi 2: Diskutoni se si nderimi me besnikëri i Shabatit, marrja e sakramentit dhe leximi i Librit të Mormonit do t’ju ndihmojnë të bëheni më të mbështetur te vetja.

PËRPARËSITË DHE PREMTIMET PROFETIKE

“Përfytyrojeni madhësitinë e asaj thënie! Plotësia e tokës u premtohet atyre që e mbajnë ditën e Shabatit të shenjtë” (Rasëll M. Nelson, “Shabati Është një Kënaqësi”, *Ensign* ose *Liahona*, maj 2015, f. 130; shih edhe DeB 59:16).

“Shpirtësia nuk është e amullt dhe as nuk janë të tilla besëlidhjet e [sakramentit]. Besëlidhjet nuk sjellin vetëm zotime, por ato sjellin fuqi shpirtërore” (Neil L. Andersen, mbledhje trajnimi me Autoritetet e Përgjithshme, prill 2015).

“Ju jap dëshmi se [Libri i Mormonit] mund të bëhet një ‘Urim dhe Thumim’ vetjak në jetën tuaj” (Richard G. Scott, “The Power of the Book of Mormon in My Life”, *Ensign*, tetor 1984, f. 11).

Zotohuni: Zotohuni që t’i bëni veprimet vijuese gjatë javës. Shenjojeni kutinë kur ta përfundoni secilin veprim.

- Tregojeni besimin tuaj këtë të diel duke e mbajtur ditën e Shabatit të shenjtë dhe duke e marrë me nderim sakramentit.
- Lexoni nga Libri i Mormonit çdo ditë.
- Lexojini shkrimet e shenjta në faqen 7. Zgjidhni njërin prej tyre dhe tregojani atë familjes apo miqve tuaj.

“Tani nëse Perëndia e vesh kështu barin e fushës, që sot është dhe nesër hidhet në furrë, vallë nuk do t’ju veshë shumë më tepër ju, njerëz besimpakë?”

MATEU 6:30

“A nuk varen të gjitha përpjekjet tuaja të çdo lloji, nga besimi juaj? . . . Ndërsa i marrim me anë të besimit të gjitha bekimet materiale që marrim, po ashtu ne, në mënyrë të ngjashme marrim me anë të besimit të gjitha bekimet shpirtërore që i marrim. Por besimi nuk është vetëm parimi i veprimit, por edhe i fuqisë.”

LECTURES ON FAITH (1985), f. 2, 3

SHKRIME TË SHENJTA RRETH BESIMIT NË VEPRIM

Për shkak se Danieli nuk ndalonte së luturi, atë e hodhën në një gropë luanësh, por “Perëndia . . . dërgoi engjëllin e tij që . . . mbyll[i] gojën e luanëve, . . . dhe nuk u gjet mbi të asnjë lëndim sepse kishte pasur besim te Perëndia i tij” (Daniel 6:22–23; shih edhe vargjet 16–21).

Zoti ia dha Lehit Liahonën për ta udhëhequr familjen e tij dhe “ajo punoi për ta sipas besimit të tyre në Perëndi. . . . [Kur] ata ishin përtacë dhe harrojnë të ushtronin besimin dhe zellin e tyre, . . . ata nuk përparonin në udhëtimin e tyre” (Alma 37:40–41).

“Sillni gjithë të dhjetat në shtëpinë e thesarit . . . dhe pastaj më vini në provë për këtë gjë . . . në se unë nuk

do t’i hap pragjet e qiellit dhe nuk do të derdh mbi ju aq shumë bekim, sa nuk do të keni vend të mjaftueshëm ku ta shtini” (Malakia 3:10).

Gjatë një zie buke, Elija i kërkoi një të veje që t’ia jepte atij vaktin e saj të fundit. Elija i premtoi që, për shkak të besimit të saj, Zoti do t’i siguronte ushqim dhe ushqimi i saj nuk do të mbaronte kurrë. (Shih 1 Mbretërve 17.)

“Të mjerët dhe të varfërit kërkojnë ujë, por mungon; gjuha e tyre u është tharë nga etja; unë, Zoti do t’ua plotësoj dëshirën; unë, Perëndia i Izraelit, nuk do t’i braktis” (Isaia 41:17; shih edhe vargun 18).

USHTRONI BESIM TE JEZU KRISHTI

Nëse nuk jeni në gjendje ta shikoni materialin filmik, lexoni këtë tekst.



PLAKU DEJVID A. BEDNAR: Ndërmarrja e veprimit është ushtrimi i besimit. Fëmijët e Izraelit po mbajnë arkën e besëlidhjes. Ata vijnë te Lumi Jordan. Premtimi është se ata do të kalojnë nga ana tjetër në tokë të thatë. Kur ndahet uji? Kur u lagen këmbët. Ata futen në lumë – veprojnë. Më pas vjen fuqia – uji ndahet.

Ne shpeshherë besojmë: “Do ta kem këtë kuptueshmëri të përkryer dhe më pas do ta shndërroj atë në ato që bëj”. Do të sugjeroja që ne kemi mjaftueshëm sa për të filluar nga puna. Ne kemi një ndjesi për drejtimin e duhur. Besimi është një parim – parimi – i veprimit dhe i fuqisë. Besimi i vërtetë përqendrohet në dhe te Zoti Jezu Krisht dhe gjithnjë të çon drejt veprimit.

(Shih “Seek Learning by Faith” [fjalim drejtuar mësuesve të fesë të Sistemit Arsimor të Kishës, 3 shkurt 2006], lds.org/media-library)

Kthehuni te faqja 224.



3: ADMINISTRUJINI PARATË

- Raportoni:** Tregojini shkurtimisht grupit mënyrën se si dita e Shabatit apo Libri i Mormonit e forcuan besimin tuaj javën e kaluar.
- Përsiatni:** Përse është administrimi i parave kaq i vështirë – dhe kaq i rëndësishëm?
- Shikoni:** “First Things First!” [“Në Fillim Gjërat e Para”], në dispozicion te srs.lds.org/videos. (Nuk keni material filmik? Lexoni faqen 10.)
- Diskutoni:** Pse duhet të mbajmë shënim se ku shkojnë paratë tona dhe t'i kursejmë ato?
- Lexoni:** Doktrina e Besëlidhje 104:78 dhe thënia nga *Përgatisni Çdo Gjë Të Nevojshme: Financat e Familjes* (në të djathtë)
- Diskutoni:** Lexoni për metodën e mbështetjes të vetja rreth administrimit të parave (poshtë). Si mund ta bëjmë këtë një zakon?

“Dhe përsëri, në të vërtetë unë ju them, lidhur me borxhet tuaja – vini re, është vullneti im që ju duhet t’i paguani të gjitha borxhet tuaja.”

DOKTRINA E BESË-LIDHJE 104:78

QASJA PËR MBËSHTETJEN TË VETJË

①


Punojmë fort dhe me zgjuarsia për të fituar para.



Të Ardhurat

②

Paguajmë Zotin të parin.



Të Dhjetat dhe Ofertat

③

Paguajmë veten të dytin.



Kursimet

④

Pastaj shpenzojmë më pak nga sa fitojmë dhe e shmangim borxhin.



Shpenzimet aktuale të jetesës

“Paguani të dhjetën dhe ofertat, . . . shmangni borxhin, . . . përdorni buxhet, . . . përcaktoni si t’i pakësoni shpenzimet për gjëra jo të rëndësishme . . . [dhe] disiplinoni veten për të jetuar brenda planit tuaj buxhetor.”

PËRGATISNI ÇDO GJË TË NEVOJSHME: FINANCAT E FAMILJES (BROSHURË, 2007), f. 3

VEPRIMTARI

Hapi 1: Individualisht rishikoni shpenzimet tuaja më poshtë.

SI NDIHEM RRETH SHPENZIMEVE TË MIA?			
Kategoria	Shpenzoj tepër pak	Ndihem mirë për shpenzimet e mia	Shpenzoj me tepri
Shembull ➡ Veshje			✓
Ngrënia në restorante			
Artikujt ushqimorë			
Ushqimet e lehta dhe pijet			
Zbavitjet			
Strehimi			
Shërbimet komunale			
Veshjet			
Gjëra për shtëpinë			
Transporti			
Sigurimet			
Telefoni			
Pagesat e borxhit			
E Dhjeta			
Dhurimet për bamirësi			
Të tjera			

Hapi 2: Lexoni citimin nga Plaku Robert D. Hejls (në të djathtë). Diskutoni se si mund t'i zvogëloni shpenzimet në kategoritë ku ju harxhoni shumë para.

Zotohuni: Zotohuni që t'i bëni veprimet vijuese gjatë javës. Shenjojeni kutinë kur ta përfundoni secilin veprim.

- Mbajini shënim ato që fitoni dhe shpenzoni çdo ditë. Ju mund të përdorni Dokumentin e të Ardhurave dhe Shpenzimeve në faqen 11.
- Tregojani familjes apo miqve tuaj atë që keni mësuar sot rreth administrimit të parave.

“Duket se ka një ndjesi të së drejtës për ta zotëruar diçka në kulturën e sotme. . . . Kur ngarkohemi me borxhe të tepërta, ne e kemi . . . vënë veten në një robëri të krijuar nga ne vetë, duke harxhuar gjithë kohën, gjithë energjinë dhe gjithë mjetet tona për shlyerjen e borxheve tona. . . . Është thelbësore që ne të . . . hartojmë një plan shpenzimesh dhe kursimesh – një buxhet – dhe të bëjmë dallimin midis dëshirave dhe nevojave.”

ROBERT D. HALES,
“Seek and Attain the Spiritual High Ground in Life” (mbledhje rreth vatrës e Sistemit Arsimor të Kishës, mars 2009), [lds.org/media-library](https://www.lds.org/media-library)

NË FILLIM GJËRAT E PARA!

Nëse nuk jeni në gjendje ta shikoni materialin filmik, zgjidhni rolet dhe lexoni këtë tekst.



MJEDISI: Një djalë dhe një vajzë e vogël, të veshur me rroba të rriturish, duke u sjellë si prindërit e tyre.

DJALI: Jam në shtëpi, e dashur.

VAJZA: Mirë se erdhe në shtëpi. Ua, sa i lodhur që dukesh.

DJALI: Edhe ti. Ti punon shumë, apo jo?

VAJZA: Epo, na duhet të punojmë, apo jo?

DJALI: Fitova 10 [mijë lekë] sot.

VAJZA: O, çfarë bekimi. Pra, në fillim gjërat e para! Le ta paguajmë të dhjetën tonë, dakord?

DJALI: Por, po sikur të mos kemi mjaftueshëm?

VAJZA: Pikërisht atëherë na duhet besim!

DJALI: Në rregull. Pra, çfarë vjen pastaj?

VAJZA: Epo, do të na duhet të blejmë ushqime, të paguajmë për biletat e autobusit e të paguajmë qiranë. Dhe më pas, do të ishte bukur po të blinim një karrige . . .

DJALI: Por nuk mundemi. E shikon? Nuk kemi para mjaftueshëm.

VAJZA: A mund të marrim ca borxh?

DJALI: Thonë se borxhi është i rrezikshëm. Ne nuk duam të futemi në telashe.

VAJZA: Në rregull. Ke të drejtë. Pra, çfarë duhet të bëjmë me këto?

DJALI: Le t'i ruajmë! Nuk i dihet kurrë se çfarë do të ndodhë.

VAJZA: Kjo duket e drejtë. Por nuk na mbetet asgjë për t'u dëfryer.

DJALI: Ne kemi njëri-tjetrin! Dhe unë do të përpiqem të fitoj më shumë.

VAJZA: Unë do të përpiqem të shpenzoj më pak!

DJALI: Në atë mënyrë ne mund të jemi të lumtur – e të mbështetur te vetja!

VAJZA: E drejtë! Nuk ishte aq e vështirë. Pse të rriturit e bëjnë kaq të madhe?

DJALI: O, ti e di. Kështu janë të rriturit!

Kthehuni te faqja 226.

DOKUMENTI I TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE

Shkruani se sa shpenzoni çdo javë. Si do të ishte nëse do të kishit mjaft para për nevojat tuaja?

SA SHPENZOJ ÇDO JAVË?					Sa më duhen çdo muaj për të qenë i mbështetur te vetja?
	Java 1	Java 2	Java 3	Java 4	
Të Ardhurat					
Të dhjetat, ofertat					
Kursimet					
Ushqimi					
Strehimi					
Shpenzimet mjekësore					
Transporti					
Shpenzimet e arsimit					
Pagesat e borxhit					
Veshjet					
Shërbimet komunale					
Telefoni					
Zbavitjet					
Sigurimet					
Të tjera					
Shpenzimet gjithsej					



4: PENDOHUNI DHE JINI I BINDUR

Raportoni: Tregojani shkurtimisht grupit përparimin tuaj për mbajtjen shënim të të ardhurave dhe shpenzimeve të javës së kaluar.

Përsiatni: Si lidhen pendimi dhe bindja me mbështetjen te vetja?

Shikoni: "Obedience Brings Blessings" ["Bindja Sjell Bekime"], në dispozicion te srs.lids.org/videos. (Nuk keni material filmik? Lexoni faqen 13.)

Diskutoni: Çfarë bekimesh keni marrë me anë të bindjes ndaj ligjeve të Perëndisë? Si na ndihmon pendimi që të përparojmë?

Lexoni: Doktrina e Besëlidhje 130:20–21 dhe citimi nga Profeti Jozef Smith (në të djathtë)

VEPRIMTARI

Bindja ndaj ligjeve të posaçme çon drejt bekimeve të posaçme.

Hapi 1: Në mënyrë të pavarur, në kolonën e majtë, shkruani disa bekime që ju i dëshironi.

Hapi 2: Përcaktoni se cilat ligjeve ose parimeve keni nevojë t'i bindeni me qëllim që t'i merrni bekimet që dëshironi.

BEKIMET QË DËSHIROJ TË MARR	LIGJET OSE PARIMET QË DUHET T'I BINDEM
Tri muaj kursime	E dhjeta dhe ofertat (Malakia 3:10–12) Ecni sipas një buxheti

Diskutoni: Lexoni Jozueun 3:5 dhe citimet nga Plaku Xhefri R. Holland dhe Presidenti Spenser W. Kimball (në faqen 13). Përse kemi nevojë të pendohemi, ta shenjtërojmë veten tonë dhe të përpiqemi të bëjmë mirë ndërsa kërkojmë të bëhemi të mbështetur te vetja?

Zotohuni: Zotohuni që t'i bëni veprimet vijuese gjatë javës. Shenjojeni kutinë kur ta përfundoni secilin veprim.

- Bindjuni ligjit që zgjodhët në veprimtarinë më lart.
- Tregojani familjes apo miqve tuaj atë që keni mësuar sot rreth bindjes.

"Ka një ligj . . . mbi të cilin të gjitha bekimet bazohen – dhe kur ne fitojmë ndonjë bekim nga Perëndia, është me anë të bindjes ndaj atij ligji mbi të cilin ai bazohet."

DOKTRINA E BESËLIDHJE 130:20–21

"Unë e bëra këtë rregullin tim: Kur Zoti urdhëron, bindu."

**MËSIMET TË PRESIDEN-
TËVE TË KISHËS: JOZEF
SMITH (2009), f. 168**

BINDJA SJELL BEKIME

Nëse nuk jeni në gjendje ta shikoni materialin filmik, lexoni këtë tekst.



PRESIDENTI TOMAS S. MONSON:

Çfarë premtimi i lavdishëm! “Ai që i mban urdhërimet e [Perëndisë], merr të vërtetë e dritë, derisa të përlëvdohet në të vërtetë dhe i di të gjitha gjërat” [DeB 93:28]. . . .

Vëllezërit dhe motrat e mia, prova e madhe e kësaj jete është bindja. “Dhe ne do t’i provojmë me këtë”, tha Zoti, “për të parë nëse ata do t’i bëjnë të gjitha gjërat që Zoti, Perëndia i tyre, do t’i urdhërojë” [Abraham 3:25]. . . .

Shpëtimtari shpalli: “Sepse të gjithë ata që dëshirojnë të kenë bekim nga dora ime, duhet t’i binden ligjit që u caktua për atë bekim dhe kushteve të tij, siç u ngritën që përpara krijimit të botës” [DeB 132:5].

Nuk ekziston shembull më i shkëlqyer për bindjen se ai i Shpëtimtarit tonë. Për Të, Pali vërejti:

“Edhe pse ishte Bir, mësoi të jetë i bindur nga ato që pësoi,

dhe, si u bë i përkryer, u bë vepronjësi i shpëtimit të amshuar për të gjithë ata që i binden” [Hebrenjve 5:8–9].

Shpëtimtari tregoi dashuri të sinqertë për Perëndinë duke jetuar jetë të përsosur, duke e nderuar misionin e shenjtë që ishte i Tij. Kurrë nuk ishte Ai

arrogant. Kurrë nuk ishte Ai i fryrë me krenari. Kurrë nuk ishte Ai i pabesë. Gjithmonë ishte Ai i përlulur. Gjithmonë ishte Ai i sinqertë. Gjithmonë ishte Ai i bindur. . . .

Kur u përball me agoninë e Gjetsemanit, ku Ai duroi dhembje të tillë sa që “djersa e tij. . . i[u] bë si gjak i mpiksuar që bie për tokë” [Luka 22:44], Ai dha shembullin e Birit të bindur duke thënë: “O Atë, po të duash, largoje këtë kupë nga unë! Megjithatë mos u bëftë vullneti im, por yt” [Luka 22:42].

Sikurse Shpëtimtari i udhëzoi Apostujt e Tij të hershëm, kështu ju udhëzon Ai ju dhe mua: “Ti ndiqmë” [Gjoni 21:22]. A jemi të gatshëm të bindemi?

Dituria që kërkojmë, përgjigjet për të cilat jemi të dëshiruar, dhe forca që dëshirojmë sot për të përballuar sfidat e një bote të ndërlikuar dhe në ndryshim, mund të jenë tonat kur u bindemi me gatishmëri urdhërimeve të Zotit. Po i citoj edhe një herë fjalët e Zotit: “Ai që i mban urdhërimet e [Perëndisë], merr të vërtetë e dritë, derisa të përlëvdohet në të vërtetë dhe i di të gjitha gjërat” [DeB 93:28].

Është lutja ime e përlulur që të mund të bekohemi me shpërblimet e bollshme që u premtohen të bindurve. Në emrin e Jezu Krishtit, Zotit dhe Shpëtimtarit tonë, amen.

(“Bindja Sjell Bekime”, *Ensign ose Liahona*, maj 2013, f. 89, 92)

Kthehuni te faqja 230.

“Shenjtërohuni, sepse nesër Zoti ka për të bërë mrekulli midis jush.”

JOZUEUT 3:5

“Zoti i bekon ata që dëshirojnë të përmirësohen, që e pranojnë nevojën për urdhërime dhe përpiqen t’i zbatojnë ato. . . . Ai do t’ju ndihmojë të pendoheni, të ndreqni, të rregulloni çfarëdo që duhet rregulluar dhe të vazhdoni. Shumë shpejt do ta keni suksesin që kërkon.”

XHEFRI R. HOLLAND,
“Nesër Zoti Ka për të Bërë Mrekulli midis Jush”, *Ensign ose Liahona*, maj 2016, f. 126

“Nëse na pëlqen luksi ose madje domosdoshmëritë më tepër sesa na pëlqen bindja, ne do t’i humbasim bekimet që Atij do t’i pëlqente të na i jepte.”

SPENCER W. KIMBALL,
në *Teachings of Spencer W. Kimball*, red. Edward L. Kimball (1982), f. 212



5: PËRDORENI KOHËN ME MENÇURI

Raportoni: Tregojini shkurtimisht grupit për një bekim që e morët javën e kaluar, ngaqë ishit të bindur.

Përsiatni: Përse koha është një nga dhuratat më të mëdha të Perëndisë?

Shikoni: "The Gift of Time" ["Dhurata e Kohës"], në dispozicion te srs.lds.org/videos. (Nuk keni material filmik? Lexoni faqen 15.)

Diskutoni: Çfarë mësuat nga motra Benkozi?

Lexoni: Alma 34:32 dhe citimi nga Presidenti Brigham Jang (në të djathtë)

"Pasi vini re, kjo jetë është koha për njerëzit që të përgatiten të takohen me Perëndinë; po, vini re, dita e kësaj jete është dita për njerëzit që të kryejnë punët e tyre."

ALMA 34:32

VEPRIMTARI

Hapi 1: Me një partner, lexoni pesë hapat që mund të ndërmerrni çdo ditë për ta përdorur mirë kohën tuaj.

1	2	3	4	5
RENDITNI DETYRA	LUTUNI	VENDOSNI PËRPARËSI	VENDOSNI SYNI-ME, VEPRONI	RAPORTONI
Çdo mëngjes, bëni një listë me detyrat që duhen bërë. Shtoni emra të njerëzve që duhet t'u shërbeni.	Lutuni për udhërrëfim. Rishikojeni listën tuaj të detyrave. Mbani vesh. Zotohuni për të bërë më të mirën tuaj.	Në listën tuaj të detyrave, vini një "1-sh" pranë detyrës më të rëndësishme, një "2-sh" pranë asaj të radhës nga rëndësia e kështu me radhë.	Dëgjoni Shpirtin. Vendosni synime. Punoni fort. Filloni me detyrën më të rëndësishme e vazhdoni deri në fund të listës.	Çdo natë, raportojini Atit Qiellor në lutje. Bëni pyetje. Mbani vesh. Pendohuni. Ndiejeni dashurinë e Tij.

Hapi 2: Në një copë letër të veçantë, renditni detyrat tuaja. Këto duhet të jenë detyra të rëndësishme për punën tuaj, për studimet tuaja, për kishën apo shërbimin familjar – jo vetëm punët e përditshme të shtëpisë. Lutuni rreth listës suaj dhe renditni përparësitë në të.

Hapi 3: Nesër ju duhet të vendosni synime, të veproni dhe të raportoni se si e keni përdorur kohën tuaj.

"Koha është gjithë fondi i kapitalit që gjendet këtu në tokë. . . . Nëse përdoret siç duhet, ai sjell atë çfarë do ta shtojë ngushëllimin, volinë dhe kënaqësinë tuaj. Le ta marrim parasysh këtë e të mos rrimë më ulur duarkryq, duke e çuar kohën dëm."

Zotohuni: Zotohuni që t'i bëni veprimet vijuese gjatë javës. Shenjojeni kutinë kur ta përfundoni secilin veprim:

- Ushtroni këta hapa çdo ditë për ta përdorur kohën tuaj më me mençuri. Çdo natë, raportojini Atit Qiellor në lutjet tuaja.
- Tregojani familjes apo miqve tuaj atë që keni mësuar sot rreth përdorimit të kohës me mençuri.

BRIGHAM YOUNG, në Discourses of Brigham Young, përzgj. John A. Widtsoe (1954), f. 214

DHURATA E KOHËS

Nëse nuk jeni në gjendje ta shikoni materialin filmik, zgjidhni rolet dhe lexoni këtë tekst.



KOFI: Përshëndetje, motra Benkozi. Si je?

MOTRA BENKOZI: A je mirë, Kofi?

KOFI: O, motra Benkozi. Jam kaq i zënë. Duhet të punoj dhe të shërbej e ta ndihmoj familjen time . . . dhe pastaj kam edhe futboll. Nuk kam kohë!

MOTRA B.: Kofi, ti ke gjithë kohën në dispozicion.

KOFI: Çfarë?

MOTRA B.: Biri im, Perëndia na ka dhënë një dhuratë të madhërisme – kohën tonë. Ne duhet të bëjmë me të atë që ka më shumë rëndësi.

KOFI: Po si, motra Benkozi? Ti gjithnjë ke bërë kaq shumë gjëra. Ia ke dalë mbanë me familjen tënde, me biznesin tënd. Ti u ke shërbyer e ke bekuar shumë njerëz, përfshirë mua. Nuk e di se si ia del.

MOTRA B.: Dëshiron vërtet ta dish? Nëse do të ulesh e dëgjosh, do të ta tregoj sekretin tim.

Çdo mëngjes unë ngrihem përpara lindjes së diellit. Vishem dhe laj fytyrën e duart e mia.

Lexoj shkrimet e shenjta. Pastaj bëj një listë me ato që duhet të bëj atë ditë.

Mendoj se kujt mund t'i shërbej. Lutem për të ditur vullnetin e Perëndisë. Dhe mbaj vesh.

Ndonjëherë, emrat ose fytyrat e njerëzve më vijnë në mendje. I shtoj ata në listën time.

KOFI: A është kjo mënyra se si ti e di gjithnjë saktësisht se kush ka nevojë për shërbimin tënd?

MOTRA B.: Po, Kofi. Dhe unë lutem për forcë e urtësi. Lutem që Perëndia ta "shenjtërojë kryerjen t[ime]". Kjo thuhet te 2 Nefi 32.

Unë e falënderoj Atë. Premtoj se do të bëj më të mirën time. I kërkoj që Ai të bëjë atë që unë nuk mundem.

Pastaj e hedh vështrimin te lista ime. Vë një "1-sh" pranë gjësë më të rëndësishme, pastaj një "2-sh".

KOFI: Nga i di përparësitë?

MOTRA B.: Unë mbaj vesh kur lutem! Pastaj shkoj të punoj. Vështroj numrin 1 dhe përqipem ta bëj të parin, pastaj numrin 2.

Ndonjëherë gjërat ndryshojnë. Fryma e Shenjtë më thotë të bëj diçka tjetër. Ajo është gjë e mirë.

Unë punoj shumë fort, por kam paqe. E di se Perëndia do të më ndihmojë.

Prandaj, me listën dhe Shpirtin, unë bëj atë që ka rëndësi, Kofi.

KOFI: Kjo duket e thjeshtë dhe e vështirë në të njëjtën kohë.

MOTRA B.: Ke të drejtë! Kur më në fund përgatitem për të fjetur, unë lutem. I raportoju Atit Qiellor. I tregoj Atij se si shkoi dita. I bëj pyetje. E pyes se çfarë mund të bëj më mirë. Mbaj vesh. Shpesh e ndiej dashurinë e Tij. E di se Ai e lartëson atë që përqipem të bëj. Më pas kam paqe, Kofi, dhe fle.

KOFI: Ajo është gjë e mirë, mama Benkozi. Unë e dëshiroj këtë paqe. Dëshiroj ta përdor kohën time. Dëshiroj të punoj e të shërbej më mirë.



6: PUNONI: MERRNI PËRGJEGJËSI DHE KËMBËNGULNI

- Raportoni:** Tregojini shkurtimisht grupit diçka që e arritët javën e kaluar ngaqë e përdorët mirë kohën tuaj.
- Përsiatni:** Përse Ati Qiellor dëshiron që unë të marr përgjegjësi vetjake për jetën time?
- Shikoni:** "Sedrick's Journey" ["Udhëtimi i Sedrikut"], në dispozicion te srs.lids.org/videos. (Nuk keni material filmik? Lexoni faqen 17.)
- Diskutoni:** Si mësojmë të vazhdojmë pa u ndalur edhe kur puna është e vështirë?
- Lexoni:** Doktrina e Besëlidhje 42:42 dhe citimi nga Presidenti Xhejms E. Faust (në të djathtë)
- Diskutoni:** Lexoni citimin nga Plaku D. Tod Kristoferson (në faqen 17). Përse Zoti pret nga ne që të punojmë për atë që marrim?

"Mos ji dembel; sepse ai që është dembel nuk duhet të hajë bukën, as duhet të veshë rrobat e punëtorit."

DOKTRINA E BESË-LIDHJE 42:42

"Këmbëngulja tregohet me vepra nga ata që . . . nuk heqin dorë edhe kur të tjerët thonë: 'Kjo nuk mund të bëhet.'"

JAMES E. FAUST,
"Perseverance", *Ensign*
ose *Liahona*, maj 2005,
f. 51

VEPRIMTARI

Hapi 1: Zgjidhni një partner dhe lexojeni së bashku çdo hap në modelin më poshtë.

Hapi 2: Kërkojini njëri-tjetrit që të flisni rreth një detyre apo sfide shumë të vështirë që personi tjetër po has.

Hapi 3: Ndhimoheni njëri-tjetrin që t'i zbatoni të katër hapat më poshtë për detyrën apo sfidën e vështirë.

1 MBANI NJË QËNDRIM POZITIV	2 MBANI MEND QË TË PUNONI SË BASHKU	3 ZËVENDËSOJENI FRIKËN ME BESIM	4 SHKONI PËRPARA ME DURIM E GUXIM
Renditini bekimet tuaja.	Kërkojuni ndihmë miqve, bashkëmoshatarëve, anëtarëve të grupit dhe të tjerëve.	Shmangeni dyshimin. Mbajeni mend se Zoti e ka të gjithë fuqinë. Bëjini thirrje Atij dhe pranojini vullnetin e Tij.	Kurrë, kurrë, kurrë mos hiqni dorë; duroni me besim. Kërkoni për mësim që Zoti mund të jetë duke ju mësuar.

Hapi 4: Shkruani dy ose tri mënyra se si mund të shkoni përpara me besim, duke mirëbesuar se Perëndia do të sigurojë për ju.

Përsiatni: Lexoni citimin nga Presidenti Tomas S. Monson (në të djathtë). Si reagoj unë kur përjetoj dështim?

Zotohuni: Zotohuni që t'i bëni veprimet vijuese gjatë javës. Shenjojeni kutinë kur ta përfundoni secilin veprim.

Zgjidhni diçka që është e vështirë ose e parehatshme dhe përfundojeni detyrën. Shkruajeni më poshtë.

Tregojani familjes apo miqve tuaj atë që keni mësuar sot rreth punës dhe këmbënguljes.

UDHËTIMI I SEDRIKUT

Nëse nuk jeni në gjendje ta shikoni materialin filmik, lexoni këtë tekst.



SEDRIKU: Unë quhem Sedrik Kambeza-bue. Jetoj në Republikën Demokratike të Kongos. Jam anëtar i Kishës SHDM.

Jam misionar dege në fshatin e Kipu-sangës. Duhet të përgatitem për të shkuar në një mision të huaj. Në mënyrë që të shkoj në një mision, më nevojitet një pasaportë, e cila tani kushton 250 dollarë amerikanë.

Për të fituar para, unë dhe babai im blejmë banane. Disa fshatra prodhojnë shumë banane: Tishabobo, Lusuku dhe Kamanda.

Tishabobo është rreth 14,5 kilometra larg prej këtu. Lusuku është 29 kilometra larg. Edhe Kamanda është 29

kilometra larg. Ne shkojmë atje e blejmë banane dhe i sjellim këtu për t'i shitur.

Për të shkuar nëpër fshatra ne përdorim një biçikletë. Ne mund të marrim katër ose gjashtë tufa banane.

Kur shkoj me biçikletë, një rrugë shkon një orë e gjysmë, nëse biçikleta punon dhe unë kam fuqi. Kur është mesditë dhe i nxehti është mbytës, unë lëviz ngadalë për shkak të të nxehtit dhe diellit.

Mund të bëj dy udhëtime në ditë nëse zgjohem shumë herët në mëngjes. Kjo është një mënyrë e mirë për të ndihmuar në pagimin e pasaportës sime.

Tani po fitoj para, pak e nga pak, ndaj po kursej si për shpenzimet e shkollës edhe të misionit. Dhe tani, pas katër vitesh punë, kam mjaftueshëm para për pasaportën time, plus 70 dollarë të kursyera.

Kthehuni te faqja 234.

"Perëndia e ka projektuar këtë ekzistencë të vdekshme për të kërkuar thuajse një tendosje të përherëshme. . . . Me punë ne mbajmë dhe pasurojmë jetën. . . . Puna ngre dhe përsos karakterin, krijon bukuri dhe është instrumenti i shërbimit tonë për njëri-tjetrin dhe për Perëndinë. Një jetë e shenjtë është e mbushur me punë, ndonjëherë e përsëritur, . . . ndonjëherë e pavlerësuar, por gjithmonë punë që përmirëson, . . . ngre [dhe] [synon]."

D. TOD KRISTOFERSON, "Mendime mbi një Jetë të Përkushtuar", Ensign ose Liahona, nëntor 2010, f. 17

"Përgjegjësia jonë është të ngrihemi nga mediokriteti te zotësia, nga dështimi tek arritja. Detyra jonë është të bëhemi vetja jonë më e mirë. Një prej dhuratave më të madhërishe të Perëndisë për ne është gëzimi i të provuarit përsëri, sepse asnjë dështim nuk ka pse të jetë përfundimtar."

THOMAS S. MONSON, "The Will Within", Ensign, maj 1987, f. 68



7: ZGJIDHINI PROBLEMET

Raportoni: Tregojini shkurtimisht grupit një detyrë të vështirë që ishit në gjendje ta përfundonit javën e kaluar.

Përsiatni: Përse na lejon Ati Qiellor që të përballemi me probleme dhe sfida?


Shikoni: "A Bigger Truck?" ["Një Kamion më i Madh?"], në dispozicion te srs.lds.org/videos. (Nuk keni material filmik? Lexoni faqen 19.)

Diskutoni: Cili është problemi i vërtetë në këtë histori? Cilat janë disa nga mundësitë për të dy burrat?

Lexoni: Doktrina e Besëlidhje 9:7–9 dhe citimi nga Plaku Robert D. Hejls (në të djathtë)

VEPRIMTARI

Hapi 1: Zgjidhni një partner dhe lexoni hapat më poshtë.



Hapi 2: Zgjidhni një problem që po hasni dhe shkruajeni poshtë.

Hapi 3: Zbatoni çdo hap për problemin tuaj.

Përcaktoni: _____

Mundësitë e studimit: _____

Vendosni dhe veproni: _____

"Vër re, ti nuk ke kuptuar; ke menduar se do të ta jap atë, kur ti nuk e more mundimin as për të më pyetur.

Por, vër re, unë të them se ti duhet ta studiosh atë tërësisht në mendjen tënde; më pas ti duhet të më pyesësh nëse është e drejtë dhe nëse është e drejtë, unë do të bëj që kraharori yt do të digjet përbrenda; si rrjedhim, do ta ndiesh që është e drejtë.

Por nëse nuk është e drejtë, ti nuk do të kesh ndjenja të tilla, por do të kesh një mpirje të mendimit që do të të bëjë ta harrosh gjënë që është e gabuar."

DOKTRINA E BESËLIDHJE 9:7-9

"Zoti pret nga ne që të ndihmojmë për zgjidhjen e vetë problemeve tona. . . . Ne jemi qenie njerëzore që mendojmë e arsyetojmë. Ne kemi zotësinë t'i dallojmë nevojat tona, të planifikojmë, të vendosim synime dhe t'i zgjidhim problemet tona."

ROBERT D. HALES,
"Every Good Gift", *New Era*, gusht 1983, f. 8, 9

Lexoni: 1 Nefi 17:51 dhe 1 Nefi 18:2–3 (në të djathtë)


Diskutoni: Në çmënyrë që në gjendje Nefi ta ndërtonte një anije?

Zotohuni: Zotohuni që t'i bëni veprimet vijuese gjatë javës. Shenjojeni kutinë kur ta përfundoni secilin veprim.

- Veproni sipas hapave që diskutuat te veprimtaria me qëllim që të filloni ta zgjidhni problemin tuaj. Mbani mend, mos hiqni dorë! Duhet kohë për t'i zgjidhur problemet e për të bërë ndryshime.
- Tregojani familjes apo miqve tuaj atë që keni mësuar sot rreth zgjidhjes së problemeve.

NJË KAMION MË I MADH?

Nëse nuk jeni në gjendje ta shikoni materialin filmik, lexoni këtë tekst.



PLAKU DALLIN H. OUKS: Dy burra formuan një ortakëri. Ata ndërtuan një barakë buzë një rruge të rrahur. Siguruan një kamion dhe shkuan me të në fushën e një fermeri, ku blenë një ngarkesë të plotë me shalqinj, për një dollar copën. Ata e çuan kamionin e ngarkuar në barakën e tyre buzë rrugës, ku i shitën shalqinj të me një

dollar copën. Shkuan përsëri te fusha e fermerit dhe blenë një ngarkesë tjetër të plotë me shalqinj, për një dollar copën. Pasi i transportuan shalqinj të në anë të rrugës, ata i shitën përsëri me një dollar. Teksa u kthyen sërish te fusha e fermerit për të marrë një ngarkesë tjetër, njëri nga ortakët i tha tjetrit: "Ne nuk po fitojmë shumë para me këtë biznes, apo jo?" "Jo, nuk po fitojmë", u përgjigj ortaku i tij. "A mendon se na duhet një kamion më i madh?"

("Focus and Priorities", *Ensign*, maj 2001, f. 82)

Kthehuni te faqja 236.

"Dhe tani, në qoftë se Zoti ka fuqi kaq të madhe dhe ka bërë kaq shumë mrekulli mes fëmijëve të njerëzve, si është e mundur që ai nuk mund të më udhëzojë që unë të ndërtoj një anije?"

1 NEFI 17:51

"Tani, unë, Nefi, nuk i punova trarët sipas mënyrës që mësohej nga njerëzit, as nuk e ndërtova anijen sipas mënyrës së njerëzve; por e ndërtova atë sipas mënyrës që Zoti më tregoi; prandaj ajo nuk ishte sipas mënyrës së njerëzve.

Dhe unë, Nefi, shkova në mal shpesh dhe iu luta Zotit shpesh; prandaj Zoti më tregoi gjëra të mëdha."

1 NEFI 18:2–3



8: BËHUNI NJË, SHËRBENI SË BASHKU

Raportoni: Tregojini shkurtimisht grupit diçka që bëtë javën e kaluar për të ndihmuar për zgjidhjen e një problemi.

Përsiatni: Si më shpëton mua në të vërtetë humbja e vetvetes në shërbimin ndaj të tjerëve?

Shikoni: "In the Lord's Way" ["Në Mënyrën e Zotit"], në dispozicion te srs.lids.org/videos. (Nuk keni material filmik? Lexoni faqen 21.)

Diskutoni: Si mund t'i hapë pragjet e qiellit në jetën tuaj shërbimi ndaj të tjerëve?

Lexoni: Disa njerëz mendojnë se ata e meritojnë atë që të tjerët e kanë tashmë, gjë e cila mund të shkaktojë mëri. Të tjerë mendojnë se kanë të drejtën për të pasur gjëra që nuk i kanë fituar. Këto dy kurthe i verbojnë njerëzit që të shohin një të vërtetë thelbësore: të gjitha gjërat i përkasin Perëndisë. Mëria dhe e drejta për ta pasur diçka mund të mposhten duke u përqendruar te nevojat e të tjerëve. Lexoni Mosian 2:17, Mosian 4:26 dhe citimin nga Presidenti Gordon B. Hinkli (në të djathtë).

VEPRIMTARI

Hapi 1: Si grup, mendoni për dikë që ka nevojë për ndihmë.

Hapi 2: Diskutoni për talentet, kontaktet dhe burimet që keni për të dhënë.

Hapi 3: Bëni një plan për t'i shërbyer atij personi. Për shembull, ju mund:



Familja Ime
Histori që na Bashkojnë



- Të kryeni një projekt shërbimi në komunitetin tuaj.
- Ta përgatitni historinë tuaj familjare duke përdorur broshurën *Familja Ime: Histori që na Bashkojnë*. Pastaj shkoni në tempull dhe kryeni ordinancat e shenjta për pjesëtarët e familjes që kanë vdekur.
- Ta ndihmoni dikë në shtegun e tij ose të saj drejt mbështetjes te vetja.

Lexoni: Citimet nga Plaku Robert D. Hejls dhe Presidenti Tomas S. Monson (në të djathtë)

Zotohuni: Zotohuni që t'i bëni veprimet vijuese gjatë javës. Shenjojeni kutinë kur ta përfundoni secilin veprim.

- Veproni sipas planit që bëtë për t'i shërbyer dikujt.
- Tregojani familjes apo miqve tuaj atë që keni mësuar sot rreth shërbimit.

"Kur jeni në shërbimin e bashkëqenieve tuaja, ju jeni vetëm në shërbimin e Perëndisë tuaj."

MOSIA 2:17

"Dhe tani, për hirin . . . e ruajtjes së një heqjeje të mëkateve tuaja nga dita në ditë, . . . unë do të doja që ju t'u jepni nga pasuria juaj të varfërve, çdo njeri sipas asaj që ka, në mënyrë që të ushqehen të uriturit, të vishen të zhveshurit, të vizitohen të sëmurët dhe t'u jepni ndihmë atyre qoftë shpirtërisht, ashtu edhe materialisht, sipas nevojave të tyre."

MOSIA 4:26

"Kur ju jeni të bashkuar, fuqia juaj është e pakufishme. Ju mund të arrini çfarëdo gjëje që dëshironi të arrini."

GORDON B. HINCKLEY, "Your Greatest Challenge, Mother", Ensign, nëntor 2000, f. 97

NË MËNYRËN E ZOTIT

Nëse nuk jeni në gjendje ta shikoni materialin filmik, lexoni këtë tekst.



PRESIDENTI HENRI B. AJRING:

Parimet në themelin e programit të Kishës për mirëqenien janë jo vetëm për një kohë apo një vend. Ato janë për të gjitha kohët dhe të gjitha vendet. . . .

. . . Mënyra se si duhet bërë ajo, është e qartë. Ata që kanë grumbulluar më shumë, duhet ta përuhin veten për t'i ndihmuar njerëzit nevojtarë. Ata që kanë bollëk, duhet të sakrifikojnë vullnetarisht një pjesë të rehatisë, kohës, aftësive dhe burimeve të tyre për të lehtësuar vuajtjen e njerëzve nevojtarë. Dhe ndihma duhet dhënë në një mënyrë që e rrit fuqinë e marrësve për t'u kujdesur për veten e tyre e më pas të kujdesen për të tjerët. Nëse bëhet kështu, në mënyrën e Zotit, diçka mbresëlënëse mund të ndodhë. Edhe dhënësi edhe marrësi bekohen.

(Përshtatur nga një fjalim i dhënë nga

Presidenti Ajring në përkushtimin e Qendrës së Shërbimeve për Mirëqenien në Shugërhauz të Jutas, qershor 2011, LDS.org)

PRESIDENTI DITER F. UHTDORF:

Vëllezër e motra, secili prej nesh ka një përgjegjësi prej besëlidhjeve që të jetë i ndjeshëm ndaj nevojave të të tjerëve dhe të shërbejë ashtu siç bëri Shpëtimtari – për të ndihmuar, bekuar dhe ngritur moralisht ata që janë rreth nesh.

Shpesh, përgjigjja ndaj lutjes sonë nuk vjen kur jemi në gjunjë, por ndërsa jemi në këmbë, duke i shërbyer Zotit dhe duke u shërbyer atyre që janë rreth nesh. Veprimet vetëmohuese të shërbimit dhe përkushtimit [i pastrojnë] shpirtat tanë, i heqin luspat nga sytë tanë shpirtërorë dhe hapin pragjet e qiellit. Duke u bërë përgjigjja për lutjen e një tjetri, ne shpesh gjejmë përgjigjen për lutjen tonë.

(“Duke Pritur në Rrugën për Damask”, *Ensign* ose *Liahona*, maj 2011, f. 76)

Kthehuni te faqja 238.

“Qëllimi i mbështetjes materiale dhe shpirtërore te vetja është që ta sigurojmë veten shpirtërisht dhe materialisht, në mënyrë që t'i ndihmojmë dhe të tjerët që janë në nevojë.”

ROBERT D. HEJLS, “Të Vijnë në Vete: Sakramenti, Tempulli dhe Sakrifika e Shërbimit”, *Ensign* ose *Liahona*, maj 2012, f. 36

“Kur punojmë së bashku në mënyrë bashkëpunuese, . . . ne mund të arrijmë çfarëdo gjëje. Kur e bëjmë këtë, ne e heqim dobësinë e një njeriu që qëndron i vetëm, dhe e zëvendësojmë me forcën e shumë njerëzve që shërbejnë së bashku.”

THOMAS S. MONSON, “Church Leaders Speak Out on Gospel Values”, *Ensign*, maj 1999, f. 118



9: KOMUNIKONI: BËNI KËRKESA DHE DËGJONI

Raportoni: Tregojani shkurtimisht grupit mënyrën se si i shërbyet dikujt javën e kaluar.

Përsiatni: Kur iu është përgjigjur Ati Qiellor lutjeve të mia?

Shikoni: "Creating Lift," ["Krijimi i Forcës Ngritëse"], në dispozicion te srs.lids.org/videos. (Nuk keni material filmik? Lexoni faqen 23.)

Diskutoni: Si mund t'i dallojmë përgjigjet ndaj lutjeve tona? Përse është dëgjimi një pjesë thelbësore e lutjes?

Lexoni: Doktrina e Besëlidhje 8:2 dhe citimi nga Presidenti Rasëll M. Nelson (në të djathtë)


Diskutoni: Përse është të dëgjuarit një aftësi thelbësore? Si mund të na ndihmojë në punën tonë të dëgjuarit me kujdes?

VEPRIMTARI

Hapi 1: Si grup, lexojini hapat më poshtë dhe diskutoni shkurtimisht për ato.

Hapi 2: Kërkojini njërit ose dy prej anëtarëve të grupit t'u tregojnë të tjerëve rreth një sfide apo pyetjeje që ata kanë. Çdokush tjetër duhet të përpiqet të dëgjojë, duke i ndjekur këto hapa.

Hapi 3: Kur të mbaroni, pyetini anëtarët e grupit që folën se si u ndien kur grupi u përpoq vërtet të dëgjonte.



"Unë do të të them në mendjen tënde dhe në zemrën tënde, me anë të Frymës së Shenjtë, që do të vijë mbi ty dhe që do të banojë në zemrën tënde."

DOKTRINA E BESËLIDHJE 8:2

"Shpirti juaj do të bekohet teksa mësoni të dëgjoni, më pas dëgjoni për të mësuar nga fëmijët, prindërit, shokët, fqinjët dhe udhëheqësit e Kishës, dhe të gjitha këto do ta zgjerojnë aftësinë për të dëgjuar këshilla nga lart."

RUSSELL M. NELSON,
"Listen to Learn",
Ensign, maj 1991, f. 24

Lexoni: Citimet nga Presidenti Henri B. Ajring dhe Plaku Robert D. Hejls (në të djathtë)

Zotohuni: Zotohuni që t'i bëni veprimet vijuese gjatë javës. Shenjojeni kutinë kur ta përfundoni secilin veprim.

- Lutuni individualisht dhe si familje çdo mëngjes e çdo natë. Shpenzoni kohë pas çdo lutjeje që të dëgjoni plot nderim për udhërrëfim.
- Tregojani familjes apo miqve tuaj atë që keni mësuar sot rreth komunikimit.

KRIJIMI I FORCËS NGRITËSE

Nëse nuk jeni në gjendje ta shikoni materialin filmik, lexoni këtë tekst.



PRESIDENTI DITER F. UHTDORF: Me qëllim që një aeroplan të ngrihet nga toka, duhet krijuar një forcë ngritëse. Në aerodinamikë, forca ngritëse krijohet kur ajri kalon te krahët e një aeroplani në mënyrë të tillë që trysnia nga poshtë krahëve të jetë më e madhe se trysnia sipër krahëve. Kur forca ngritëse e tejkalon tërheqjen nga poshtë të forcës së rëndesës, aeroplani ngrihet nga toka dhe arrin të fluturojë.

Në një mënyrë të ngjashme, ne mund ta krijojmë forcën ngritëse në jetën tonë shpirtërore. Kur forca që na shtyn drejt qiellit, është më e madhe sesa tundimet dhe ankthi që na tërheqin poshtë, ne mund të ngjitemi dhe të fluturojmë në mbretërinë e Shpirtit.

Edhe pse ka shumë parime të ungjillit që na ndihmojnë ta arrijmë forcën ngritëse, do të më pëlqente të përqendroheshja te njëri në veçanti.

Lutja!

Lutja është një nga parimet e ungjillit që siguron forcë ngritëse. Lutja ka fuqinë të na ngrejë nga shqetësimet tona tokësore. Lutja mund të na ngrejë përmes reve të dëshpërimit ose errësirës për te një horizont i ndritshëm e i kthjellët.

Një nga bekimet e privilegjet dhe mundësitë më të mëdha që kemi si fëmijë të Atit tonë Qiellor, është se ne mund të komunikojmë me Të nëpërmjet lutjes. Mund t'i flasim Atij për përvojat tona jetësore, sfidat dhe bekimet. Ne mund ta dëgjojmë e të marrim udhërrëfim qiellor nga Shpirti i Shenjtë në çdo kohë e në çdo vend.

(Shih Dieter F. Uchtdorf, "Prayer and the Blue Horizon", *Ensign ose Liahona*, qershor 2009, f. 5–6)

"Ati ynë Qiellor i dëgjon lutjet e fëmijëve të Tij [anëmbanë] tokë[s] që luten për ushqim për të ngrënë, për rroba për t'i mbuluar trupat e tyre dhe për dinjitetin që do të rridhte nga të qenët në gjendje për të siguruar për vete."

HENRI B. AJRING,
"Mundësi për të Bërë Mirë", *Ensign* ose *Liahona*, maj 2011, f. 22

"Ne duhet të kërkojmë ndihmë nga Ati ynë Qiellor dhe të kërkojmë forcë përmes Shlyerjes së Birit të Tij, Jezus Krishtit. Në të dyja, si në gjërat materiale ashtu dhe ato shpirtërore, marrja e kësaj ndihme hyjnore na mundëson të bëhemi kujdestarë të matur për vete dhe për të tjerë."

ROBERT D. HEJLS, "Të Bëhemi Kujdestarë të Matur, Materialisht dhe Shpirtërisht", *Ensign* ose *Liahona*, maj 2009, f. 8

Kthehuni te faqja 240.



10: TREGONI INTEGRITET MORAL

Raportoni: Tregojani shkurtimisht grupit një përgjigje që morët nga lutja javën e kaluar.

Përsiatni: Përse i do Zoti ata që kanë “integritet të zemrës”?

Shikoni: “What Shall a Man Give in Exchange for His Soul?” [“Çfarë do të japë Njeriu si Shkëmbim të Shpirtit të Vet?”], në dispozicion te srs.lids.org/videos. (Nuk keni material filmik? Lexoni faqen 25.)

Diskutoni: Çfarë do të thotë të kesh integritet moral? Cilat janë disa nga mënyrat e thjeshta se si njerëzit japin shpirtin e vet për të marrë gjëra në këtë jetë?

Lexoni: Nenet e Besimit 1:13; Jobi 27:5 (në të djathtë)

VEPRIMTARI

Në mënyrë të pavarur, vlerësojeni veten në fushat e mëposhtme.

VENDOSNI NJË NUMËR PËRPARA ÇDO PIKE PËR TË TREGUAR SE SA SHPESH VEPRONI NË KËTË MËNYRË

1 = kurrë, 2 = nganjëherë, 3 = shpesh, 4 = gjithnjë

- _____ 1. I mbaj të gjitha premtimet, zotimet dhe besëlidhjet e mia.
- _____ 2. Jam tërësisht i vërtetë në gjërat që them dhe në shënimet që mbaj.
- _____ 3. Nuk e teproj që t'i bëj gjërat të duken më të mira nga sa janë.
- _____ 4. E kthej çdo gjë që marr hua dhe nuk marr gjëra që nuk më përkasin.
- _____ 5. Jam tërësisht besnik ndaj bashkëshortit/es tim/sime në fjalët dhe veprimet e mia.
- _____ 6. Nuk mashtraj kurrë, edhe kur e di që nuk do të më kapin.
- _____ 7. Kur gjej diçka që nuk është e imja, ia kthej të zotit.
- _____ 8. Gjithmonë e shlyej borxhin e marrë.

Diskutoni: Lexoni Mosian 4:28 (në të djathtë) dhe citimin nga Plaku Jozef B. Uirthlin (në faqen 25). Përse është pagimi i një borxhi apo huaje biznesi apo studentore (e tillë si një hua nga FQA-ja) një çështje e integritetit moral vetjak?

Zotohuni: Zotohuni që t'i bëni veprimet vijuese gjatë javës. Shenjojeni kutinë kur ta përfundoni secilin veprim:

- Përmirësoni një nga tetë aspektet që vlerësuar më sipër.
- Tregojani familjes apo miqve tuaj atë që keni mësuar sot rreth integritetit moral.

“Ne besojmë në qenien të ndershëm.”

NENET E BESIMIT 1:13

“Deri në regëtimat e fundit nuk do të heq dorë nga ndershmëria ime.”

JOBIT 27:5

“Dhe unë do të doja që ju të mbanit mend se kushdo mes jush, që merr hua nga fqinji i tij duhet t'ia kthejë gjënë që ai ka marrë hua, sipas asaj që bini dakort, përndryshe do të bëni mëkat; dhe ndoshta do të shkaktoni që fqinji të bëjë mëkat gjithashtu.”

MOSIA 4:28

ÇFARË DO TË JAPË NJERIU SI SHKËMBIM TË SHPIRTIT TË VET?

Nëse nuk jeni në gjendje ta shikoni materialin filmik, lexoni këtë tekst.



PLAKU ROBERT C. GEJ: Shpëtimtari një herë u bëri dishepujve të Tij pyetjen në vijim: “Çfarë do të japë njeriu si shkëmbim të shpirtit të vet?”

Kjo është një pyetje që im atë më mësoi ta mendoja me maturi vite më parë. Ndërsa po rritesha, prindërit e mi më caktuan punë të përditshme përreth shtëpisë dhe më paguanin një shumë të vogël të hollash për atë punë. Shpesh ato para, pak më shumë se 50 qindarka në javë, i përdorja për të shkuar në kinema. Atëherë një biletë filmi kushtonte 25 qindarka për një 11-vjeçar. Më mbeteshin 25 qindarka për t’u shpenzuar me ëmbëlsira, që kushtonin 5 qindarka copa. Një film me pesë ëmbëlsira! Më mirë se kaq nuk bëhej.

Çdo gjë shkoi mirë derisa mbusha 12 vjeç. Një pasdite duke qëndruar në radhë, mora vesh se çmimi i biletës për një 12-vjeçar ishte 35 qindarka dhe kjo do të thoshte dy ëmbëlsira më pak. Jo shumë i përgatitur për ta bërë atë sakrificë, unë arsyetova me vete: “Ti dukesh njëlloj si një javë më parë”. Më pas hipa lart dhe kërkova një biletë 25-qindarkëshe. Sportelisti nuk më pa fare me sy hetues dhe unë bleva pesë ëmbëlsirat e mia të zakonshme në vend që të blija tri.

Më vonë, i ngazëllyer nga arritja ime, nxitova në shtëpi për t’i treguar tim eti për suksesin tim të madh. Kur po i tregoja hollësitë, ai nuk tha asgjë. Kur mbarova, ai thjesht më pa dhe tha: “Bir, a do të shisje shpirtin për një monedhë pesëqindarkëshe?” Fjalët e tij më therën në zemrën time 12-vjeçare. Është një mësim që nuk e kam harruar kurrë.

(“Çfarë do të Japë Njeriu si Shkëmbim të Shpirtit të Vet?” *Ensign* ose *Liahona*, nëntor 2012, f. 34)

Kthehuni te faqja 242.

“Integritet moral do të thotë të bëjmë gjithmonë atë që është e drejtë dhe e mirë, pavarësisht nga pasojat e menjëherëshme. Do të thotë të jemi të drejtë nga vetë thellësia e shpirtit tonë, jo vetëm në veprimet tona por, më e rëndësishmja, në mendimet tona dhe në zemrat tona. . . . Pak gënjeshtria, pak mashtrim ose marrja e një përfitimi të vogël të padrejtë, nuk janë të pranueshme për Zotin. . . . Shpërblimi i përkryer i integritetit moral është shoqërimi i vazhdueshëm i Frymës së Shenjtë, . . . [i cili do të] na udhërrëfjëjë në gjithçka bëjmë.”

JOSEPH B. WIRTHLIN,
“Personal Integrity”,
Ensign, maj 1990, f. 30,
32, 33



11: KËRKONI TË MËSONI: ZGJIDHNI SE KU PO SHKONI DHE SI TË ARRINI ATJE

Raportoni: Tregoni shkurtimisht një përvojë kur ju treguat integritet moral javën e kaluar.

Përsiatni: Si na krijon të nxënit mundësi?

Shikoni: "Education for a Better Life," ["Arsimim për një Jetë më të Mirë"], në dispozicion te srs.lds.org/videos. (Nuk keni material filmik? Lexoni faqen 29.)

Diskutoni: Çfarë donte Plaku Jozef W. Sitati kur ishte 13 vjeç? Çfarë bëri ai rreth kësaj?

Lexoni: Doktrina e Besëlidhje 88:118–119 dhe citimi nga Presidenti Gordon B. Hinkli (në të djathtë)

Përsiatni: Çfarë mendimesh dhe përshtypjesh keni pasur nga Fryma e Shenjtë rreth përmirësimit të jetës suaj?

VEPRIMTARI – KRIJIMI I NJË "MISIONI TË JETËS"

Hapi 1: Lexoni citimin nga Presidenti Henri B. Ajring (në faqen 27). Zoti ka një plan për ju. Ai ju ka bekuar me dhurata dhe talente të veçanta që do t'ju lejojnë të bëheni çdo gjë që Ai dëshiron që ju të bëheni. Ju mund ta përmbushni misionin tuaj këtu në tokë nëse jeni të zellshëm në përpjekjet për ta kuptuar vullnetin e Tij për ju dhe t'i bindeni atij.

Hapi 2: Përgjigjuni pyetjeve më poshtë që të filloni të krijoni përfytyrimin apo "misionin e jetës" suaj. Javën e ardhshme ju do të keni mundësinë t'ia tregoni grupit "misionin e jetës" suaj.

MISIONI I JETËS SIME

Ku dua të jem pas pesë vjetësh?

Përse?

Çfarë aftësish, njohurish ose përvojë më nevojiten për të arritur atje?

"Kërkoni me zell dhe i mësoni njëri-tjetrit fjalë urtësie; po, kërkoni nga librat më të mirë fjalët e urtësisë; kërkoni të mësoni, madje me anë të studimit dhe gjithashtu me anë të besimit. . . . Ngrini një shtëpi . . . mësimi."

DOKTRINA E BESËLIDHJE 88:118–119

"Ne kemi një përgjegjësi dhe një sfidë për të zënë vendet tona në botën e biznesit, shkencës, qeverisë, mjekësisë, arsimit dhe çdo profesioni tjetër me vlerë e dobiprurës. Ne kemi një detyrim për t'i stërvitur duart dhe mendjet tona që të shkëlqejnë në punën e botës për bekimin e gjithë njerëzimit."

GORDON B. HINCKLEY,
"A City upon a Hill",
Ensign, korrik 1990, f. 5

Zotohuni: Zotohuni që t’i bëni veprimet vijuese gjatë kësaj jave. Shenjojeni rutinë kur ta përfundoni secilin veprim.

- Plotësojini synimet vijuese dhe vihuni në rolin e këshilluesit për veprimtarinë.
- Përfundoni së shkruari planin e “misionit të jetës” suaj dhe diskutojeni atë me familjen tuaj.
- Kërkojini dikujt të jetë këshilluesi juaj dhe vendosni një kohë për t’u takuar.

VEPRIMTARI – KRIJIMI I SYNIMEVE

Hapi 1: Lexojeni citimin nga Presidenti Hauard W. Hanter (në të djathtë). Nëpërmjet synimeve, shpresat tona shndërrohen në veprime.

Synimet duhet:

1. Të jenë specifike dhe të matshme.
2. Të shkruhen diku dhe të vendosen atje ku mund t’i shihni të paktën çdo ditë.
3. Të kenë afate për t’u përmbushur.
4. Të kenë veprime të veçanta që duhet të ndërmerren për ta përmbushur synimin.
5. Të rishikohen, raportohen dhe përditësohen vazhdimisht.

Hapi 2: Në një fletë të veçantë letrë, shkruani dy ose tri synime që do t’ju ndihmojnë ta arrini misionin e jetës suaj. Ndiqeni shembullin më poshtë. Vendoseni letrën atje ku mund ta shihni çdo ditë.

SYNIMI	PËRSE?	HAPA TË VEÇANTË PËR TA ARRITUR SYNIMIN	RENDI KOHOR	KUJT DO T’IA RAPORTOJ PËRPARIMIN TIM?
SHEMBULL: Lexojeni Librin e Mormonit për 30 minuta çdo ditë.	Që unë të mund të marr udhëheqje të përditshme nga Fryma e Shenjtë.	1. Ngrihem në orën 6:30 të mëngjesit çdo ditë. 2. Lexoj përpara se të ha mëngjes. 3. E shënoj përparimin tim në tabelë.	Unë do të bëj një vlerësim të përparimit tim çdo natë përpara se të shkoj në shtrat.	Unë do t’ia tregoj tabelën time të përparimit një pjesëtarit të familjes çdo të diel.

“Përgjërrohuni që Shpirti t’ju tregojë atë që Zoti dëshiron që të bëni. Planifikoni që ta bëni këtë. Premtojini Atij se do të bindeni. Veproni me vendosmëri derisa ta kenë bërë atë që Ai kërkoi. Dhe pastaj lutuni . . . për të ditur se çfarë mund të bëni [më tej].”

HENRI B. AJRING,
“Veproni Gjithë Zell”,
Ensign ose Liahona,
maj 2010, f. 63

“Ky është një ungjill i pendimit dhe ne kemi nevojë të pendohemi dhe të zgjedhim të veprojmë më mirë. Me të vërtetë, procesi i pendimit, i bërjes së zotimeve dhe i vendosjes së synimeve duhet të jetë i vazhdueshëm. . . . Jua rekomandoj këtë praktikë.”

HOWARD W. HUNTER,
“The Dauntless Spirit of Resolution” (takim shpirtëror në universitetin “Brigam Jang”, 5 janar 1992), f. 2,
speeches.byu.edu

VEPRIMTARI – GJETJA E NJË KËSHILLUESI

Hapi 1: Lexojeni citimin nga Plaku Robert D. Hejls (në të djathtë). Ka lloje të ndryshme këshilluesish. Juve mund t’ju nevojitet dikush me shumë përvojë për t’iu përgjigjur pyetjeve tuaja – dikush që e ka bërë atë që doni të bëni ju. Këshillues të tjerë mund të jenë miqtë ose pjesëtarët e drejtë të familjes. Këta njerëz janë të gatshëm të shpenzojnë më shumë kohë duke ju nxitur të bëni ndryshime në jetën tuaj dhe duke ju mbajtur përgjegjës për të përparuar.

Hapi 2: Mendoni rreth llojit të ndihmës që ju nevojitet. Shkruani një listë të njerëzve që mund të jenë këshilluesit tuaj. Përsiatni dhe lutuni për listën tuaj të emrave.

Hapi 3: Përgjigjuni pyetjeve më poshtë që të filloni një marrëdhënie këshilluese. Për ta ftuar dikë që të jetë këshilluesi juaj, ju thjesht mund të pyetni: “Po përpiqem të bëj një ndryshim në jetën time. A do të ishit i gatshëm të më ndihmoni?”

KËSHILLUESI IM

Kë do të donit të ishte këshilluesi juaj?

Çfarë do t’i kërkoni atij apo asaj për të qenë këshilluesi/ja juaj?

Kur mund të takoheni për t’i treguar “misionin e jetës” suaj dhe synimet tuaja?

Sa shpesh do të donit të takoheshit me këshilluesin/en tuaj?

Hapi 4: Mbani mend se ju jeni përgjegjës për “misionin e jetës” suaj. Kur të takoheni me këshilluesin tuaj:

- Shqyrtojeni përparimin tuaj.
- Shqyrtojini pengesat në përparimin tuaj dhe atë që po bëni për t’i kapërcyer ato.
- Shqyrtojeni veçanërisht atë që planifikoni të bëni përpara se të takoheni me këshilluesin tuaj sërish.

“Në vitet e mia të moshës madhore, unë kam kërkuar këshillë nga prindërit e mi dhe nga këshilltarë besnikë e të besuar. Njëri ishte një udhëheqës i priftërisë; tjetri një mësues që besoi tek unë. . . . Me lutje zgjidhni këshillues që shqetësohen sinqerisht për mirëqenien tuaj shpirtërore.”

ROBERT D. HEJLS,
“Përballja me Sfidat e Botës së Sotme”,
Ensign ose Liahona,
 nëntor 2015, f. 46

ARSIMIM PËR NJË JETË MË TË MIRË

Nëse nuk jeni në gjendje ta shikoni materialin filmik, lexoni këtë tekst.



PLAKU JOZEF W. SITATI: Në moshën 13 vjeç jetoja në një pjesë tepër rurale të Kenias. Njerëzit kishin shumë pak gjëra. Por ata që dukeshin se i siguronin gjërat që të tjerët i admironin, ishin ata që kishin një arsimim të mirë. Arrita ta kuptoj se arsimi ishte një çelës për një jetë më të mirë.

Vazhdonte të më vinte mendimi që të shkoja e të flisja me drejtorin e njëres prej shkollave që dëshiroja me të vërtetë ta frekuentoja. Më nevojitej biçikleta e babait për ta bërë këtë udhëtim që më mori gjysmë dite. Nuk kisha dalë kurrë prej fshatit tim. Nuk dija se si të flisja anglisht shumë mirë dhe ky drejtor ishte një burrë i bardhë. Kurrë më parë nuk kisha takuar apo folur drejtpërdrejt me një burrë të bardhë, kështu që ky ishte një mendim që më trembi.

Diçka brenda meje vazhdonte të më shtynte dhe të më thoshte që duhej të bëja këtë, kështu që u nisa për ta takuar drejtorin. Kur e vështrova, mund të shikoja se ai qe pothuaj i befasuar ta shikonte këtë të ri që qëndronte si një ushtar përpara tij. Ai kishte sy dashamirës, kështu që më dha zemër. I thashë se doja me të vërtetë të hyja në shkollën e tij dhe do të isha shumë i lumtur

nëse do të më pranonte. Pastaj ai tha: “Epo, do të shohim kur të dalin rezultatet e provimit.” I thashë: “Faleminderit, zotëri”. Në më pak se katër minuta dola nga zyra.

Ato katër minuta që kalova në atë zyrë, ishin çastet vendimtare në jetën time. Isha i vetmi nxënës nga shkolla ime fillore që u përzgjodh në një nga shkollat më të mira në zonën tonë. Fakti që ky burrë i mirë ma kishte dhënë këtë mundësi, më bëri mirënjohës dhe më frymëzoi që të përpiquesha të isha nxënësi më i mirë në klasën time.

Kjo hapi mundësi të reja për mua që të shkoja në një tjetër shkollë të mirë dhe më pas të përgatitesha për në universitet. Arsimimi im bëri të mundur që ta gjeja bashkëshorten time në universitet. Më aftësoi që të gjeja një punë në qytet. Ndërkohë që jetonim në Nairobi, ne u ndeshëm me një çift misionarësh që na ftuan në shtëpinë e tyre, ku ata kishin mbledhje me njerëz që ishin anëtarë të Kishës. Nëse nuk do kisha qenë në Nairobi në atë kohë, nuk do ta kisha gjetur kurrë ungjillin. Fakti që isha në një punë të sigurt, më mundësoi të shërbeja në Kishë.

Dëshmoj se arsimi është një çelës për mbështetjen te vetja. Do të hapë shumë rrugë që ju të mund të jeni në gjendje të siguronit për veten tuaj materialisht si edhe të bëheni të mbështetur te vetja shpirtërisht.

Kthehuni te faqja 244.



12: MERRINI ORDINANCAT E TEMPULLIT

Raportoni: Tregoni paragrafin e “misionit të jetës” suaj nëse zgjidhni ta bëni këtë.

Përsiatni: Cilat janë disa nga gjërat që kanë më shumë rëndësi për ju?

Shikoni: “Doing What Matters Most” [“Bërja e Asaj që Ka më Shumë Rëndësi”], në dispozicion te srs.ids.org/videos. (Nuk keni material filmik? Lexoni faqen 31.)

Diskutoni: Çfarë gjërash të parëndësishme po na pengojnë të përparojmë? Si mund të na ndihmojnë ordincat e ungjillit?

Lexoni: Doktrina e Besëlidhje 84:20 dhe citimi nga Presidenti Bojd K. Paker (në të djathtë)

Diskutoni: Ndërsa kërkojmë mbështetje te vetja, pse është e rëndësishme të jemi të denjë për në tempull?

VEPRIMTARI

Hapi 1: Me një partner, lexoni citimin nga Plaku Kuentin L. Kuk (në të djathtë) dhe shkrimet e shenjta vijuese. Nënvizojini bekimet e premtuara për ata që adhurojnë në tempull.

“Si rrjedhim, në ordincat e saj, fuqia e perëndishmërisë manifestohet” (DeB 84:20).

“Dhe që ata të mund të rriten në ty e të marrin plotësi të Frymës së Shenjtë dhe të organizohen sipas ligjeve të tua e të përgatiten për të fituar çdo gjë të nevojshme” (DeB 109:15).

“Dhe kur njerëzit e tu të bëjnë shkelje, ndonjëri prej tyre, ata me të shpejtë të mund të pendohen e të kthehen tek ty dhe të gjejnë hir në sytë e tu e të rivendosen në bekimet që ti i ke shuguruar të derdhen mbi ata që do të të nderojnë ty në shtëpinë tënde” (DeB 109:21).

“Dhe ne të kërkojmë, Atë i Shenjtë, që shërbëtorët e tu të mund të largohen nga kjo shtëpi të armatosur me fuqinë tënde dhe që emri yt të mund të jetë mbi ta e lavdia jote të jetë përreth tyre dhe engjëjt e tu të ngarkohen me përgjegjësi për ta” (DeB 109:22).

“Ne të kërkojmë, Atë i Shenjtë, . . . që asnjë armë e formuar kundër tyre nuk do të përparojë” (DeB 109:24–25).

Hapi 2: Përsiatni individualisht: “Çfarë duhet të ndryshoj në jetën time që të marr pjesë në ordincat e tempullit më shpesh?”

“Si rrjedhim, në ordincat e saj, fuqia e perëndishmërisë manifestohet.”

DOKTRINA E BESËLIDHJE 84:20

“Zoti do të na bekojë ndërsa marrim pjesë në punën e ordincave të shenjta të tempujve. Bekimet e atjeshme nuk do të kufizohen te shërbimi ynë në tempull. Ne do të bekohemi në të gjitha punët tona. Ne do të kemi të drejtën që Zoti të ndikojë si në punët tona shpirtërore, ashtu edhe në ato materiale.”

BOYD K. PACKER, *The Holy Temple* (1980), f. 182

Zotohuni: Zotohuni që t'i bëni veprimet vijuese gjatë javës. Shenjojeni kutinë kur ta përfundoni secilin veprim:

- Nëse keni një rekomandim tempulli, vendosni një datë për të marrë pjesë në tempull.
- Nëse nuk keni një rekomandim tempulli, takohuni me peshkopin tuaj ose presidentin e degës për të diskutuar mënyrën se si mund të përgatiteni për t'i marrë ordinancat tuaja të tempullit.
- Tregojani familjes apo miqve tuaj atë që keni mësuar sot rreth ordinancave të tempullit.

Shkoni te faqja 32 dhe rishikoni hapat tuaj vijues.

BËRJA E ASAJ QË KA MË SHUMË RËNDËSI

Nëse nuk jeni në gjendje ta shikoni materialin filmik, lexoni këtë tekst.



TREGIMTARI: Një avion u rrëzua në Florida në një natë të errët dhjetori. U vranë mbi 100 njerëz. Ai ishte 32 kilometra larg zonës së sigurisë.

PRESIDENTI DITER F. UHTDORF: Pas aksidentit, hetuesit u përpoqën të përcaktonin shkakun. Rrota e përparme në fakt ishte shtrirë siç duhej. Aeroplani ishte në kushte mekanike të përkryera. Çdo gjë funksiononte siç duhej – gjithçka përveç një gjëje: një llambe të vetme drite e djegur. Llamba e vogël – me vlerë rreth 20 cent – nisi zinxhirin

e ngjarjeve që së fundi çoi në vdekjen tragjike të më tepër se 100 vetëve.

Sigurisht, llamba e dritës që nuk ndizej, nuk e shkaktoi aksidentin; ai ndodhi sepse ekuipazhi u përqendrua te diçka që dukej se kishte rëndësi në atë çast, duke harruar atë që kishte rëndësinë më të madhe.

Prirja për t'u përqendruar te gjërat e parëndësishme në kurriz të atyre të thellave u ndodh jo vetëm pilotëve por gjithkujt. Të gjithë jemi në rrezik. . . . A jepen mendimet dhe zemrat tuaja pas atyre gjërave jetëshkurtra, fluturake që kanë rëndësi vetëm për çastin, apo pas gjërave që kanë më shumë rëndësi?

(“Jemi Duke Bërë një Punë të Madhe dhe nuk Mund të Zbresim”, *Ensign* ose *Liahona*, maj 2009, f. 59, 60)

Kthehuni te faqja 248.

“Ne do të bënim mirë ta studionim seksionin e 109-të të Doktrinës e Besëlidhjeve dhe ta ndiqnim paralajmërimin e Presidentit [Hauard W.] Hanter për ta ‘vendos[ur] tempullin e Zotit si simbolin e madhërishtëm të anëtarësisë [sonë].”

KUENTIN L. KUK,
“Shikojeni Vetën Tuaj në Tempull”, *Ensign* ose *Liahona*, maj 2016, f. 99; duke cituar *Mësime të Presidentëve të Kishës: Hauard W. Hanter* (2015), f. 178–179



VAZHDONI NË SHTEGUN TUAJ TË MBËSHTETJES TE VETJA

Lexoni: Përgëzime! Gjatë 12 javëve të kaluara, ju keni krijuar zakone të reja dhe jeni bërë më i/e mbështetur te vetja. Zoti do që ju të vazhdoni të ndërtoni mbi këto aftësi dhe të zhvilloni aftësi të reja. Ndërsa lutemi dhe mbajmë vesh, Fryma e Shenjtë mund të na ndihmojë të dimë se cilat gjëra në jetën tonë duhet të përmirësojmë.

Diskutoni: Çfarë mund të bëjmë që të vazhdojmë përgjatë shtegut tonë të mbështetjes te vetja? Si mund të vazhdojmë ta ndihmojmë njëri-tjetrin?

Zotohuni: Zotohuni që t'i bëni veprimet vijuese gjatë 12 javëve të ardhshme. Shenjojeni kutinë kur ta përfundoni secilin veprim:

- Rishikojini dhe vazhdoni t'i jetoni të 12 parimet dhe zakonet e mbështetjes te vetja.
- Tregojuni të tjerëve atë që keni mësuar rreth mbështetjes te vetja. Vazhdoni t'i ndihmoni anëtarët e grupit tuaj ose propozoni të ndërmjetësoni për një grup të ri të mbështetjes te vetja.
- Ndërtoni mbi aftësitë tuaja duke marrë pjesë në një grup tjetër të mbështetjes te vetja.
- Studiojini parimet doktrinale të mbështetjes te vetja që janë më poshtë.

PARIMET DOKTRINORE TË MBËSHTETJES TE VETJA

MBËSHTETJA TE VETJA ËSHTË NJË URDHËRIM.	QËLLIMI I ZOTIT ËSHTË QË TË SIGUROJË PËR SHENJTORËT E TIJ DHE AI E KA TË GJITHË PUSHTETIN PËR TA BËRË KËTË.	MATERIALJA DHE SHPIRTËRORJA JANË NJË.
Doktrina e Besëlidhje 78:13-14; Moisiu 2:27-28	Doktrina e Besëlidhje 104:15; Gjoni 10:10; Mateu 28:18; Kolosianëve 2:6-10	Doktrina e Besëlidhje 29:34; Alma 34:20-25

“Dhe tani, vëllezërit e mi të dashur, pasi ju të keni hyrë në këtë shteg . . . , unë do t’ju pyesja nëse gjithçka është bërë? Vini re, unë ju them juve, Jo; pasi ju nuk keni arritur deri këtu përveçse me anë të fjalës së Krishtit, me besim të patundur në të, duke u mbështetur tërësisht në meritat e atij që është i fuqishëm të shpëtojë. . . . Ju duhet të shkoni përpara me një vendosmëri në Krisht.”

2 NEFI 31:19-20

“Zoti kujdeset mjaftueshëm për ne sa të na japë drejtim për të shërbyer dhe mundësinë për ta zhvilluar mbështetjen te vetja. Parimet e Tij janë të qëndrueshme dhe nuk ndryshojnë kurrë.”

MARVIN J. ASHTON,
“Give with Wisdom That They May Receive with Dignity”,
Ensign, nëntor 1981,
f. 91

LETËR PËRFUNDIMI

Unë, _____, kam marrë pjesë në një grup për mbështetjen te vetja të siguruar nga Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme dhe i kam përmbushur kërkesat e nevojshme për përfundim sikurse vijojnë:

Mora pjesë në së paku 10 nga 12 mbledhjet.

I ushtrova që të 12 parimet dhe ia mësova ato familjes sime.

Përfundova një veprimtari shërbimi.

Kam ushtruar dhe ndërtuar një themel aftësish, parimesh dhe zakonesh për mbështetjen te vetja. Do të vazhdoj t'i përdor këto gjatë gjithë jetës sime.

Emri i pjesëmarrësit

Nënshkrimi i pjesëmarrësit

Data


Unë vërtetoj se ky pjesëmarrës i ka plotësuar kërkesat e renditura më lart.

Emri i ndërmjetësit

Nënshkrimi i ndërmjetësit

Data

Shënim: Në një datë të mëvonshme mund të lëshohet një certifikatë e Kolegjit SHDM për Biznesin nga komiteti i mbështetjes te vetja i kunjit ose distriktit.



A DO TA VAZHDONI SHTEGUN TUAJ DREJT MBËSHTETJES TE VETJA?

“Prandaj, çfarë lloj njerëzish duhet të jeni? Në të vërtetë, unë ju them juve, madje siç jam unë.”

3 Nefi 27:27

KISHA E
JEZU KRISHTIT
E SHENJTORËVE TË
DITËVE TË MËVONSHME

Shërbime për
Mbështetjen te Vetja
FONDI I QARKULLUESHËM ARSIMOR

